

ZGJEDHJE TË

LIRA

KUSHT PËR TË CILIN

NUK KA NEGOCIATA

ZGJEDHJE TË LIRA: KUSHT PËR TË CILIN NUK KA NEGOCIATA

Botues: CIVIL- Qendra për Liri
Për Botuesin: Xhabir m.Deralla

Autorë, ekipi ekspert:

Xhabir M. Deralla (redaktor), d-r Sasho Ordanoski (analist politik), Petrit Saraçini (redaktor i botimit shqip), Biljana Jordanovska (hulumtime), Goran Naumovski (ekspert financiar), Sinisha Stanković (redaktor i CIVIL Media), Aleksandra Joziq- Ileković (eksperte për sisteme zgjedhore), Sandra Gavrilovska (eksperte juridike), Dragan Zeliq (ekspert për vëzhgime zgjedhore), Marija Tegovska, Dehran Muratov, Ermin Klimenta, Arbana Qerimi, Heather Roberson Gaston (këshill-tare speciale)

Ekipi i projektit dhe bashkëpunëtorët:

Sonja Eftovska (kryetare e komitetit ekzekutiv, CIVIL), Kreshnik Ajdini, Atanas Petrovski, Katerina Hristovska, Tomislav Kezharovski, Nikola Ugrinovski, Emrah Rexhepi, Behar Memishi, Hadis Sulejman, Biljana Everet, Agnesa Çavolli, Luljeta Klica, Vladimir Perçuklievski, Snezhana Milisavljeviq – Oshakovska, dhe tjerë

Ekipe vëzhguese:

Monika Taleska, Elena Ilievska, Lençe Hristova, Nadica Veliçkovska, Mide Nexhipi, Marijana Gugoski, Frosina Mitrusheva, Dimçe Velev, Dejan Ristov, Slagjana Angelkovska, Zorica Kostovska, Lumi Bekiri, Nenad Micov, Katerina Petanosvska, dhe tjerë

Layout & Design: Xhabir M.Deralla, Ermin Klimenta

Fotografi: Ekipi i CIVIL

Ilustrime: Miroslav Stojanović

Redaksia gjuhësore: Natasha Cvetkovska, Dijana Tahiri, Arsim Jonuzi, m-r Gordana Aceska

Shtypi: TP Dule 99, Shkup

Ky publikim është i financuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës Federale të Gjermanisë. Gjetjet dhe qëndrimet e prezentuara në këtë publikim janë vetëm të CIVIL dhe të autore(ë)ve dhe nuk i pasqyrojnë qëndrimet e donatorit.

Ky publikim është në dispozicion sipas kushteve të Creative Commons 4.0

Kontakte:

CIVIL, Maksim Gorki 31/1 Shkup, Republika e Maqedonisë
02/5209176/ civil@civil.org.mk/ civil.mk@gmail.com

Web: www.civil.org.mk | Facebook: www.facebook.com/civil.mk | Twitter: www.twitter.com/CivilMacedonia

YouTube: www.youtube.com/c/Civil.Macedonia

ISBN-10: 608-65629-9-7

ISBN-13: 978-608-65629-9-1

EAN: 9786086562991

ZGJEDHJE TË LIRA: KUSHT PËR TË CILIN NUK KA NEGOCIATA

raporte ■ analiza ■ aktivitete

Projekt:

ZGJEDHJE TË LIRA PËR QYTETARE/Ë TË LIRË

Botuar nga CIVIL - Qendra për Liri

Shkup

korrik, 2016

СИХЛ

Агенција
за Изборно Надзорово
Судство

СЛОБОДНИ
ИЗБОРИ
ЗА
СЛОБОДНИ
ГРАЃАНСКИ

Проект за слободни избори

ВКЛУЧИ СЕ!
НАБЉУДУВАЈ!

ЦИВИЛ ги повикува сите граѓани и
граѓани да се вклучат во набљудување
се обезбодат услови за слободни,
слободни, фер и транспарентни избори
во Република Македонија.

до делување
иот сектор
Битола

PARATHËNIE

ZGJEDHJE TË LIRA: NUK PRANOJMË ASGJË MË PAK SE KJO!

Xhabir DERALLA

Termi “zgjedhje të lira”, për të cilën këmbëngulej, është një shprehje kuptimi për të cilin tashmë ka diagnoza për Republikën e Maqedonisë. Zgjedhjet e lira janë aq të dukshme dhe normale në shumë shoqëri evropiane, por për këtë vend paraqesin problem brengosës për një kohë të gjatë. Ajo që është pranuar si një vlerë dhe një fakt i jetës në shoqëritë normale, është ende e pakapshme për vendin tonë.

Gjatë vitit të kaluar, CIVIL- Qendra për Liri, si organizatë joqeveritare nacionale prodemokratike, e cila vepron në Republikën e Maqedonisë, energjinë dhe fokusin ia përkushtoi qëllimit, i cili është dëshmuar si i realizueshëm për një numër të madh të shoqërive europiane, por i cili vazhdimisht mbetet jashtë arritjeve të shtetit tonë, gjegjësisht, ndaj zgjedhjeve fer.

Gjatë kësaj periudhe ishim të inkurajuar dhe plot energji, për arsye se me mijëra njerëz dolën në rrugë, gjithashtu duke kërkuar zgjedhje të lira, një ide, të cilës i ka ardhur koha.

Shprehja “zgjedhje të lira”, për të cilën insistohej, është shprehje me të cilën veç më jepet diagnozë për Republikën e Maqedonisë. Zgjedhjet e lira janë aq shumë të qarta dhe normale për një numër të madh të shoqërive europiane, megjithatë për këtë vend paraqesin problem shqetësues për një kohë të gjatë. Ajo që është pranuar si vlerë dhe fakt i jetës në shoqëritë normale, ende është e pa arritshme për vendin tonë. Megjithatë, ky është qëllimi të cilin organizata jonë po përpiqet ta arrijë, edhe përskaaj shtypjeve, pengesave dhe zvellimin e pa parashikueshëm në realitetin e vrrullshëm politik në vend. Vendosmëria ynë edhe më shumë u forcua me faktin që ndodhemi në një rreth me qasje armiqësore politike ndaj aktorëve të shoqërisë qytetare dhe ndaj secilit që do të merr guximin ta kundërshtojë monopolin e fuqisë të deritanishëm të pushtetit.

Por, Çfarë është e nevojshme për zgjedhje të lira? Që të mbahen zgjedhje të lira, na duhet shoqëri dhe qytetarë të lirë. Çlirimi i shoqërisë është proces i ngadalshëm dhe i ndërlikuar dhe nuk mund të zgjidhet me marrëveshje politike mes individëve të fuqishëm, pavarësisht nga numri i njerëzve të cilët ata i përfaqësojnë.

Qëndrimi ynë është se ne, si shoqëri civile, duhet të sigurojmë informata, dijeni dhe hapësirë të sigurtë që çdo individ dhe grupë njerëzish të bëhet pjesë e procesit demokratik. Na nevojiten qytetarë të çliruar nga frika. Na nevojiten qytetarë që janë të çliruar nga lidhjet jo parimore me struktura të dyshimta të fuqisë. Duhet në mënyrë aktive të ndihmojmë në çlirimin e atyre qytetarëve që janë aq shumë të mbështjellur në rrejtin e institucioneve politike, të ndërтуara në bazë të klientelizmit dhe testeve të besnikërisë. Në këtë mënyrë edhe është krijuar titulli i këtij projekti: Zgjedhje të lira për qytetarë të lirë.

Projekti “ Zgjedhje të lira për qytetarë të lirë” ka qasje nga shumë aspekte ndaj pre-gatitjeve për zgjedhje të lira në Republikën e Maqedonisë. Në zemrën e projektit është njohja e nevojës së qytetarëve për te i pa institucionet dhe partitë politike si pjesë e orvatjes së përbashkët për krijimin e kushteve për zgjedhje në atmosferë demokratike me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe sigurimin e zgjedhjeve të cilat do të jenë pasqyrë e doshirës së lirë të votuesve, sepse projekti ynë u zbatua në kohën e skandalit masovik të pushtetit me përgjime që zbuluan spiunime të opozitës nga ana e Qeverisë. Fakti se projekti ynë zbehohej në kohën kur zhvillohej skandali me përgjimet me të cilin u zbuluan shantazhet e zgjedhjeve dhe ndëshkimet e partive opozitare të bëra në nivelet më të larta të pushtetit, vetëm e theksoi kuptimin e këtij qëllimi, si dhe pengesat e shumta që e pengojnë arritjen e qëllimit.

Projektet, i cili filloi në qershor të vitit 2015, mes raportimeve për përgjime nga Qeveria dhe për manipulimin me zgjedhjet, vendosi qasje dhe metodologji unike të cilat siguruan edukimin qytetar ndaj të drejtës votuese dhe kontribuoi për ngritjen e vetëdijes ndaj parregullsive zgjedhore. U zbatua përmes ndarjeve të informatave dhe dijenive në bazë ditore, të bazuara në përcjellje afatgjate të të drejtave të njeriut dhe situatës politike në kontekst të përgjithshëm dhe zgjedhor.

Tani më jemi në fund të zbatimit të projektit, por në fillim të një procesi të gjatë plot me ndryshime dhe sfida. CIVIL përmes këtij projekti pati sukses të sigurojë bazë për ndjekjen afatgjate dhe analizë të proceseve shoqërore dhe politike lidhur me zgjedhjet, konkretisht të drejtës votuese dhe të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjithësi. Projektet është dhe do të mbetet burim për edukimin e qytetarëve, ngritjen e vetëdijes dhe rritjen e fuqisë të qytetarëve për sigurimin e zgjedhjeve të lira. Më në fund, kë është publikim i cili përmban selektim të shkurtë të raportimeve dhe analizave, të cilat janë rezultat i punës së palodhshme të një numri të madh njerëzish të cilët morën pjesë në implementimin e projektit “ Zgjedhje të lira për qytetarë të lirë”. Ky projekt është i gjallë dhe do të rritet, si që vazhdon puna e CIVIL, si organizatë për të drejtat e njeriut, e cila vazhdon, jo vetëm përmes projekteve, por edhe si grupe të organizuara të aktivistëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, ekspertëve, që vazhdojnë të mbledhin dhe shpallin raste të shkeljes të të drejtave të njeriut dhe kërkojnë përmirësimin e politikave dhe praktikave në të gjitha nivelet dhe në të gjitha sferat e shoqërisë.

Ishte ky një vit i vrullshëm, në të cilin kombinuam metodologji dhe aktivitete të ndryshme, të ndërlidhura dhe komplementuara, me qëllim të ballafaqohemi me sfidat e imponuara nga realiteti i ndërlikuar sociopolitik në Maqedoni. Përmes këtij projekti Kontribuam që të ndryshojë perceptimi i aspekteve të ndryshme të procesit dhe kulturës politike, vetodijen publike për zgjedhjet dhe të drejtat votuese, dhe formuam kërkesa për ndryshime të politikave, legjislativës dhe praktikave për sigurim të zgjedhjeve të lira.

Projekti përbehej nga disa komponente, përfshi

Hulumtimet në teren, përfshi anketat, fokus grupet, intervistat, të realizuara përmes internetit me disa mijëra njerëz dhe në teren, nëpër tërë vendin në pothuajse gjashtë komuna, analiza dhe rekomandime, fushata për ngritjen e vetëdijes, edukim qytetar dhe mobilizim ndaj kulturës politike dhe zgjedhore, edukim për të drejtat votuese dhe përfshirjen, si dhe formimin dhe administrimin e pesë ekipeve vëzhguese dhe ekipit mobil për vëzhgim dhe raportim afatgjatë. Si çdo herë, vazhdojmë me vëzhgimin e gjendjes me të drejtat e njeriut dhe me rrethin politik, me vëmendje të veçantë ndaj kontekstit zgjedhor të atyre proceseve. Shumë punë u kryen dhe ende më shumë duhet kryer. Megjithatë, jemi krenar për arritjet tona të deritanishme.

Ky projekt, "Zgjedhje të lira për qytetarë të lirë", do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, sepse i vendosi bazat e punës sonë edhe në projektet tjera në këtë sferë. Rezultatet nga projekti, përfshi edhe këtë publikim, e përfaqësojnë luftën pa kompromis të shoqërisë qytetare për nxitjen e zgjedhjeve të qëndrueshme për tejkalimin e praktikave korruptuese dhe mashtrimeve zgjedhore.

CIVIL ka prekur një numër të madh qytetarësh përmes projektit "Zgjedhje të lira për Qytetarë të lirë". I ka tejkaluar numrat fillestare të planifikuara dhe u bë udhërrëfyes në situatën e errët politike në Republikën e Maqedonisë. Çdo ditë, me mijëra njerëz i lexojnë raportimet e CIVIL lidhur me punën mbi këtë projekt. Arritja deri te profilet nëpër rrjetet sociale është mbi 150.000 çdo javë, me arritje të numrit prej 500.000 shikimeve për një javë. Në kornizat e këtij publikimi, kolegët e mi elaborojnë për të gjitha këto, si dhe për arritjet tjera.

Si çdo herë, mbështetemi në të dhëna, komente, sugjerime dhe këshilla nga votuesit dhe opinionit më të gjërë. Në të vërtete, një numër i madh i rasteve që u zbuluan gjatë vitit të kaluar vijnë nga qytetarë të brengosur. Vazhdoni komunikimin. Deri në ditën kur do të kemi mundësinë të thuar: Qytetarë të lirë votojnë në zgjedhje të lira në Republikën e Maqedonisë.

Nuk pranojmë asgjë më pak nga kjo.

RAPORTE NGA TERRENI

1 KORRIK, 2015 - 30 QERSHOR, 2016

Biljana JORDANOVSKA

Në bashkëpunim me ekipet vëzhguese dhe ekipit projektues të CIVIL-it.

Përgjatë zbatimit të projektit, CIVIL-i pranoi mbi njëqind raporte nga vëzhguesit afatgjatë, treqind porosi e denoncime nga qytetarë përmes postës elektronike apo në rrjetet sociale, si dhe formulare onlajn për paraqitje të shkeljes së të drejtës së votës dhe keqpërdorime e parregullsi të tjera përmes ueb-faqes "Zgjedhje të lira" (www.slobodniizbori.info).

Denes vo 17 casot ke se odi
vo Skopje so avtobus pred
Vodovod. Brabotenite
zadolzitelno, ako ne so ime i
prezime ke se pratat spisoci
do CENTRALA. POZ .
E vakva poraka jas i mnogu
drugi vrsboteni dobija
denes. pozz

Received: 15 April

Përveç

kësaj, ekipet e CIVIL-it, në përbërje të të cilave është edhe Redaksia e CIVIL Media, ishin mobilë dhe punonin në hulumtimin e gjendjeve dhe rasteve, përderisa bënë kontroll të fakteve të shënuara në raporte e paraqitje. CIVIL-i përditë informon për ndodhitë në terren dhe publikon ngjarje për keqpërdorime të shumta të pushtetit, diskriminim në bazë të lidhjeve politike, dhunë strukturore, korrupsion politik dhe një sërë kategorish të tjera të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut në kontekst zgjedhor e më gjerë.

Në vëzhgimin shumëvjeçar të gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Maqedonisë, CIVIL-i shënon rritje të vazhdueshme të keqpërdorimeve, shtypjeve dhe diskriminimeve në bazë të lidhjeve politike. Puna e vëzhguesve afatgjatë dhe ekipi i projektit të CIVIL-it në projektin “Zgjedhje të lira për qytetare e qytetarë të lirë” ishte dinamike dhe i rëndë.

U zbuluan dhe u publikuan një numër i madh rastesh, po mbetën edhe një numër i madh indikacionesh për keqpërdorime serioze dhe raste shkeljesh të të drejtave dhe lirive të njeriut në kontekst zgjedhor. Dhuna strukturore dhe diskriminimi politik janë shpërndarë gjithandej dhe kanë bërë fole në çdo pore të shoqërisë dhe institucioneve. Mirëpo, institucionet e drejtësisë mbeten të verbra e të shurdhra ndaj këtyre gjendjeve dhe vazhdimisht i pohojnë gjetjet për kontroll partiak mbi to, me çka pamundësohet qasja te drejtësia për një numër të madh qytetarësh e qytetarësh.


Ueb-faqja kryesore e CIVIL-it (www.civil.org.mk) është resurs jashtëzakonisht i pasur, në të cilin janë publikuar mbi 800 tekste në rubrikën Zgjedhje, vetëm në periudhën 1 korrik 2015 – 30 qershor 2016. Një pjesë e madhe e këtyre përmbajtjeve janë dëshmi direkte e dokumente për shkeljet serioze që i regjistron organizata jonë.

E informojmë opinionin publik për resurset onlajn për t’u informuar për gjendjet dhe për rastet e shumta individuale, për të cilat flasin raportet e vëzhguesve afatgjatë, si edhe rezultatet e hulumtimit të ekipit të CIVIL Media-s. Të gjitha përmbajtjet e CIVIL-it janë të lira për t’u marrë, për t’u shfrytëzuar e publikuar, sipas licencës Creative Commons 4.0, e me këtë i inkurajojmë mediumet të vazhdojnë t’i përdorojnë këto resurse.

Në publikim, CIVIL-i ka parasysh ruajtjen e identitetit të burimit. Me kërkesë të buri-

meveve, një pjesë e madhe e raporteve nga terreni nuk mund të publikohen për shkak të "frikës nga hakmarrja e regjimit", siç thonë ata. Megjithatë, për t'u vërejtur është fakti se gjithnjë e më i madh është numri i njerëzve që marrin guximin për të folur për atë se çfarë është duke u ndodhur dhe që duan t'i ndajnë përvojat e veta me problemet e mëdha që lidhen me partizimin e institucioneve në nivel lokal e nacional.

Gjithashtu, veçanërisht është nxitës e motivues fakti se besimi në organizatën tonë u rrit edhe më shumë përgjatë zbatimit të këtij projekti. Kjo vërehet në çiltërsinë e qytetarëve për të ndarë informacione me CIVIL-in edhe atëherë kur janë më së shumti të frikësuar nga pasojat me të cilat mund të përballen për shkak të komunikimit të tillë. Përndryshe, për secilin prej qindra rasteve që i regjistrojnë vëzhguesit e CIVIL-it, ekzistojnë të dhëna precize, incizime apo dokumentacion tjetër, që arkivohet sipas metodologjisë së projektit dhe parimeve të organizatës.



Në vazhdim po publikojmë një seleksion të shkurtër të gjendjeve dhe rasteve që i regjistron CIVIL-i përgjatë 12 muajve të fundit. Duhet të kihet parasysh se shpeshherë është e pamundur për t'u bërë kategorizim i qartë i rasteve,

sepse shpesh ato bien në më shumë kategori, gjegjësisht një keqpërdorim shpesh shpie në shkelje edhe në kategori të tjera.

Për shkaqe të kuptueshme, nuk zbuluam detale për rastet individuale, për shkak të mundësisë që burimet tona të jenë objekt i revanshizmit.

PRESIONI POLITIK I ASHPËR DHE MASIV

Përditshmëria e një numri të madh të qytetareve dhe qytetarëve të Republikës së Maqedonisë është e plotësuar me shumë kërcënime, shtypje dhe kushtëzime të motivuara politikisht.

Shtypjet, kërcënimet dhe kushtëzimet, për të cilat lajmëronin vëzhguesit dhe burimet

nga tereni, lëviznin prej atyre subtile, deri të ashpra dhe të drejtpërdrejta. Në shumë raste ato zbatohen nga përfaqësues të institucioneve, përfshirë edhe anëtarë të policisë dhe shërbimeve të inspektimit, në kohë pune dhe pas saj.

Këto ngjarje jo të mira u ndodhin njerëzve gjithandej, nëpër vende publike, nëpër institucione, në vendin e punës dhe në sektorin privat, në arsim, shëndetësi, po edhe në komunikim të përditshëm mes njerëzve.

Është e shpeshtë skema, kur së pari dërgohen "këshilla dhe kallëzime miqësore" përmes miqve të afërm dhe farefisit të "shënjestrës", që më vonë ato të zhvillohen në paralajmërime, kërcënime dhe kushtëzime. Nëse e gjithë kjo nuk e arrin efektin e duhur, kalohet në shtypje më serioze për "disiplinim" dhe "ndëshkim" të të padëgjueshmëve.

Mbi një mijë qytetare dhe qytetarë, në komunikim me ekipet e CIVIL dhe në komunikim onlajn, lajmërojnë për shtypje politike dhe diskriminim në bazë të përkatësisë politike. "Do të shohësh ti që shoqërohesh me "komunjarë"!"; është komunikim i rregullt i ushtarëve partiak me të gjithë tjerët. Mjafton të klikohet "lajk" (më pëlqen) në ndonjë postim "jo të përshtatshëm" në Fejsbuk, që të mund të fillojë procedura e "disiplinimit", e cila mund të sjellë deri te degradimi i vendit të punës dhe ekskomunikim nga kolektivi.

CIVIL ka ardhur deri te dëshmi të shumta për shtypje të motivuara politikisht, si dhe dhunë, në të cilën protagonistë janë funksionarë komunalë dhe policë.

Ndalimi i ndihmës sociale, fshirja nga evidenca e të papunësuarve, ndërprerja ose ulja e subvencioneve për prodhime bujqësore, ulja e rrogës – janë vetëm një pjesë nga mbi 250 raste, për të cilat informoi CIVIL në periudhën 12 mujore, prej korrikut të vitit 2015 deri në qershor të vitit 2016.

As fëmijët e as të rinjtë nuk janë të kursyer nga shtypjet politike. Përveç se ushtrohet indoktrinim i përditshëm i fëmijëve dhe të rinjve, ata janë edhe mjet për shtypje politike mbi prindërit. Deri te këto raste është shumë rënde të arrihet. Burimet frikësohen për fëmijët e tyre dhe pa dëshirë flasin për atë që u ndodh. Megjithatë, ekipet e CIVIL erdhën deri te 20 raste, në të cilat stafi arsimor bën shtypje subtile mbi fëmijët, prindërit e të cilëve janë të orientuar nga opozita.

SHTYPJE, KËRCËNIME E DISKRIMINIME POLITIKE

CIVIL-it i kanë ardhur raporte për më shumë se 30 raste individuale për shtypje të motivuara politikisht dhe lloje të tjera prishjesh në institucionesh arsimore në Manastir, Ohër, Shkup, Gostivar, Veles, Kavadar, Shtip, Kumanovë, Shën Nikollë, Vallandovë, Strumicë, Kërçovë dhe Gjevgjeli.

Trajta “më e butë” e shtypjeve regjistrohet në rastet kur drejtorët gjejnë mënyra se si në mënyrë subtile t’i maltretojnë të punësuarit që nuk janë të lidhur me pushtetin, me shtim të detyrave në punë që nuk janë kompetencë e tyre, me kërcënime dhe ndëshkime për cilindo gabim, pa qoftë edhe për gabimin më të imët në punë, kurse i shpeshtë është rasti “të papërshtatshmit” të “kurdisen” për gabime që fare nuk i kanë bërë.

Një profesoreshë “e papërshtatshme” e historisë në një shkollë të mesme në një komunë në pjesën perëndimore të vendit e largojnë nga puna, kurse në vend të saj vënë një inxhinier pylltarie, për të ligjëruar histori, i cili përndryshe është ushtar i partisë në pushtet.

Një personi që punon si udhëheqës i një ndërmarrjeje për shërbime funerale, që është në pronësi të shtetit, i kanë ardhur kërcënime për jetën e tij dhe të familjarëve të tij, se do t’ia djegin shtëpinë po qe se nuk i përmbush urdhrat për pjesëmarrje në kundërprotesta dhe aktivizëm partiak “nga dera në derë”. Sipas dëshmisë të qytetarit të shqetësuar, kërcënimet i ka marrë nga pushtetarë partiakë lokalë, kurse më së shumti shtypje kishte përjetuar nga drejtori i zyrës lokale të Agjencisë për Punësim dhe nga sekretari i Këshillit Komunal të VMRO-DPMNE-së. Për t’iu shmangur shtypjeve, burimi i CIVIL-it thotë se është detyruar të marrë pushim mjekësor, por përgjigjja për të kishte qenë se për të tashmë është nënshkruar vendim për largim nga puna.

Të punësuarit në një ndërmarrje publike komunale paraqitën se kishin marrë dënime në vlerë prej 10% të të hyrave të tyre për shkak se kishin refuzuar të shkojnë në kundërprotestë në Shkup, në prill të vitit 2016. Një tjetri të punësuarit në administratë, sipas raportit të vëzhguesit të CIVIL-it, në mars të vitit 2016 iu ishin shkurtuar 10% të rrogës për shkak se kishte munguar në një ngjarje për promovimin e rezultateve të arritura të partisë në pushtet në komunën e tij.

Birit të një vëzhgueses sonë iu ishte paraqitur një prind i një bashkënxënësi të tij, përndryshe aktivisti i partisë në pushtet, dhe i kishte thënë sharje e kërcënime për shkak të aktivitetit të tij onllajn dhe për shkak se nëna e tij ka bashkëpunuar me CIVIL-in.


Shtabi partiak lokal në Kërçovë bën mobilizim të protestave në Shkup në maj të vitit 2016. Një qytetare, e punësuar në administratë publike, kishte kërkuar të kursehet nga detyrimi për të marrë pjesë në një kundërprotestë, me ç'rast i kanë thënë: "Vetëm mos shko, pa nesër në punë të pret vendim për largim nga puna".

KEQPËRDORIM I INSTITUCIONEVE PËR QËLLIME PARTIAKE

Mbyllja e firmave private, në pjesën më të madhe kafiteri dhe objekte të tjera hotelerike, si dhe shitore të vogla, është trajta më e shpeshtë e qërimit të hesapeve politike, sipas dëshmimeve të ndërmarrësve të vegjël. Ata pohojnë se DAP-i dhe shërbimet e tjera inspektuese, ashtu si edhe policia, vazhdimisht bëjnë shtypje mbi bazë partiake dhe selektivisht i zbatojnë ligjet.

Sipas fjalëve të mbi njëzet pronarëve biznesesh të vogla, edhe pse e kanë të gjithë dokumentacionin e duhur, nuk mund të ngrenë kokën nga inspeksionet që vazhdimisht sulmojnë lokalet e tyre dhe i maltretojnë. Raste të këtilla CIVIL-i vëren te pronarët e bizneseve të vogla në Shkup, Veles, Shtip, Kumanovë, Strugë, Gjevgjeli, Gostivar dhe në sërë komunash të tjera.

Sipas burimeve të CIVIL-it, faji i vetëm që e kanë shitësit është që nuk janë bashkë-



mendimtarë të partive në pushtet. Ata shpeshherë janë të shpërndarë ndërmjet pushteteve lokale dhe shërbimeve qendrore, të cilët vazhdimisht i vizitojnë dhe i dënojnë pa bazë.

“Kur të hyjë inspeksioni, thjesht, e di se do të dënohesh. Pa marrë parasysh se a ka dënimi bazë apo jo, duhet patjetër ta paguash, e pastaj mund të ankohesh. Po sikur të kishte te kush të ankohemi?” – dëshmojnë dy pronarë të një shitore shtëpiake në një komunë. Fjalët e tyre janë jehonë e shumë dyqanxhivë nëpër gjithë vendin.

Në ditët kur u ndërruan ministrat e punës dhe politikës sociale dhe i punëve të brendshme nga radhët e opozitës, sipas Marrëveshjes së tejkalimit të krizës politike, ndodhën pakënaqësi të shumë të punësuar te këto dy ministri. Deri te CIVIL-i erdhën shumë ankesa nga i gjithë vendi (mbi 40 raste), në të cilat të punësuar në qendrat sociale, si dhe pjesëtarë të policisë, ankoheshin për shtypje politike dhe revanshizëm që e kishin bërë mbi ta pjesëtarë të partisë në pushtet.

Në ato ditë, në disa raste të tjera, ka ngjarë kaos i tërësishëm, sepse vetëm për pak ditë shumë pjesëtarëve të policisë u qenë anuluar dhe dy herë ndryshuar vendimet për të vënë marrëdhënie pune. Ata kishin marrë telegram nga ministri Çavkov me urdhër për t’u respektuar vendimet e nënshkruara prej tij, por iu kishte ardhur edhe telegram nga ministri Spasovski në të cilin thuhet se do të sanksionohet çdo mosrespektim i vendimeve të tij.

SHTYPJE POLITIKE DHE MOBING

Një grup të punësuarish në institucion publik iu drejtuan CIVIL-it, që prej se situata e tyre ishte bërë e padurueshme. Disa prej të punësuarve kishin edhe nga 25 vite përvojë pune në kujdesin për shëndetin e të mbrojturve në këtë institucion. Mirëpo, me ashpërsimin e krizës politike dhe emërimin e drejtuesit të ri, e punësuarat dhe koleget e tjera kishin qenë ekspozuar në shtypje të fuqishme politike.

E punësuarat, ashtu si edhe të tjerat që gjenden në situatën e njëjtë, kanë frikë të flasin publikisht për problemet e tyre. Disa prej tyre tashmë janë dënuar me shkurtrim të

rrogës, por frikësohen se do t'u jepet largim po qe se flasin për problemet publikisht. Sipas tyre, kushtet për punë në këtë institucion janë të padurueshme, mes tjerash, për shkak se është kthyer në një shtab partiak.

"Në mes të kohës së punës gjysma e personelit, pjesëtarëve partiakë e aktivistëve, mban një mbledhje dhe merren vesh se cilat hapa duhet të ndërmerren tutje në të mirë të partisë. Kështu ishte para se të mbahej Konferenca Vjetore e Unionit të Grave, gjithashtu, edhe në periudhën kur bëheshin lista me votues të sigurt të VMRO-DPMNE-së. Thjesht, institucioni tani funksionon si shtab partiak", thonë ata.

Një nga të punësuarat në këtë institucion ka vendim edhe për invaliditet të pjesërishëm pas një aksidenti të përjetuar trafik. Mirëpo, edhe pse ka ndalesë për të ngritur peshë, në fakt, çdo ditë, siç pohon, është e ekspozuar në mundime të këtilla, sepse e ka patjetër t'i pastrojë të mbrojturit, kurse disa prej tyre nuk lëvizin lehtë.

"Vendimin që e mora nga Komisioni nuk e merrte parasysh as drejtori paraprak, as ky i tanishmi. Nuk po më pranohet as diploma e arsimimit të lartë. Përveç kësaj, gjatë çdo përpjekjeje për ta shfaqur pakënaqësinë time, drejtori refuzon të më dëgjojë", dëshmon burimi ynë.

Për CIVIL-in dëshmoi edhe një avokat i një komune të madhe në Maqedoni, i cili në deklaratën e tij në dhjetor të vitit 2015 thotë se në kohën e fundit po rritet numri i të punësuarve në sektorin publik, të cilët te ai po kërkojnë këshilla se si të mbrohen nga shtypjet politike nga kuadri udhëheqës.

*

Sipas burimit tonë, të punësuar në ndërmarrje publike deklarojnë se udhëheqësit e tyre i thërrasin në shtabet partiake dhe në komuna dhe se aty u japin urdhra për t'i urdhëruar vartësit e tyre për të përpiluar lista nga 5-6 qytetarë të papërcaktuar. Ky "operacion" ka për qëllim të ketë ndikim ndaj të papërcaktuarve.

KEQPËRDORIM I ADMINISTRATËS DHE RESURSEVE PUBLIKE

Keqpërdorimi i resurseve, duke u nisur nga zyrat që përdoren për qëllime politike, e deri te keqpërdorimet e veturave zyrtare për nevoja partiake, por edhe personale, vërehet gjithkund dhe përditë, dhe paraqet dukuri të cilës madje askush nuk i kushton vëmendje. Thjesht, kjo konsiderohet si praktikë e zakonshme që çështja e këtyre keqpërdorimeve nuk merret seriozisht.

*

Ndaj një të punësuarë në një institucion kulturor, drejtoresha i ka dërguar vërejtje nga shtabi partiak se fare nuk është aktive në rrjetet sociale dhe se nuk shpërndan asgjë nga aktivitetet e pushtetit, që të punësuarit, sipas kësaj dëshmie, kanë pasur detyrim ta bëjnë në vendin e punës dhe në orarin e punës.

*

Një punëtoreje në Shkollën e Lartë Medicinale me kontratë në vepër që nga viti 2009, në një komunë në pjesën jugor të vendit, i është shqiptuar largim menjëherë pas mungesës pas lindjes. Sipas fjalëve të saj, arsyeja për këtë është lidhja e saj familjare me një funksionar të LSDM-së opozitare.

*

Përgjatë tetorit të vitit 2015, në një fshat në Maqedoninë Lindore, kryetari i Këshillit Komunal të një partie në pushtet dhe motra medicinale kryesore në shtëpinë e shëndetit i kishin vizituar familjet – për të cilat në opinion ishin konsideruar se i takojnë asaj partie.

Edhe pse sipas të gjitha gjasave është bërë fjalë edhe për persona me probleme shëndetësore, dhe sipas informacioneve nga banorët e fshatit, motra medicinale nëpër shtëpi me të vërtetë kishte bërë kontrolle mjekësore, kurse "shoqëruesi", përndryshe funksionar partiak lokal, ka bërë agjitim partiak të hapur.

*

Më 13 tetor 2015, në një qytet të Maqedonisë Lindore, një person i punësuar në administratën komunale si inspektor arsimor, përgjatë orarit të punës ka shpërndarë formu-

larë partiakë, në shoqërim të një zonje të panjohur.

Në mëngjes rreth orës 10 personi kishte kaluar në shtëpitë dhe ndërtesat, nga dera në derë, dhe me këtë kishte këmbëngulur për t'i mbushur formularët.

Në një vendbanim, sipas dëshmisë të burimit të vëzhguesit të CIVIL-it, pjesëtarët më të moshuar të familjes, përndryshe të regjistruar në listën e vizitorit si pjesëtarë të VMRO-DPMNE-së, nuk kishin pasur mundësi t'i mbushin formularët, por anketuesi partiak kishte këmbëngulur t'i plotësojë ndonjë pjesëtar më i ri i familjes. Qëkur ai kishte refuzuar duke thënë se nuk dëshiron dhe nuk mundet të përgjigjet në emër të tjetrit, anketuesi kishte kërkuar formularët, gjithsesi, t'i mbushë dikush tjetër dhe t'ia dërgojë në vendin e tij të punës në Komunë.

E meqenëse as ajo nuk kishte ndodhur, personi i njëjtë pasdite ishte kthyer edhe një herë me këmbëngulje që formularët të plotësohen menjëherë.

*

Disa anëtare të Unionit të Grave të VMRO-DPMNE-së në një komunë në pjesën veriore të vendit, të punësuar në administratën shtetërore, në orarin e punës kishin vizituar familje të rrezikuar socialisht dhe u kishin dërguar pako me ushqime. Me këtë rast, këtë ndihmesë e kishin paraqitur si ndihmesë nga partia në pushtet dhe kishin agjituar.

Rast i këtillë vërehet edhe në një komunë në pjesën lindore të vendit ku këta aktivistë partiakë kishin shpërndarë pako me banane.

PUNËSIME PARTIAKE

Punësimet partiake janë masive dhe ndonjëherë maten me qindra. Punësimi është "shpërblim" për angazhimin partiak në rrjetet sociale, agjitacionin dhe shtypjen ndaj njerëzve të tjerë, përgatitjen e listave me "votues të sigurt", mobilizimin për prani të tubimeve partiake, festime dhe kundërprotesta, ndjekjen dhe raportimin për aktivitetet e fqinjve dhe kolegëve, e madje edhe pjesëtarëve të familjes me orientim politik "të papërshatshëm".

Punësimet partiake janë më të vërejturat në administratën publike në nivel lokal dhe qendror edhe në ndërmarrjet publike. Me këtë, kriteri themelor për punësim është pikërisht librezja partiake, e as prej së largu nuk merren parasysh kualifikimet e kandidatëve për punë. Në kohën e sotme është vështirë për t'u punësuar edhe ndonjë mik apo familjar, po qe se nuk ekziston rekomandim nga shtabi partiak.

Marrëveshjet në vepër (punësimi i përkohshëm) janë mjeti më i shpeshtë për t'u mbajtur të punësuarit në sektorin publik në vartësi dhe të jenë patjetër vazhdimisht të detyruar ta dëshmojnë lojalitetin e tyre. Në CIVIL kanë mbërritur dëshmi, raporte dhe denoncime për këtë lloj keqpërdorimi dhe luajtje me pritjet e njerëzve nga spitalet, shkollat, kopshtet dhe institucione të tjera e ndërmarrje publike.

Ndërmarrja publike në një komunë në pjesën lindore të vendit, në marrëveshje me një pjesëtar të Këshillit të Komunës nga radhët e njëres prej partive romë, kishte nënshkruar marrëveshje për ndarje të përbashkët të mjeteve nga donatorë të huaj të destinuara për mirëmbajtje të higjienës në një lokacion frekuent.

Mjetet qenë fituar për angazhman të 20 personave me kontratë në vepër. Sipas raportit të vëzhguesit afatgjatë, punësimi ka qenë ekskluzivisht në linjë partiake dhe pjesa më e madhe e të punësuarve kanë qenë romë.

Pas marrjes së rrogës në llogari, gjithsecili prej njëzet të punësuarve ka qenë "i detyruar" të kthejë 3.000 denarë në dorë te "shefi", gjegjësisht te këshilltari i Komunës. Arsyetimi ka qenë se "gabimisht" u janë paguar tepriçë parash. Atyre që u është bërë i qartë "gabimi" në marrëveshjen e shkruar, qenë kërcënuar: "o do të ndash 3.000 denarë çdo muaj, o do të shkosh në shtëpi."

Mirëpo, "shefi" nuk ishte ndalur këtu. Përditë u kishte bërtitur, i kishte sharë e i kishte kërcënuar me ndërprerje të kontratës. Duke qenë se kishin pritur gjatë kohë për punësim, e duke u frikësuar se nuk do t'i humbasin edhe ato para që u kishin mbetur pas pagimit të "haraçit", punonjësit e angazhuar kishin heshtur dhe kishin punuar.

*

Në një qytet në Maqedoninë lindore, përgjatë shtatorit dhe tetorit të vitit 2015, dhe

pas publikimit të një konkursi nga MPB-ja (të 10 korrikut 2015) për pranim nëpunësish me arsimim të lartë (2) dhe policë në SPB-në e qytetit (10), sipas informacioneve nga një i punësuar në SPB, të gjithë të pranuarit në punë kishin qenë pjesëtarë të partive në pushtet.

Sipas burimit të SPB-së, nuk dihet numri i saktë i kandidatëve të pranuar dhe vështirë gjendet ajo e dhënë, po për një pjesë të të punësuarve dihet se ata janë persona që janë të afërt me funksionarë të pushtetit (deputetë, shefa, drejtorë...).

Të sapopunësuarit ishin të zhvendosur në punë nëpër stacionet policore në Shkup, por rrogat e tyre kishin qenë më të ulëta se rroga e zakonshme e nëpunësve policorë.

Sipas modelit të njëjtë të sjelljes, është bërë partizim edhe në SPB në një qytet lindor në Maqedoni, kur më 1 tetor 2015 na erdhi raport se janë punësuar "ushtarë" partiakë në policinë lokale, kurse dy veta (njëra është bashkëshorte e policit lokal të sapopunësuar) janë dërguar në punë në MPB në Shkup.

*


Rreth 100 vullnetarëve në një spital në pjesën veriore të vendit u ishte dhënë punësim permanent si pjesë e premtimeve zgjedhore të partnerit të koalicionit në pushtet, Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), në fund të vitit 2015. Kjo përputhet me periudhën kur pritej zgjedhjet të mbahen më 24 prill 2016. Përndryshe, një pjesë e madhe e tyre (higjienistë, teknikë mjekësorë, motra medicinale dhe mjekë) kishin punuar thuhet një dekadë si vullnetarë, të paguar me kompensime minimale, pa beneficione sociale dhe lehtësime. Sipas burimeve të CIVIL-it, drejtori i spitalit, përndryshe nga radhët e BDI-së, vazhdimisht i kishte "përkujtuar" të punësuarit e vullnetarët për atë se sa e mirë është Qeveria që u kishte dhënë angazhmane pune.

*

Ministria e Punëve të Brendshme e intensifikon punësimin në vija partiake menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Përzhinës, e veçanërisht në shtator e tetor të vitit 2015, para se të emërohej Oliver Spasovski nga LSDM-ja ministër i punëve të brendshme, që ishte detyrim i Marrëveshjes. Sipas informacioneve nga terreni dhe raporteve

të ekipeve monitoruese të CIVIL – Qendrës për Liri, e në bazë të burimeve relevante e të besueshme, në tri komunat më të mëdha të Republikës së Maqedonisë ishin punësuar dhjetëra persona me librezë partiake nga partia në pushtet.

CIVIL-i disponon të dhëna për punësime në të tri komunat, por nuk i kumtoi detalet për këtë operacion për t’i mbrojtur burimet e veta. Njëherësh, vërehen punësime, ashtu si edhe shtypje e rritur ndaj të punësuarve në administratë, që në disa muajt e fundit të vitit 2015 janë vënë në funksion të propagandës politike të strukturave udhëheqëse.



*

Si ilustrim të punësimit partiak mund të shërbejë edhe raporti i Rajonit të Manastirit. Në shtator të vitit 2015 në REK Bitolla qenë nëshkruar rreth 1.000 kontrata veprash përmes Agjencisë për Punësim, me premtim se do t’u japin punësim të përhershëm, por pas zgjedhjeve. Kuptohet, me kusht që të jenë lojalë dhe të dëgjueshëm ndaj partisë në pushtet.

*

Sipas raportit nga Ohri në tetor të vitit 2015, kryetari i këshillit vendor të VMRO-DPMNE-së, përndryshe i punësuar në Fondin e Shëndetësisë, në orarin e punës kishte plotësuar librezat partie para kolegëve të vet dhe njëherësh u kishte premtuar vende pune të sigurta pjesëtarëve të familjeve të tyre, po që se do të bashkëngjiteshin në partinë e tij.

*

Këto praktika ndonjëherë kanë epilog absurd. Kështu, një profesoreshe në një shkollë të mesme, në fillim të vitit shkollor, 1 shtator 2015, i ishte dhënë fond i plotë i orëve dhe ishte kualifikuar për punësim të

përhershëm. Të nesërmen, më 2 shtator, ia marrin të gjitha orët dhe e largojnë nga puna për shkak të dyshimit që e kishte shprehur shtabi partiak lokal se është “në anën tjetër”.

*

Psikologut të shkollës në një komunë, në një kolegji të mbajtur në gusht të vitit 2015, i thuhet se nuk do t’i vazhdohet kontrata për shkak se kishte pasur kandidat tjetër për vendin e tij të punës, që kishte pasur përvojë më të gjatë në parti.

*

Kështu, nga raporti i Prilepit i publikuar më 29.03.2016, mësuam për SMS-porositë e dërguar pjesëtarëve të partisë nga një këshill komunal në Prilep, ku kërkohen propozime për punësim në institucionin arsimor, me parakushtin më të rëndësishëm – të shënohet përvoja partiake e të propozuarve.

Nga një SMS-porosi tjetër e dërguar deri te pjesëtarët partiakë shihet se madje edhe për punë sezonale për përpunimin e duhanit, përparësi do të kenë pjesëtarët e këshillit vendor të partisë në pushtet.

PUNËSIME PARTIAKE NË SEKTORIN PRIVAT

Në vitet e fundit vërehet tempo veçanërisht e forcuar e punësimeve partiake edhe në sektorin privat.

Sipas raporteve të vëzhguesve afatgjatë dhe dëshmimeve nga të punësuar apo pronarë në sektorin privat, strukturat udhëheqëse në nivel lokal u imponojnë punësim të ushtarëve partiakë edhe firmave private.

“Argumenti që përdoret për bindje të pronarëve privatë janë DAP-i dhe shërbimet inspektuese, që përdoren si mjet për kërcënim dhe detyrim. Raste të këtilla vërejmë në Manastir, Shkup, Kumanovë, Veles, Kavadar, Strumicë, Shtip, Tetovë, Gostivar, Ohër dhe Prilep.

SHTYPJE PARTIAKE NDAJ SEKTORIT CIVIL

Në një qytet në Maqedoninë qendrore, një person i punësuar në ndërmarrje komunale si kontrollor, kishte kërcënuar aktivistë të organizatave joqeveritare. Duke pasur parasysh natyrën e punës së tij që i mundëson lëvizje nëpër qytet në orarin e punës, personi ka mundësi t'i vëzhgojë aktivitetet ditore nëpër rrugët e qytetit. Gjatë "aksionit gueril" të aktivistëve – për vënie të majmunëve në palmat që i kishte vendosur pushteti aktual, personi me skuter kishte ardhur në vendin e ngjarjes dhe kishte pyetur (edhe pse nuk është person i punësuar në MPB) se kush i kishte vendosur majmunët dhe kush qëndron pas aksionit. Në ditën e ardhshme personi i njëjtë kishte takuar një nga aktivistët e pranishëm të aksionit dhe e kishte kërcënuar me fjalët: "Të gjithë jeni incizuar duke i vendosur majmunët dhe do të shihni ju!"

Sipas aktivistit të frikësuar, personi i njëjtë, i cili vazhdimisht është i pranishëm në ngjarjet që i zbatojnë aktivistët e organizatave joqeveritare, i mbikëqyr dhe i kontrollon materialet që shpërndahen, pyet se çfarë agjende kanë, me ç'gjë ai bën shtypje, gjë që aktivisti e vlerëson si përpjekje për frikësim të sektorit civil nga një bashkëpunëtor i MPB-së apo ndonjë bashkëpunëtor i partisë në pushtet.

AGJITIM, PROPAGANDË DHE... PREMTIME TË RREME

Partitë në pushtet shpeshherë promovojnë një projekt më shumë herë. Ky raport është ilustrim i praktikës së tillë, aq më tepër që prania e këtyre ngjarjeve është e domosdoshme për të punësuarit në administratë, por edhe për popullatën në përgjithësi.

Më 30 gusht në vizitë në Dojran ishin kryeministri Nikolla Gruevski dhe ministri i transportit dhe lidhjeve Vllado Misajllovski, me rastin e fillimit të punëve ndërtimore të rrugës Dojran - fshati Nikoliq. Kryeministri paralajmëroi se rruga do të jetë gati për gjashtë muaj dhe se do të kushtojë 1,4 milion euro. Gjysmë ore pas largimit të tij, ishin larguar edhe makinat e punës dhe punonjësit.

Një nga banorët e fshatit Nikoliq iu ishte drejtuar vëzhguesit të CIVIL-it, i cili e kishte ndjekur këtë ngjarje dhe kishte kërkuar të shënohet se ushtarët partiakë vazhdimisht

këmbëngulin banorët të marrin pjesë në ngjarje të këtilla. Ky nuk është “promovimi” i parë i ndërtimit të rrugës së njëjtë – kishin dëshmuar shumë të pranishëm.

Më 12 nëntor, në një qytet në Maqedoninë perëndimore, Nikolla Gruevski në cilësinë e kryeministrit kishte qenë i pranishëm në fillimin e punëve për pishinën e mbyllur. Mirëpo, paraprakisht, anëtarësia e VMRO-DPMNE-së në profilet në Fejsbuk dhe në adresat elektronike ishte njoftuar për të marrë pjesë në lokacionet kur do të kalojë dhe do të qëndrojë kryeministri – “për të qenë dendur”, siç qëndron në porosinë origjinale. Porosi të këtilla u ishin dërguar edhe të punësuarve në çerdhe të fëmijëve dhe në shkolla fillore.

Përgjatë vizitës së njëjtë, me veprimet e kryeministrit ishte bërë propagandë e ashpër partiake, e fshehur në reklamimin e Qeverisë, si dhe devalvim i institucioneve shtetërore, përmes PR-modelit të përdorur shpesh “zgjidhje të problemeve të qytetarëve në vendin e ngjarjes, me telefon, por në kamera televizive.”

Për fat të keq, në situatën konkrete bëhej fjalë për dy raste të personave të pambrojtur.

Rasti i parë i propagandës vulgare nga pozita e të pushtetshmit dhe shpërdorimi i pozitës zyrtare është keqpërdorimi i një personi që vuan nga kanceri i lëkurës, baba i papunësuar i dy fëmijëve të mitur, kërkesa e vetme e të cilit ka qenë futja e medikamenteve të nevojshme në listën pozitive. Edhe pse rasti është i njohur për publikun për shkak të thirrjeve të shumta për ndihmë nëpër rrjetet sociale dhe emisionet televizive, personi ka qenë i ftuar në takim në rrugë dhe kryeministri Gruevski, për vetëm 2 minuta, “e ka zgjidhur problemin”, në koordinim me drejtorin e Fondit Shëndetësor, Sasho Stefanovski, dhe gjithçka është zhvilluar para kamerave.

Rasti i dytë ka të bëjë me një takim po në të njëjtën rrugë me një anëtar të një familje 8 anëtarëshe rome, e cila para një muaji ka qenë e detyruar të zhvendoset nga shtëpia. Asokohe, drejtori i Agjencionit për Menaxhimin e Hapësirës Publike, Cvetko Grozdanov, para medimeve deklaroi se kjo familje nuk ka më të drejtë ta përdorë barakën (e cila është në gjendje të rrënuar, por në lokacionin e së cilës është paraparë të ndërtohet një ndërtesë) dhe se do të zhvendoset, pa gjetur paraprakisht ndonjë zgjidhje vendbanimi për familjen me disa fëmijë të vegjël, gjë që nxiti reagime në mesin e qytetarëve.

Në takim me kryeministrin edhe ky rast u zgjidh para TV kamerave, e që ironia të jetë edhe më e madhe, Gruevski i është drejtuar pikërisht Grozdanovit me pyetjen: "A mund t'u gjendet një banesë nga 'ato'?"

Shpërdorimet vulgare të pozitive zyrtare janë bërë me qëllim të fitimit të votave të të gjithë përdoruesve të barnave që nuk gjenden në listën pozitive dhe qytetarëve nga minoriteti rom.

PROPAGANDË DHE GJUHË E URREJTJES

Të gjithë anëtarët e VMRO-DPMNE, pa përjashtim, kanë për detyrë t'i postojnë në Facebook të gjitha linqet në të cilat ka informacione për aktivitetet e Qeverisë, dhe këtë gjë duhet ta bëjnë disa herë në ditë. Për aktivitetin e tyre nëpër mediumet sociale mbahet një evidencë precize. Në qoftë se dikush çalon nga dinamika e aktiviteteve online, pasojnë telefonata dhe shtypje nga shtabet lokale partiake.

Ata që janë të punësuar në mënyrë partiake në administratë ose në ndërmarrjet publike janë të obliguar që në orar të punës të jenë maksimalisht aktiv në mediumet online, t'i përdorin këto mjete për propagandë dhe mobilizim të një numri sa më të madh njerëzish. Të punësuarit kanë obligim edhe të dërgojnë porosi SMS dhe të lajmërohen në telefon, në orar të punës dhe nga telefonët zyrtarë, që ta mbajnë aktivitetin partiak në nivel sa më të lartë.

Në fshatrat e rrethinës së Shkupit, para festave të Pashkëve (prill, 2016), aktivistë të VMRO-DPMNE kanë shkuar nga dera në derë dhe kanë ndarë vezë dhe ngjyrë. Përveç kësaj, kanë organizuar edhe një propagandë, duke i bindur qytetarët se më 5 qershor do të mbahen zgjedhje, sepse në të kundërtën do të ketë luftë. Sipas tyre, "lufta është zgjidhja e vetme". Njerëzit në fshatra kanë qenë të frikësuar deri në atë pikë që kanë filluar të sigurojnë rezerva të miellit, sheqerit dhe nevojave të tjera shtëpiake.

Në periudhën pas nënshkrimit të Marrëveshjes për tejkalimin e krizës politike, sipas

raporteve të mbikëqyrësve nga Regjioni i Manastirit, është intensifikuar mobilizimi i anëtarësisë në të gjithë komitetet vendore. Takimet janë pothuajse të përditshme, ndërsa organizimi i tyre bëhet gjatë orëve të punës të punonjësve në administratë, ndërsa terminet për takime ndonjëherë ndodh të caktohen edhe në mesnatë.

Gjendje identike vërehet edhe në Kërçovë, ku punonjësit në administratë, gjatë orarit të punës, rregullisht thërrasin njerëz në takime në orët e pasdites dhe mbrëmjes, duke mos harruar t'i theksojnë detajet për nevojat e secilit individ, si "argument" për bindje që ata me të vërtetë të vijnë në takim.

Për secilin individ ekzistojnë të dhëna se çfarë problemi ose nevoja ka. Tek një pjesë e madhe e njerëzve në listën e mobilizimit, nevoja më e madhe është punësimi, por shpeshherë në ato lista vërehen edhe nevoja shëndetësore të njerëzve, interesim i fëmijëve për udhëtime të caktuara, regjistrim në shkolla të caktuara ose bursa, leje për ndërtim, por edhe kundërvajtje, borxhe dhe një sërë probleme të tjera të përditshme, me të cilat ballafaqohen njerëzit e thjeshtë. Të gjitha këto shfrytëzohen si mjete për t'i bindur njerëzit të aktivizohen më tepër ose, në qoftë se nuk janë anëtarë të partisë udhëheqëse, t'i bashkangjiten të njëjtës.



Takimet, sipas burimeve të CIVIL-it, më së shpeshti zhvillohen në hapësira zyrtare dhe publike, duke i përfshirë edhe zyret e dektorëve të shkollave dhe institucioneve shëndetësore. Zyrtarë drejtorëve të institucioneve publike, si dhe funksionarëve të vetëqeverisjes lokale, më së shpeshti janë të dekoruara në mënyrë të tepruar me simbole partiake dhe fetare.

Sa i përket propagandës në rrjetet sociale, përmbajtja që plasohet aty është larg kufizimit vetëm në shpërndarje të informacioneve dhe përgëzim për arritjet e partive

në pushtet. Më e dukshme është, në fakt, fushata e zezë e pandërprerë, e stërbushur me shpifje dhe gjuhë të urrejtjes. Përveç opozitës, qëllimi i gjuhës së urrejtjes, fyerjeve banale dhe vulgariteteve tjera, janë edhe aktivistët e shoqërisë civile. Gjuha e urrejtjes nëpër rrjetet sociale është e liruar dhe larg çfarëdo niveli të mirësjelljes. Bëhet fjalë për

shpërthime të pastra urrejtjeje dhe kërcënime për jetët e individëve.

Është jetike të vihet re se në gjenerimin e gjuhës së urrejtjes udhëheqin individë nga jeta publike dhe e medimeve, redaktorë dhe udhëheqës të emisioneve të TV-stacioneve nacionale. Indikativ është edhe fakti se ata shpeshherë i paraqesin, por edhe i vulgarizojnë skajshmërisht, pikërisht deklaratat dhe qëndrimet e kreut të shtetit. Lideri i VMRO-DPMNE-së dhe kryeministri i deritanishëm, Nikola Gruevski, në fjalimet e tij, kundërshtarët e ideologjisë së tij i klasifikon me fjalët “fuqi të errëta”, “tradhtarë” e tjerë, dhe se populli “do t’i godasë me shqelma”. Këto shprehje, të kombinuara me kërcënime të ashpra dhe vulgaritete, shpërndahen shumë herë për një minutë të vetme nëpër rrjetet sociale.

пред 22 часа · 2

НЕМА ИЗБОРИ НЕМА МИР! НЕМА ИЗБОРИ НЕМА МИР! Вака ќе биде. Народот ќе ви суди. Шарена револуција ПРОШИРЕНА И НАДГРАДЕНА! Ќе ги боиме седиштата на Сдсм-предавничка, на Сјо-продадена, на Сорос-Невладини-поткупени-предавнички, домовите на лигушите што палеа и фарбаа и т.н.....

Ми се допаѓа · Коментирај · Сподели

и 49 други

i ro nekoj koktel ,molotov Види го преводот Ми се допаѓа - Одговори · 1 · пред 18 часа

Сподели

и 136 други

2 shares

View 12 more comments

imat moj broj i jas sum kraj tamu

2 · Вчера во 14:13 Шиптари ќе печемел Шиптари ќе печемел Шиптари ќе печемел

2 · Вчера во 15:34 · Изменет Ako na 9 maj se formira tehnicka vlada e togas grujо i zajko ke vidat sto znaci narod i kako postapura Makedonecot koga e predaden i prodaden za licni interesi...

1 · пред 17 часа KE GORI SVE, OVA E VETUVANJE, NEMA SILA STO KE NE SOPRE. Види го преводот · 1 · пред 17 часа

KEQPËRDORIMI I FËMIJËVE DHE TË MITURVE

Gjatë vizitës së zëvendës-ministrit për punë dhe politikë sociale, Spiro Ristovski, në Gjevgjeli, në shkurt të vitit 2016, është vërejtur keqpërdorim i të miturve, edhe atë gjatë orës së mësimit. Bashkë me kryetarin e komunës së Gjevgjelisë, Ivan Frangov, Ristovski e lëshoi për përdorim shkollën e riparuar në fshatin Kovanec të Gjevgjelisë. Prerja e shiritit ndodhi gjatë kohës kur mbahej mësim, ndërsa funksionarët u fotografuan me nxënësit.



Unioni i Forcave Rinore i VMRO-DPMNE-së vazhdimisht ka mbajtur mbledhje dhe ka organizuar evenimente, në të cilat ka qenë e obligueshme të marrin pjesë edhe të mitur, edhe atë gjatë kohës së mbajtjes së mësimit. Mësuesit duhet t'i lirojnë nxënësit nga mësimi nëse ata kanë ndonjë obligim me Unionin e Forcave Rinore.

Gjatë kundërprotestave, mësuesit obligohen t'i shkurtojnë orët dhe i dërgojnë nxënësit e tyre të mitur në kundërprotestë. Në lidhje me pjesëmarrjen në kundërprotestë dhe aktivitete të tjera të partive në

pushtet, mbahen lista për evidencë.

Në më shumë shkolla në vend vërehen simbole partiake dhe kolazhe fotografish të funksionarëve partiakë dhe qeveritarë në korridore. Një shembull i tillë është edhe raporti i bashkëpunëtorit të CIVIL-it nga Prilepi, i publikuar më 14 shkurt 2016, me titull Prilep: Propagandë partiake dhe manipulim me të miturit.

RAPORT I VEÇANTË

SHTYPJA POLITIKE MBI SINDIKATAT DHE KEQPËRDORIMI I TYRE NË KONTEKSTIN E ZGJEDHJEVE

Udhëheqësitë e sindikatave qytetare dhe anëtarëve të cilët nuk pajtohen me politikën e “syzeve rozë” të njerëzve të parë të bashkimit ose konfederatës, të cilës i takojnë shumica e sindikatave në Maqedoni, ballafaqohen me shtypje shumë të ashpra. Pjesa më e madhe e këtyre sindikatave qytetare janë themelues ose pjesë e Kartës për Solidaritet, e cila në tre vitet e kaluara është e vetmja, jo vetëm në festimin autentik të Ditës së punës 1 Maj, por edhe në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Ndëshkimet, ofendimet dhe kërcënimet janë dukuri e përditshme në komunikim me institucionet, por edhe në kompanitë private ku funksionojnë organizatat sindikale të një pjese të këtyre sindikatave qytetare, të cilat nuk të vartura prej pushtetit.

Në analizën “Kënetat sindikale”, e shpallur me 25 dhjetor në ueb faqen e CIVIL Media, Sinisha Stankoviç shkruan: “ Unioni i Sindikatave në Maqedoni e përjashtoi dhe me forcë e shpërnguli Sindikatën multietnike të arsimit (MESO) nga objekti i tyre, me çka, pas sqarimit me drejtorinë problematike rajonale të Sindikatës për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SASHK), e cila kërcënohej ta kanalizojë pakënaqësinë e rreth 2.500 anëtarëve të komunës së Manastirit kundër rolit të të dëgjueshmit të dy drejtorive qendrore sindi-


kale në Shkup, dhe pas kurorëzimit të krerëve të rinj pro- VMRO në Manastir, u krijuan kushte për mbyetje të plotë të çfarë do proteste”. Kjo është vetëm ilustrim për shtypjen e fuqishme politike që ushtrohet mbi sindikatat, të cilat nuk janë nën kontrollin e pushtetit.

Ndërrimet në organizatat sindikale bëhen vetëm me direktivë partiake dhe janë të orientuara vetëm drejt “disiplinimit” të punëtorëve në përputhje me interesat partiake të strukturave qeverisëse. Kjo veçanërisht vërehet në sferën e organizimit të administratës publike.

CIVIL ka ndjekur dhe ka shpallur një sërë raportesh për ngjarjet rreth partizimit të Sindikatës për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SASHK). Nga vargu i raportimeve për punën e kësaj sindikate, përfundimi i përgjithshëm është se, në vend se t’i mbrojtë të drejtat e punëtorëve, SASHK manifeston dëgjueshmëri ndaj partisë qeverisëse dhe shërben si mjet për mobilizim partiak dhe kontroll të anëtarësisë.

Pushteti, si dhe një pjesë e kompanive të mëdha, u “lejojnë” punëtorëve të vazhdojnë me aktivitete sindikale, mirëpo në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në zgjedhjen e strukturave udhëheqëse në këto organizata sindikale. Kështu që, gjatë zgjedhjes së udhëheqësive në strukturën më të madhe të Unionit të Sindikatave të Maqedonisë dhe organizatave tjera sindikale, në mënyra të ndryshme, përmes shtypjes partiake, por edhe me shtrembërimin e procedurave, rregulloreve dhe ligjeve, në pozita udhëheqëse vijjnë kuadro të afërt me partinë në pushtet. Këto udhëheqësi, më vonë, në vend se t’i mbrojnë të drejtat e punëtorëve, në fakt, mobilizojnë dhe sjellin vota zgjedhore. “Sindikatat në Maqedoni, pa marrë parasysh nëse janë SASHK ose USM, u ngjajnë nëndegëve partiake”, konstatoi Monika Taleska nga CIVIL në analizën “Roli i turpshëm i sindikatave të Maqedonisë”, e shpallur me 17 prill 2016, pas shumë raportimeve për parregullsi në këtë sferë.

Mes tjerash, në raportimet dhe dëshmitë deri te cilat ka arritur CIVIL në 12 muajt e kaluar, thuhet se liderët e organizatave sindikale gëzojnë automobila luksoze dhe shumë privilegje tjera, si dhe se ekzistojnë edhe shumë tregues tjerë për keqpërdorimin e shumave të mëdha të parave që vijjnë nga kuotat e anëtarësisë të punëtorëve.



**SHPRESAT
DHE DËSHTIMET:
VOTUES TË
REGJISTRUAR,
ZGJEDHËS
FANTAZMA,
& KOMISIONI SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE**

Përgatitur nga ekipet e monitorimit dhe të projektit stafi i CIVIL



VOTUES-FANTAZMA

Komisioni Shtetëror Zgjedhor e shpalli Listën e Votuesve në ueb faqen e tyre me 3 mars të vitit 2016, ku të gjithë qytetarët dhe qytetarët kishin mundësinë t'i kontrollojnë informatat sipas adresës, emrit dhe mbiemrit. Këtë mjet e shfrytëzuan mijëra qytetare dhe qytetarë që të kontrollojnë nëse gjenden në Listën e Votuesve, por edhe të kontrollojnë edhe kush tjetër është i shënuar si votues në adresat e tyre. CIVIL dhe organizatat tjera e përshëndetën gjestin e KSHZ, si mundësi e mirë për pjesëmarrjen qytetare në pastrimin e këtij dokumenti me rëndësi të madhe për kredibilitetin e procesit zgjedhor. Qysh në orët e para, nëpër rrjetet sociale u paraqitën qindra informata për situata fantastike të adresave të një numri të madh qytetarësh dhe qytetarësh. Ata treguan se kanë nga disa dhjetëra "mysafirë", për të cilët nuk kanë ditur. Mbi 300 raportime për parregullsi dhe votues - fantazma arritën në adresën e CIVIL vetëm në shtatë ditët e para pas shpalljes së Listës së Votuesve. Një pjesë prej tyre CIVIL i shpalli edhe në ueb faqen e organizatës. Во продолжение објавуваме само еден дел од овие пријави што ги доби ЦИВИЛ во текот на првото објавување на апликацијата на ДИК од 3 до 28 март 2016 г.

Në vazhdim, do të shpallim vetëm një pjesë nga këto raportime të cilat arritën te CIVIL gjatë shpalljes së parë të aplikacionit të KSHZ prej 3 deri me 28 mars 2016.

S.G. nga Struga paraqiti se në adresën në të cilën jeton, sipas Listës së Votuesve (LV), ka pesë persona që asnjëherë nuk kanë jetuar atje.

L. L. Nga Shkupi paraqiti se sipas numrit amzë mund të gjejë veten në LV, por si votues nuk ekziston në adresën në të cilën jeton.

Në Manastir, në rr. Boris Buxhevski, nr. 25, janë të shënuar dy persona që nuk jetojnë në atë adresë. Personat N.E. dhe N.H. asnjëherë nuk kanë jetuar në këtë adresë dhe askush nuk ka dëgjuar ndonjëherë për ta. Në atë adresë jetojnë T.D., T.O. dhe T.G..

Në rrugën Boris Kidriç, nr. 20 në Resnjë, në të cilën jetojnë T.D. dhe N.O., pas kontrollimit në Listën e Votuesve, vërehet se ka pesë persona që evidentohen në atë adresë dhe se të gjithë kanë mbiemrin e njëjtë. "Si duket një familje pesëanëtarëshe e tërë jeton me ne, ndërsa ne nuk jemi të vetëdijshëm për këtë", thuhet në paraqitjen deri te CIVIL.

"Vërejtja se ka më shumë parregullsi, duke kontrolluar nëse jam në Listën e Votuesve. Në vendvotimin tim nr. 2806, më saktë, në rr. Kozara nr.64 në Shkup, ka të dhëna problematike për banesën nr.2, që është shitur para 5 vitesh, ndërkohë që në listë ende janë pronarët e vjetër T.M. dhe T.L.. Në banesën nr. 3, N.D. dhe G.A. janë shpërngulur dhe jetojnë në adresë tjetër, e njëjta vlen për banorët e banesës nr.8, J.S. dhe J.E. të cilët për më shumë se 10 vite jetojnë në Kanada", shkruan në raportimin e K.V. nga Shkupi.

"Në momentin që vërejtja, u lajmërova në KSHZ, prej aty më udhëzuan të paraqes në MPB, ndërsa ata, serish më udhëzuan të lajmërohem në KSHZ" – shkruan një qytetar nga Shkupi në raportimin deri te CIVIL – " Në rr. Luka Gerov, nr.11, e cila është adresa ime, ka të regjistruar 12 votues, të cilët asnjëherë, në asnjë mënyrë nuk kanë jetuar në shtëpinë time". Për të njëjtën rrugë, në Listën e Votuesve ka edhe një problem, sipas paraqitjes: "Hyrja 3, banesa nr.7. Shtëpia ka dy hyrje dhe jetojnë gjithsej 9 votues, ndërsa janë të regjistruar 21!".

Raportim nga Koçani: " Në rr. Braça Stavrevi, nr. 6, përskaaj familjes katërantarëshe që jeton atje, sipas Listës së Votuesve, në atë adresë ka edhe 4 votues".

"Në adresën në të cilën jetoj gjithë jetën, Çairska nr. 3, në komunën e Çairit, sipas I.S., jetojnë edhe personat B.E. dhe B.S...Rastin e paraqita edhe në zyrat e KSHZ në Çair, prej ku më thanë se do ta përcjellin më tej.", thuhet në raportimin e një qytetari nga Shkupi.

"Vëllai im L.K. është shpërngulur në Kanada nga viti 1987, dhe është shtetas i Kanadasë, Megjithatë, ai ende paraqitet si votues në adresën time, rr. Alesandar Martulkov, nr. 11. Gjithashtu, edhe personi N.K. nga fshati Brajçinë, komuna e Resnjës, i cili e realizon të drejtën e votimit në Kanada, është i regjistruar si votues në Maqedoni", qëndron në raportimin që arriti nga një qytetar i Prespës.

“Jemi të shpërngulur nga Maqedonia në vitin 2001. Në dokumentet tona për identifikim personal qëndron adresë kanadeze. Problemi është se ne ende jemi në Listën e Votuesve. Përveç bashkëshortes V.L dhe meje, A.L., aty është edhe biri ynë B.L. i cili nuk jeton në Maqedoni qysh nga mosha e tij 10 vjeçe. Sipas Listës së Votuesve, jetojmë në komunën Karposh, në Bulevardin Aradhat Partizane, nr.149.”

“Në rr. Boris Kidriç, nr. 49. Në Tetovë, përskaj familjes katërantarëshe që jeton në këtë adresë, sipas I.S., në të njëjtën adresë jeton edhe një familje pesëantarëshe.”, thuhet në paraqitjen që arriti në CIVIL nga Tetova.

“Disa herë kontrollova në LV dhe përfundova se edhe pse jam e regjistruar sipas numrit amzë, në adresën në të cilën jetoj, nuk jam” - raporton një shkupjane.

“Në rr. Krste Misirkov, nr.111, janë të paraqitur gjashtë persona, ndërsa realisht jetojnë katër. Përskaj familjes time, në këtë adresë janë të regjistruar edhe personat G.A. dhe G.G”, qëndron në paraqitjen që arriti në adresën e CIVIL.

“Personat J.T., B.S., A.L., nuk jetojnë dhe asnjëherë nuk kanë jetuar në rr.Trst në Kumanovë. Personi A.S. më shumë se 20 vite jeton në Serbi”, thuhet në një paraqitje nga Kumanova.

Personi R.V., më herët me mbiemër tjetër, fare nuk është regjistruar në LV, as në adresën e tanishme, sipas letërnjoftimit, bul. Jane Sandanski 12/4-13 Shkup, as në adresën e mëparshme në Strugë, rr.Čvetan Dimov nr. 47. Në zgjedhjet e kaluara është bërë tentim të gjendet se në cilin vendvotim figuron, por për fat të keq, pa sukses.

Në rr. Strushki Kepeci nr.21, Strugë, shtatë persona më nuk jetojnë në këtë adresë. Një pjesë prej tyre janë në Australi për më shumë se 30 vite, ndërsa pjesa tjetër në Kanada për 10 vite.

Në rr.Čvetan Dimov nr. 47, Strugë, në Listën e Votuesve është paraqitur një person që fare nuk jeton në atë adresë dhe dy votues të shpërngulur në Kanada.

Në rr. Dimitar Vllahov nr. 34, Strugë, një person, kohë më parë i ndjerë, ende figuron në LV.

Në rr. Frenklin Ruzvelt nr. 64/3, komuna Qendër, Shkup, janë të regjistruar 14 persona, të cilët fare nuk jetojnë në këtë adresë. Në të vërtetë, banesa është e zbrazët, askush nuk jeton në të.

Në rr. Pirinska në Prilep, në vendbanimet me nr. 21 – tre persona, nr.28. – një person, nr. 30- dy persona, nr. 31 – një person dhe nr. 34 – një person, nuk jetojnë në ato adresa, e gjenden në LV.

Në rr. Pere Toshev nr.8 në Prilep, ndërtesë me banesa sociale, e cila ende nuk është e lëshuar në përdorim, në Listën e Votuesve janë të regjistruar 23 votues.

“Ndërtesa në rr. Sava Kovaçeviq, nr. 18 në Shkup, është me 4 banesa dhe është rriemëruar në Hristo Tatarçev nr. 18. Sipas print-skrinëve, janë regjistruar nga 9 banesa me banorë, për të cilët asnjëherë nuk kam dëgjuar, përveç emrit tim dhe të bashkëshortit tim. Në dy print- skrinët e parë në banesën 003 jam unë N.S.-P., por përveç meje janë të regjistruar edhe 4 persona të panjohur me mbiemrin Ivanovski. Bashkëshorti është i zhvendosur, sipas Listës së Votuesve, në banesë tjetër në rr. Hristo Tatarçev, me të panjohurën Suzana Ivanovska.

Me plot përgjegjësi pohoj se në ndërtesën tonë asnjëherë nuk kanë jetuar familjet Ivanovski, Nanevski, Ilijovski, Ackovski, Sazdanovski, Veljanovski, Ilievski”, shkruan një qytetare e Shkupit në raportimin e saj, e cila dërgoi edhe më shumë print- skrinë

Në rr. Koço Racin nr.11, Resnjë, pronari paraqet se në adresën e tij është i regjistruar N.J. por nuk janë në asnjë lidhje, dhe as që njihen. Ka shkuar në stacionin policor në Resnjë dhe i kanë thënë se personi N.J. ka lindur në vitin 1988 në Melburn dhe e kanë udhëzuar ta zgjidhë problemin në njësinë e degës të KSHZ në Resnjë. Aty i kanë thënë se nuk e dinë se si duhet vepruar, sepse nuk kanë udhëzime se si duhet vepruar në raste të tilla.

Në rr. Boris Kidriç, nr.20, Resnjë, janë regjistruar 5 persona që nuk ekzistojnë. Në rrugën e njëjtë, Boris Kidriç nr. 147, Resnjë, (ndërtesë e vjetër me një hyrje të vetme dhe një kat), trashëgimi e G.J., nuk jeton askush tjetër. Në LV paraqiten edhe 5 persona.

Në rr. 18 Nëntori, nr.21, Gostivar, në LV është regjistruar një person që nuk ekziston.

Në rr. Mosha Pijade, nr. 15, Strumicë, sipas Listës së Votuesve, jeton një person, të cilin askush nuk e njih.

“Në adresën tona në rr. 4- Korriku, nr.182, hyrja 02, banesa 008, Kërçovë, vendvotimi 0745/1, në LV është shtuar P.Q. për të askush nuk din gjë. Gjatë kërkimit përmes opsionit “adresa”, në të njëjtën adresë, por në vendvotimin nr.745 gjenden D.J. dhe B.J, derisa në atë adresë janë të regjistruar se votojnë në vendvotimin nr. 745/1, gjenden M.J. nga kjo familje, të cilët, sipas LV, jeton me personin jo ekzistues P.Q”.

Sipas raportimit të një qytetari nga Shkupi, në ndërtesë në komunën Qendër, katër herë gjendet në Listën e Votuesve, edhe atë:

“Në rr.Veljko Vllahoviq, nr, 20, hyrja 1, adresë e vjetër të cilën disa banorë ende e kanë në dokumentet e tyre biometrike. Ndërtesa e njëjtë është e regjistruar edhe për herë të dytë, me adresë: rr. Dimitrie Çupovski, nr. 20, hyrja 1, që është adresë e re, sipas emrit të ndryshuar të rrugës. Kjo ndërtesë paraqitet edhe një herë në Listën e Votuesve si: rr. Dimitrie Çupovski, nr.0020, hyrja1”.

Kjo nuk është e tëra. Ky raportim zbulon edhe probleme tjera me Listën e Votuesve:

“Banesa njëdhomëshe nr.1 figuron edhe si banesa 001 në listën e katërt. Do të thotë, bëhet fjalë për banesën e njëjtë njëdhomëshe, në të cilën, nëse kontrollohen të gjitha 4 adresat, gjithsej janë të regjistruar 31 votues. Gjithashtu, në listë ka edhe së paku 2 të ndjerë në adresën e dytë, banesa 46, edhe atë: M.J. dhe banesa 14: S.T.. Personi V.T. , sipas dijenisë sime, nuk jeton në këtë banesë së paku për 10-12 vite.”

Riemërimi i rrugëve në disa vitet e fundit, paraqet problem plotësues të Listës së Votuesve. Edhe emrat e vjetra, por edhe të rejt, mund të gjinden në LV, shpesh me të dhëna të ndryshme. Gjithashtu, ka nga dy rrugë me emra të njëjtë, ndërsa huti më të madhe shkakton ajo që emri i vjetër i rrugës i është dhënë një rrugës tjetër, në pjesë tjetër të qytetit.

KOMISIONI ZGJEDHOR SHTETEROR... NEN RRETHIMIN E POLITIKES

Optimizmin, të cilin CIVIL dhe një numër i madh i qytetareve dhe qytetarëve e shprehën në fillimin e pastrimit të Listës së Votuesve, e zëvendësoi dëshpërimi. Gati një muaj pas shpalljes, Lista ishte e mbyllur për publikun, ndërsa raportimet e qytetareve dhe qytetarëve nuk merreshin parasysh. CIVIL disa herë tentoi t'i ofrojë resurset dhe ekspertizat, me qëllim të kontribuojë për krijimin e kushteve për zgjedhje të lira, mirëpo KSHZ nuk tregoi interesim as për raportimet për votuesit - fantazma, e të mos flasim për ndonjë bashkëpunim më thelbësor. CIVIL-it nuk iu dha mundësia për prezentimin e zbulimeve, analizave, rekomandimeve, përveç përmes kanaleve të tyre onlajn, ku i paraqitën vlerësimet e qarta për procesin, në kornizat e të cilit zbatohet edhe pastrimi i Listës së Votuesve. Një lajmërim i tillë është "Lista e votuesve nuk është e pastruar, nuk krijohen kushte për zgjedhje të lira", i shpallur me 27 prill, pas mbarimit të kontrollit në teren të KSHZ, kur ky institucion doli me qëndrim se Lista e Votuesve është e pastruar, që ishte larg nga e vërteta. CIVIL atëherë lajmëroi:

Mënyra, cilësia e drejtimit të procesit, të gjitha dyshimet të cilat i shkaktoi puna në Komisionin Shtetëror Zgjedhor, tregon se qytetaret dhe qytetarët me të drejtë nuk kanë besim në këtë dokument. Konstatimi i përgjithshëm është se, edhe nëse Lista Zgjedhore do të pastrohej deri në fund, gjë që nuk ndodhi fare, mungon besimi, e me të edhe kredibiliteti i KSHZ dhe i tërë procesit.

Para së gjithash, kontrollimi në teren i Listës së Votuesve nuk u zbatua në mënyrë, e cila mund të vlerësohet si plotësisht i rregullt, gjë për të cilën e informuam opinionin edhe më herët, në disa raste.

Kontrollimi administrativ që duhej të përfshijë mbi 70.000 persona, e qiti në pah njohurinë se mbi 18.000 persona fare nuk kanë aplikuar për dokumente personale, ndërkohë që gjenden në Listën e votuesve.

Deri tani kemi shpallur njohuri për dy raste, ndërsa me siguri kemi edhe më shumë dhe çdo orë na arrijnë raportime, sipas të cilave kuptohet se në Listën e Votuesve ende ka persona që kanë vdekur qysh gjatë vitit të kaluar, si dhe më herët.

Vite më pas, në proceset e kaluara zgjedhore, personat të cilët kanë qenë të shënuar me yll, që do të thotë se votojnë jashtë shtetit, tani janë vendosur në Listën Zgjedhore sikurse votojnë në vend. Do të thotë, dikush ka vendosur që ta largojë yllin, me çka lejohet hapësirë për dyshim se këtu dikush mund ta keqpërdorë votën e tyre.

Dhe e tërë kjo nuk mjafton. KSHZ, thjeshtë, vendos ta imponojë Listën e tillë votuese si të pastër. Për më tej, në KSHZ votohet në stilin 6:0, ndërsa përbëhet nga nëntë anëtarë. Kush akoma mund të besojë në legjitimitetin dhe kredibilitetin e Komisionit Shtetëror Zgjedhor dhe në Listën e Votuesve? Edhe bashkësia ndërkombëtare, ajo nga e cila shteti kërkoi ndihmë, paraqiti vlerësime të ngjashme si të CIVIL, megjithatë, asgjë nuk mjaftonte.

Përveç gjendjes katastrofale të Listës së Votuesve, CIVIL regjistroi një numër të madh rastesh të kërcënimeve dhe kushtëzimeve, korrupsionit politik, diskriminimit në bazë të përkatësisë politike, mobingut, kontroll të plotë partiak ndaj institucioneve dhe gjendje

të pa ndryshuar të mediave, të cilat në pjesë të madhe janë nën kontrollin e pushtetit.

Si përgjigje, KSHZ dërgoi letër deri te CIVIL, me 4 maj 2016, në të cilën shkruan:

“Komisioni Shtetëror Zgjedhor në tërësi i hedh poshtë dhe i demanton spekulimet dhe kualifikimet e paraqitura nga organizata joqeveritare CIVIL, në lidhje me punën e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, me qëllim të devalvimit të të njëjtit. Apelojmë deri te organizatat joqeveritare të përmbahen nga komentimet dhe shkrimet me qëllim të ndikojnë mbi punën dhe vendimet e organeve zgjedhore gjatë procesit zgjedhor. Komisioni Shtetëror Zgjedhor në këtë përbërje, prej zgjedhjes së tij në vitin 2015, punon me profesionalizëm, me transparencë të plotë, nëpërmjet mbledhjeve publike dhe formave tjera të komunikimit me opinionin publik, si dhe në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Kështu që, i japim vërejtje organizatës joqeveritare CIVIL që t’i përmbahet vetëm Kodit Zgjedhor dhe Kodeksit për vëzhgim të votimeve, si dhe statutit të saj gjatë çfarë do deklaratave lidhur me punën e Komisionit Shtetëror Zgjedhor”.

Ditën e njëjtë, KSHZ dha edhe lajmërim publik me përmbajtje të ngjashme, të cilin CIVIL e shpalli në ueb faqen e organizatës. Pas takimit të strukturave udhëheqëse dhe konsultimeve me ekipin e ekspertëve të CIVIL, u shpall kumtesa “Nuk kemi ndërmend të përmbahemi nga vërejtjet për lëshimet e KSHZ”, e botuar me 6 maj 2016:

Organizata joqeveritare CIVIL vepron plotësisht sipas mandatit, në korniza të rregullave ligjore, për monitorim të gjithmbarshëm procesit zgjedhor në Republikën e Maqedonisë, ku bie edhe përcjellja dhe komentimi i punës së KSHZ. Këtë do ta bëjmë edhe në të ardhmen, me qëllim që Maqedonia të vijë në situatë që në vend të mbahen zgjedhje të lira, fer dhe demokratike, si interes kryesor publik i demokracisë në Maqedoni.

Vitet e kaluara dhe përvojat e këqija treguan se është e domosdoshme përcjellja e vazhdueshme e punës së KSHZ edhe nga sektori joqeveritar, i cili është i specializuar enkas për këtë punë, t’i shmanget përsëritjes së gjendjeve, në të cilat KSHZ ishte dora e vazhduar e partive në pushtet. Në fakt, për parregullsitë dhe për shkeljet e legjislaturës në Republikën e Maqedonisë për momentin po mbahen procedura hetuese me baza të

mëdha të dyshimeve për veprime të rënda penale nga lëmi i krimit të organizuar, e të cilat kanë të bëjnë me shumë procese të kaluara zgjedhore.

Për këtë arsye, nuk kemi ndërmend të përmbahemi nga kallëzimet dhe paralajmërimet për lëshimet në punën e KSHZ.

CIVIL ekziston për mbrojtjen e interesave demokratike të qytetare(ë)ve të Republikës së Maqedonisë, e jo për pëlqimin ose mos pëlqimin nga anëtarët e KSHZ.

*

Çdo gjë që CIVIL tentoi, është të ndihmojë në këtë proces të rëndësishëm dhe delikat dhe, gjatë kësaj, t'i analizojë porositë dhe kërkesat e konstituentëve dhe publikut më të gjerë. Derisa vazhdonte kontrolli në teren, kur në ueb faqen e Komisionit Shtetëror Zgjedhor për një periudhë të shkurtë ishte e shpallur vetëm lista me shënime të dyshimta në Listën e Votuesve, gjë që nxiti edhe debat rreth ligjshmërisë të atij veprimi, deri te CIVIL pandërprerë arrinin raportime dhe paraqitje të cilat dëshmonin për mënyrën se si është zbatuar ky aksion.

Po shpallim një pjesë nga ato raportime dhe paraqitje nga vëzhguesit e CIVIL:

Personi A.GJ. nga komuna e Manastirit, tërë jetën me familjen e tij jeton në shtëpinë, të cilën e ka ndërtuar babai i saj, dhe asnjëherë nuk ka ndërruar vendbanimin. Megjithatë, adresa e tyre është pjesë e listës së regjistrimeve të paligjshme.

Gjithashtu, personi S.V. nga komuna Gjorçe Petrov, qytetar i cili rregullisht voton për 30 vite me radhë dhe asnjëherë nuk ka ndërruar adresën, nuk e ka të qartë sipas cilave kriteret është bërë "i dyshimtë" dhe se si është gjetur në listën e atyre qytetarëve diskutabil, të cilët duhet kontrolluar.

I vetmi qytetar i cili është pjesë e listës për kontrollim në teren, ndërsa në CIVIL është i paraqitur si votues - fantazmë, është personi B.S., i cili sipas Listës së Votuesve është i regjistruar se jeton në rr. "Çairska" në komunën Butel, adresë në të cilën asnjëherë nuk ka jetuar. Raportimet tjera që arritën deri te CIVIL në periudhën e kaluar, nuk janë të

parashikuara për kontrollim në teren.

Shembuj për këtë janë:

Edhe pse komuna e Çairit mban rekordin me më shumë se 17.000 regjistrime jo konsistente, personat R.S. dhe T.M., të cilët sipas paraqitjeve që arritën në CIVIL janë të regjistruar në adresa në të cilat asnjëherë nuk kanë jetuar, nuk janë pjesë e kontrollit.

Personat P.I. dhe M.I., për të cilët pranuam paraqitje se asnjëherë nuk kanë jetuar në f. Slloeshticë, nuk janë pjesë e listës së regjistrimeve jo konsistente, të cilat do të kontrollohen në teren.

K.D. dhe K.V. për të cilët pranuam raportim se sipas Listës së Votuesve janë të regjistruar në rr. "Kuzman Josifovski" në Prilep, në shtëpi të braktisur, nuk janë pjesë e listës së regjistrimeve që do të kontrollohet në teren.

N.M, për të cilën në CIVIL mori informatë se edhe pse ka vite që ka vdekur, ende gjendet në Listën e Votuesve, me adresë në komunën Karposh, nuk është pjesë e kontrollit në teren nga KSHZ.

Në rr. "Partizanska" në Strugë, sipas Listës Zgjedhore, janë të regjistruar pesë persona, të cilët asnjëherë nuk kanë jetuar aty. Asnjë nga ato persona nuk janë të paraparë për kontroll në teren.

Këto janë vetëm një pjesë e vogël e paraqitjeve që arritën në CIVIL, e të cilat nuk janë pjesë e listës me regjistrime jo konsistente që kontrollohen në teren.

Kjo tregon se lista që e ka përgatitur KSHZ, pas kontrollit të kryqëzuar, ka qytetare dhe qytetarë që nuk duhet të jenë në atë listë, dhe e kundërta, votues diskutabil të cilët ishin të paraqitur, e për të cilët nuk është paraparë kontrollim në teren.

PËRFUNDIM

Në fillimin e procesit të revizionit dhe pastrimit të Listës Zgjedhore, Komisioni Shtetëror Zgjedhor u lajmërua me numër të njësuar prej mbi 330,000 votuesve të dyshimtë, që pastaj si lëndë për kontrollim në teren të jenë vetëm 83.680 qytetarë.

Pas mbarimit të kontrollimit në teren, KSHZ u lajmërua me dy raportime të ndryshme, të cilat tregojnë se është krijuar kaos në të dhënat dhe në punën e këtij institucioni. Prej një raportimi të KSHZ kuptohet se në 6.366 pyetësorë fare nuk ka përgjigje në pyetjen nëse anketuesi personalisht është takuar me personin, i cili ka qenë qëllim i kontrollimit në teren. Në raportimin e dytë, dallimi mbi bazë të kësaj çështjeje është drastik: 10.436 pyetësorë nuk kanë përgjigje për të njëjtën pyetje.

Për më tej, KSHZ në një raportim lajmëron se fizikisht mungojnë 282 pyetësorë, ndërsa sipas raportimit të dytë, mungojnë 414 pyetësorë.

Sipas raportit të KSHZ, në 1.043 adresa nuk ka jetuar askush, për 1,730 persona nuk ka kurrfarë informata, 2,945 persona nuk kanë qenë prezent gjatë kontrollimit, 8,878 persona në momentin e kontrollimit kanë qenë jashtë shtetit, 5,093 persona janë shpërngulur në adresa tjera në Maqedoni, 523 persona kanë vdekur, 36 persona nuk kanë të drejtë votimi, 8, 351 persona janë të vendosur nën pikën "të tjera".

Gjatë kontrollimit të adresave në teren, kuptohet se 26 nga ato kanë qenë adresa të administratës publike, në 15 adresa nuk ka pasur objekt ose ka qenë i rrënuar, 13 objekte kanë qenë në fazë të rrënimit, por ka pasur përgjigje se adresa të caktuara fare nuk ekzistojnë, gjegjësisht, nuk kanë ekzistuar banesa të caktuara nëpër ndërtesa.

Pas gjithë kësaj, KSHZ votoi raportin, sipas të cilit Lista e Votuesve është e pastruar dhe e gatshme për zgjedhje.

Në qershor të vitit 2016, KSHZ, megjithatë, e hapi Listën e Votuesve dhe lajmëroi se revizioni i Listës së Votuesve do të vazhdojë.



POLITICAL ANALYSIS

**ZGJIDHJE E KRIZËS
MAQEDONASE
KURDISJA E
ZGJEDHJEVE NË STIL
KORPORATIV**

Dr. Sasho Ordanoski



Që nga mëvetësia e vitit 1991, “dredhimi” i rregullave zgjedhore dhe kurdisja e zgjedhjeve u bënë relativisht praktikë gjithandej e shpërndarë në Maqedoni, që trajtohet si pjesë e folklorit politik dhe si mangësi demokratike e pashmangshme, e madje edhe e pranuar, tipike për një shoqëri postkomuniste.

Mirëpo, pas skandalit me përgjimet në fillim të vitit 2015, u bë e qartë se kurdisja e zgjedhjeve në disa vitet e fundit është shndërruar në aktivitet kundërligjor me përmasa gjigante, duke e pasur parasysh qarkun e atyre kurdisjeve, vëllimit të tyre dhe themelin e metodave të zbatuara.

Frikësimet e zakonshme të votuesve, kërcënimet e herëpashershme, trajtat e ndryshme të korrupsionit zgjedhor, gjuha e urrejtjes dhe propaganda agresive, shumëllojshmëria e keqpërdorimit të pushtetit dhe të institucioneve shtetërore, votimi për të tjerë apo për ata që nuk janë këtu, gjegjësisht falsifikimet sporadike – gjithë ajo ishte ngritur në një nivel më të lartë, si pjesë përbërëse e një sistemi të koordinuar në mënyrë precize veprimesh të planifikuara dhe të zbatuara. Po që se ndonjëherë partitë politike kanë qenë kryerësit kryesorë të veprimeve të paligjshme, tani realiteti i pakënaqshëm tregon se vetë shteti, me institucionet dhe resurset e tij, është bërë qendra e gërryerjes së vlerave dhe praktikave themelore të demokracisë.

Në pjesën e aktiviteteve të tyre të rregullta, si organizatë joqeveritare prodemokratike, vëzhguesit zgjedhorë, hulumtuesit dhe analistët e CIVIL-it hulumtonin dhe shënonin shumë parregullsi përgjatë zgjedhjeve lokale në vitin 2013, ashtu si edhe përgjatë zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në vitin 2014. Mirëpo, shpërfaqja e parregullsive vazhdimisht shpërfillëshin nga ana e institucioneve shtetërore dhe u kontestuan nga aparati i nxehtë propagandues të partisë në pushtet, VMRO-DPMNE. Madje edhe ato keqpërdorime e shkelje të rregullave zgjedhore që ishin më shumë se të dukshme kanë qenë vazhdimisht të mohuara nga organet shtetërore kompetente. Shpërfillëshin faktet, njoftimet zbrazeshin, kurse propozimet për përmirësim të gjendjeve refuzoheshin. Mirëpo, tash e dimë pse! Shumë prej atyre që duhej të reagonin, me detyrim zyrtar, gjendeshin ndër kryerësit kryesorë në zinxhirin sistematik dhe sistemor të vënë të veprave penale edhe në fushën e aktiviteteve zgjedhore.

Skandali i prëgjimeve dhe pasojat shoqëro-politike prej tij Kontroversiteti i tërësishëm me përgjimet të bisedave telefonike dhe ndjekja e komunikimeve të tjera të qytetarëve maqedonas në politikën maqedonase mund të lërë shumë pyetje të papërgjigjura në lidhje me rrethanat e ndërlikuara politike, juridike dhe institucionale të kësaj afere turpërore.

Megjithatë, ky rekonstruim detal publik i të punuarit të paligjshëm i drejtorisë maqedonase “telekomunikative” të shërbimit të fshehtë policor paraqet mundësi të rralë për shqyrtim të thellë në atë se si ka ndodhur që demokracia në Maqedoni të kidnapohet dhe të harxhohet kot nga një grup relativisht i vogël i eshalonit më të lartë të pushtetit shtetëror.

Me mbi 400 biseda të publikuara, në të cilat dominojnë funksionarë të lartë në qeverinë e liderit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski – duke e përfshirë edhe vetë Gruevskin! – opinionit maqedonas iu ofruar një mundësi e rrallë për ta vëzhguar, përmes “zërave origjinalë” të aktorëve kryesorë, korrupsionin e paturp, keqpërdorimin e funksioneve, ashtu si edhe shmangien e përgjegjësisë publike nga ana e atyre funksionarëve të cilëve iu është besuar mirëqenia e vendit në pjesën më të madhe të dekadës prapa nesh. Legjendat për të cilat mendonim se e dinim se janë të vërteta, menaxhimi i keq për të cilin dyshonim se është bërë, marrëdhëniet për të cilat supozonim se ndodhnin, ashtu si edhe organizatorët e aktiviteteve kriminale për të cilat asnjëherë nuk kuptuam se me të vërtetë ekzistojnë – e gjithë kjo tash është pjesë e përvojës maqedonase kolektive politike. Pasojat juridike shikohen përmes orarit shumë të zënë të zyrës së Prokurorisë Publike Speciale – një institucion i krijuar ad hoc si rezultat i mosfunksionimit të Prokurorisë Publike të korruptuar – që ka për rezultat dhjetëra fletëparaqitje penale kundër bashkëpunëtorëve më të afërt partiakë dhe shtetërorë të Gruevskit, si dhe kundër vetë atij.

Duke e marrë parasysh krejt këtë që është botuar, politika maqedonase asnjëherë më nuk do të jetë e njëjtë.

Sistemet jodemokratike i përdorin shërbimet e policisë sekrete jo për të menaxhuar proceset politike, biznesore e shoqërore në shtet përmes shpërndarjes së informa-

cioneve dhe debateve për vlera shoqërore e ide, po për kontroll të drejtpërdrejtë mbi njerëzit – manipulimi me njerëzit shpie në manipulim të proceseve shoqërore. Në skandalin e tanishëm është e qartë se operacioni i sekret për kontrollim të qytetarëve është shndërruar në aktivitet grandioz kundërligjor: që nga viti 2009/2010 e këtej, janë ndjekur biseda të më shumë se 26.000 personash, me përdorim të teknologjisë më bashkëkohore për përgjim të marrë nga Izraeli.

Mijëra persona qenë gjetur në listën e të dyshuarve, duke i përfshirë të gjithë përfaqësuesit opozitarë, gazetarë, biznesmenë, si dhe aktivistë qytetarë, njerëz të institucioneve akademike dhe diplomatë të huaj. Shumë veta prej autorëve të këtij Raporti, si dhe aktivistë të sektorit civil, rregullisht dhe me kujdes qenë ndjekur me vite.

Të gjithë partnerët e koalicionit të qeverisë, pa edhe funksionarët më të lartë (e më të ulët) të VMRO-DPMNE-së, së bashku me ministrat dhe bashkëpunëtorët e tyre (si dhe partnerët e tyre martesorë) gjithashtu kanë qenë në listën e vëzhgimit elektronik, me përjashtim të dy familjarëve: kryeministri Nikolla Gruevski dhe kushëriri i tij, shefi i policisë sekrete, Sasho Mijallkov.

Ajo që dihet deri më tani është se janë mbi një milion biseda telefonike private e zyrtare midis një numri të madh njerëzish që janë përgjuar – ndër të cilët janë edhe bisedat e atyre që kanë komunikuar Gruevski dhe Mijallkov – dhe siç është rendi janë arkivuar në një bibliotekë meta të dhënash në shërbimin sekret. Qindra biseda në mënyrë statistikore dhe përmbajtësore janë analizuar në bazë ditore, që ka rezultuar me aktivitete operative të vazhdueshme të shërbimeve të destinuara për gërryerje të opozitës politike në shtet, por edhe për nevojën për kërcënim të individëve, reketim të bizneseve, kurdisje të zgjedhjeve, bashkërendim të aktiviteteve propoaganduese proqeveritare dhe për kontrollim të tendencave shoqërore që do të mundnin ta binin në pikëpyetje politikën e regjimit.

Ky sistem i paligjshëm i vëzhgimit të kundërzbulimit rezultoi me zgjerim të pushtetit politik dhe ekonomik të rrethit rreth Gruevskit ("Familjes"), jashtë të gjitha pritjeve. Mirëpo, praktikat e këtilla, në anën tjetër, shpuren në dobësim të instikteve të tyre normale politike dhe të ndjesisë elementare të realitetit. Pjesëtarët e "Familjes"

bëheshin gjithnjë e më shumë të varur nga metodat për kontroll të zbatuar nga shërbimet sekrete dhe, pashmangshëm, hynë në botën e saj të realitetit virtual.

Qërim hesapesh në sipërfaqen e rrethit

Prej këtu, nuk është për befasi që zbardhjen e këtij skandali, në muajt e parë të vitit 2015, e shkaktoi sipas të gjitha gjasave kriza më e thellë politike e vendit që prej



Kumanovo, May, 2016

mëvetësisë së saj. Nga fazat fillestare të këtyre ndodhive në vitin 2015, regjimi i Gruevskit po tenton të minimizojë pasojat e skandalit përmes aktiviteteve të ndryshme politike dhe proganduese.

Në këtë kuptim, duket se pushteti kuan madje edhe në "kartën e sigurisë", kur në maj të vitit 2015, nën rrethana tërësisht të pashpjeguara, u luajt intervencë policore kundër një grup militantësh kriminelësh shqiptarë etnikë në një lagje në

qytetin e Kumanovës. Aksioni rezultoi me debakëll të sigurisë: pas një qërimi hesapesh gjithëditor, u vranë 22 persona, duke përfshirë tetë pjesëtarë të forcave policore speciale, me edhe dhjetëra të lënduar nga të dyja palët. Të dy bashkëpunëtorët më të afërt të Gruevskit – ministrja e punëve të brendshme Gordana Jankullovska dhe kushëriri i tij, shefi i shërbimit sekret – Mijallkov – dhanë dorëheqje disa orë pas përfundimit katastrofal të incidentit.

Megjithatë, edhe përkundër "lojës me armë" nga ana e regjimit, pjesë gjithnjë e më e vogël e opinionit publik maqedonas mund të frikësohet apo hutohet: nëpër një numër të madh qytetesh maqedonase që nga fillimi i vitit të kaluar filloi të zhvillohet një valë

e pakënaqësisë qytetare, që përfshinte një pjesë domethënëse të shoqërisë civile maqedonase, që kulminon me protestën më të madhe që qe organizuar deri atëherë në Shkup, më 17 maj 2015. U tubuan dhjetëra organizata qytetare multietnike, të prira nga LSDM-ja. Vetëm në atë ditë, më shumë se 60.000 njerëz kërkuan dorëheqje nga qeveria, zgjedhje të parakohshme dhe pasoja juridike për të gjithë që qenë të kyçur në skandalin e bisedave të përgjuara. Kriza tashmë nuk mundej të shpërfilllej.

Më tej, procesi i bisedimeve për tejkalim të krizës politike, që u mbajt në rezidencën e ambasadorit të BE-së në lagjen shkupjane Përzhinë rezultoi me marrëveshje politike, që u nënshkrua më 2 qershor dhe plotësuar më 15 korrik 2015, i menduar si platformë politike për zgjidhje të krizës. Mirëpo, në vend të tij të tri palët që qenë kyçur në procesin e bisedimeve – koalicioni maqedonaso-shqiptar në pushtet; LSDM-ja opozitare; dhe ndërmjetësit euro-amerikanë ndërkombëtarë, të udhëhequr nga komisar i Komisionit Evropian – Johanesh Han – në fakt, kanë agjenda të ndryshme dhe korniza të ndryshme kohore për zgjidhje të krizës.

Në atë kohë, koalicioni në pushtet ishte i interesuar të bëhen sa më shpejt që është e mundur zgjedhjet, me ç'gjë do të përtërihej legjitimiteti i tyre politik, me minimalizim të çfarëdo reforme politike që eventualisht do të rezultonte në qeverisje më të madhe të së drejtës dhe në institucione kredibile në shtet, me ç'gjë do të vihej pushteti i tyre në pikëpyetje. Në anën tjetër, opozita ishte e interesuar për reforma gjithëpërfshirëse politike, për ç'gjë duhej një tempo më e ngadaltë e ndodhive, me qëllim që të instalohet sundim i së drejtës i duhur për ta ndërprerë trendin e edhe një palë zgjedhjesh të falsifikuara. Bashkësia ndërkombëtare donte reforma politike që do të shpiejnë në zgjedhje për të formuar qeveri, që do të ishte sa më legjitime dhe e cila do të vazhdonte me reformat politike në vend në përputhje me sundimin e së drejtës, por pa kushtuar mjaftueshëm kohë dhe resurse të kërkuara nga opozita.

Me qasje të këtilla të pasinkronizuara, filloi garë ndërmjet parimeve juridike dhe politike në zgjidhjen e krizës, kurse frustracionet nga ai proces rriteshin në të gjitha anët e kyçura. Duke shpejtuar, koalicioni qeverisës, që nuk donte ta rrezikojë përtëritjen e besueshme e listës zgjedhore, e as ta ngadalësojë kontrollin mbi mediumet dhe sërish

të vëre pavarësi të institucioneve kyçe nga kontrolli i madh partiak, duhej dy herë ta shtyjë datën e zgjedhjeve, të cilat patën qenë njëanshmërisht të caktuara prej tyre më 24 prill dhe më 5 qershor 2016. Qeveria u përball me bojkotimin e zgjedhjeve të caktuara ashtu nga të gjitha partitë opozitare në vend dhe me mospajtimin e fortë nga ana e shoqërisë civile, duke i përfshirë edhe kërkesat e shumta të CIVIL-it të bazuara në raportet nga terreni dhe analizat gjithëpërfshirëse për mosgatishmërinë e një procesi të drejtë zgjedhor. Opozita vendosi të bëjë rezistencë të vazhdueshme, po të qetë ndaj qeverisë, duke u thirrur në përkrahjen e qindra qytetarëve maqedonas që panë mundësi për t'u marrë kontrolli nga duart e koalicionit qeverisës në të cilin ata tashmë nuk kishin besim. Për atë duhej shumë kohë dhe nerva, ashtu si edhe resurse. Gjithashtu, e gjithë kjo shpiu edhe në shumë moskuptime me aktorët ndërkombëtarë, të cilët këmbëngulnin në atë se është më së miri institucionet zyrtare ta udhëheqin këtë proces – institucionet e njëjta që u zbuluan se janë tërësisht të korruptuara dhe joefikase.

Gjithçka bëhej me tempon e valleve popullore maqedonse: tri hapa përpara, dy mbra-pa...

Disi, të gjitha ndodhitë po sillen rreth punës së zyrës së prokurorisë publike speciale, që u bë institucioni i vetëm në vend që, pas themelimit të saj në fund të vitit 2015, vazhdimisht ka rejting publik më të madh se cilado parti politike, politikan apo ndonjë organ tjetër shtetëror. Imazhi i kësaj zyre edhe më shumë u forcua me pamaturinë politike të presidentit maqedonas Gjorge Ivanov, i cili harxhoi dy muaj të shtrenjtë të kohës së duhur për zgjidhje të krizës, me faljen e 56 personave, pjesa më e madhe prej tyre ishin funksionarë qeveritarë (duke e përfshirë edhe vetë Nikolla Gruevskin) dhe ndihmësit e tyre joqeveritarë, për të cilët bëhej hetim apo për të cilët presidenti kishte supozuar se janë të dyshuar nga ana e prokurorisë publike speciale – që pastaj atë vendim të vetin presidenti do ta shfuqizojë gjithashtu befasisht, ashtu siç ishte marrë! Me këtë gjest të tij, u duk se presidenti tërësisht e humbi legjitimitetin e vet modest dhe përkrahjen për disa aspekte nga opinioni i gjerë maqedonas, me ç'gjë u bë pjesë e problemit politik, e jo pjesë e zgjidhjes. Përveç kësaj, këtë incident të ri politik e mbolli

prokuroria publike speciale në zemrat dhe vetëdijet e qytetarëve, si institucion i vetëm që e teston fuqinë e formuar të pushtetit.

Reagime të shoqërisë qytetare

Që prej se u formua qeveria nacionaliste-konservative e VMRO-DPMNE-së bashkë me partnerët e koalicionit – shqiptarët etnikë në korrik të vitit 2006, filloi dekada e

periudhës më sfiduese për mbijetesën e shoqërisë civile të pavarur politikisht e aktive në Maqedoni. Politikat konservative populiste të kësaj qeverie gjithnjë e më autoritare që nga viti 2009 e këtej, me ç'gjë në mënyrë dramatike u ngushtua liria e shprehjes dhe liria e medimeve, kurse u shkatërrua edhe autonomia e aktiviteteve politike kritike në vend, duke i përfshirë edhe aktivitetet e sektorit civil të pavarur.



Colorful Revolution protest, June 6, 2016

Protestat për shkak të shtypjeve të forta të shtetit merrnin intensitet, veçanërisht pas zbulimit të skandalit për përgjime. Përgjatë vitit 2015 u shfaq mobilizim i fortë në kuadër të sektorit civil në Maqedoni. Plenumet studentore dhe të shkollarëve të mesme organizoheshin me një të madh profesorësh të vet. Me ta bashkëngjiteshin gazetarë dhe organizata mediumore, organizata të ndryshme joqeveritare, një pjesë e sindikatave zyrtare, një numër i madh individësh nga bota e artit dhe shkencës, si dhe aktivistë politikë, të gjithë së bashku të tubuar në rrugë në protesta më të vogla e më të mëdha në kryeqytet, ashtu si edhe në një varg qytetesh të tjera në vend – përditë. Frika dominuese e dikurshme dhe shqetësimi që mbretëronte te qytetarët shpejt u

ndërrua me padëgjueshmëri qytetare dhe mospajtim i hapur me politikat dhe praktikat qeveritare.

Në pjesën e parë të vitit 2016, këto protesta morën domethënie ideologjike, kur mblihdeshin rreth lëvizjes që veten e quajti Revolucioni i Larmë. Lëvizja u ngre nga aktivistë qytetarë me përkrahje të aktivistëve juridikë të prokurorisë publike speciale, punë e të cilëve vazhdimisht sabotohej nga ana e regjimit. Revolucioni i Larmë është lëvizje e organizuar horizontalisht që i koordinon aktivitetet e veta përmes rrjeteve sociale, pa ndonjë lidhshmëri të dukshme apo strukturë organizative të pashme. Në qendër të vëmendjes së Revolucionit të Larmë janë thirrjet për përgjegjësi juridike për të gjithë ata që janë të kyçur në aktivitete të paligjshme në shoqëri.

Aparati propagandistik shtetëror nuk kurseu kohë, përpjekje a resurse, për të "dëshmuar" se kjo lëvizje është rezultat i "konspiracionit perëndimor", të udhëhequr nga Xhorxh Soros, me qëllim të mposhtjes së "qeverisë legjitime" në Maqedoni. Pothëj se ajo paraqet lëvizje në stilin e Revolucionit të Portokalltë, tipike për nisma të ngjashme qytetare që po shpërndahen në vitet e fundit në Tunizi, Egjipt dhe Ukrainë. Përmes aparatit propagandues shpërndaheshin teori të marra konspirative e spekulime, ashtu si edhe sulme personale ndaj pjesëtarëve më aktivë të lëvizjes me qëllim që të diskreditohej Revolucioni i Larmë. Megjithatë, këta aktivistë qytetarë nuk i zbythi propaganda e regjimit, e as që u shkurajuan nga ana e forcave policore masive në rrugët apo përmes arrestimeve të shumta e akuzave të parashtruara nga ana e autoriteteve: nga 12 prilli i vitit 2016 e këtij thujse çdo pasdite mijëra njerëz përpara ndërtesës ku gjendet prokuroria publike speciale në Shkup dhe fillojnë marsh protestues nëpër qendër të qytetit; gjuhët me bojë nëpër fasadat e ndërtesave të institucioneve shtetërore dhe përmendoret që dolën në kuadër të projektit të ashtuquajtur "Shkupi 2014", që e simbolizon fuqinë politike të korruptuar të regjimit të korruptuar të Gruevskit.

Ajp që filloi me disa qindra njerëz, përgjithësisht të rinj, që protstojnë në Shkup, shpejt u rrit në mijëra njerëz që marshojnë përditë nëpër kryeqytet, ashtu si edhe në nja njëzet qytete nëpër gjithë Maqedoninë. Dalëngadalë, edhe opozita e tregoi praninë

e vet më të fortë në protesta, edhe pse ajo këmbëngul të mos përfshihet shumë në agjendën e aktiviteteve konkrete në protestat e Revolucionit të Larmë. Ky sezon i protestave qytetare pranverore në Maqedoni kulminoi më 20 qershor, me protesta të mëdha me rreth 30.000-40.000 njerëz në Shkup, duke i stërbushur rrugët dhe sheshet para ndërtesave të Qeverisë dhe Kuvendit. Protestuesit kërkonin rënie të regjimit, shfuqizim të të gjitha obstrukcioneve të prokurorisë publike speciale dhe zbatim të së drejtës së të gjithë atyre që janë të kyçur në aktivitete kriminale në dekadën e fundit të pushtetit demokratikisht të deformuar të Gruevskit.

Efekt i përhershëm mbi shoqërinë civile

Ngjarjet e këtilla sipas të gjitha gjasave do të lënë mbresë të fortë mbi një pjesë të madhe të organizatave qytetare në vend edhe në vitet e ardhshme. Për herë të parë në dy dekadat e gjysmë të fundit, pjesëtarë të shoqërisë qytetare në Maqedoni ishin me kuptimin e plotë të fjalës të larguar nga zyrat e vet komode dhe të qitur në rrugë, duke ia nisur me funksionim politik eksplicit. Ata hapur kundërshtojnë regjimin agresiv dhe makinerisë së tij frikësuar, politik, policor dhe propagandues.

Sa i përket zhvillimi të sektorit civil në vend, raporti i fundit vjetor i Komisionit i Komisionit Evropian për përparimin e Republikën e Maqedonisë , i publikuar në fund të vitit 2015, thotë se "organizatat qytetare kanë luajtur rol konstruktiv në kontekst të krizës, përmes kërkesës së raportueshmërisë nga aktorët politikë. Në të njëjtën kohë, ata shprehën shqetësim për shkak të vështirësive me të cilat përballen në punën e tyre dhe angazhimin e kufizuar për dialog të pushteti, si dhe për shkak të sulmeve publike nga politikanë dhe medime proqeveritare".

Shoqëria civile maqedonase, që e përbëjnë rreth 4.000-5.000 organizata aktive, është e zhvilluar në mënyrë mesatare dhe e ndjek procesin "nisu – ndalu" të demokracisë dhe tranzicionit socioekonomik maqedonas në 25 vitet e fundit. Të përballur me tendenca të forta kundërdemokratike të pushtetit aktual në Shkup, një numër i madh i organizatave joqeveritare në vend reagues në mënyrë energjike dhe morën qëndrim të fortë politik prodemokratik, duke i zgjeruar aktivitetet e tyre për rrjetëzim në fushën e përkrahjes dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Kjo shkaktoi nevojë për mirëkuptim më të

madh të rolit të shoqërisë civile në konsolidimin demokratik dhe reformat urgjente në sistemin politik në Maqedoni, veçanërisht në fushën e zgjedhjeve të lira dhe të drejta, në lirinë e shprehjes dhe nevojës për departizim të institucioneve shtetërore dhe organeve të pavarura rregullatore dhe vëzhguese. Si rezultat i gjithë kësaj, për këtë trend do të duhen lidhje të forta ndërmjet organizatave qytetare dhe bazës së tyre qytetare, ndjesi më të madhe të solidaritetit dhe rrjetëzimit në sektorin civil, ashtu si edhe bashkëpunim të fortë ndëretnik.

Megjithatë, zhvillimi i këtyre po zhvillohet paralelisht me eskalim të vështirësive financiare, si rezultat i numrit të vogël të donatorëve bilateralë dhe varshmëria e rritur nga fondet e BE-së; edhe pse fondet e BE-së ofrojnë më shumë resurse, shumica e organizatave lokale civile, për fat të keq, nuk e kanë kapacitetin që duhet për t'u përmbushur kriteret e duhura të ndërlikuara që i kanë këto fonde.

Ekziston nevojë për zhvillim të modeleve alternative për tubim të mjeteve që përfshijnë prani më të madhe nga qytetarët dhe prej bizneseve, ashtu si edhe nxitjen e potencialeve të bashkësisë lokale filantropike.

Qëkur kjo qeveri e VMRO-DPMNE-së do të largohet nga skena, do të duhet të ndërmerren nisma të rëndësishme për "përshtatje" të mëtutjeshme të politikës tati-more ndaj sektorit civil, për stimulim të më shumë lehtësimeve tati-more (veçanërisht për donacione nga individë) dhe të donacioneve më të mëdha nga kompani private. Paralelisht me atë, do të duhet edhe sistem më transparent, më i drejtë dhe më i përgjegjshëm i financimit shtetëror i drejtuar kah sektori civil në vend.

Domethënie e rritur e sektorit civil

Që tani është e qartë se, gjithashtu, do të duhet të përmirësohen marrëdhëniet ndërmjet shtetit (si në nivel të pushtetit nacional, ashtu edhe në atë lokal) dhe sektorit civil. Pas trajtimit shumëvjeçar të sektorit civil si armik, cilado qeveri do të duhet të jetë e gatshme ta përtërijë besimin e humbur reciprok dhe ta kyçë këtë sektor si aleat dhe si pjesë e domosdoshme të mbrojtjes së demokracisë së shëndoshë në Maqedoni. Korniza e vazhdueshme institucionale për dialog ndërmjet pushtetit dhe sektorit civil nuk po funksionon dhe po zbatohet në mënyrë joparimore. Përmirësimet e kësaj

kornize duhet të bëhet në përputhje me parimet e bashkëpunimit horizontal, në vend të hierarkisë vertikale, në të cilat aktorët qeveritarë dhe aktorët e shoqërisë civile do t'i plotësonin përpjekjet në fushën e bashkëpunimit. Me këtë do të avancohej qeverisja demokratike në nivel nacional dhe lokal, përmes kultivimit të trupit konstituv të sektorit civil, me qëllim që të përmirësohet legjitimiteti dhe redibiliteti i organizatave joqeveritare. Gjithashtu, do të rriten edhe aktivitetet vullnetare, do të forcohet ndjesia e vlerave dhe solidaritetit ndërmjet qytetarëve dhe sektorit civil dhe se do të zgjerohej hapësira për rritje të shërbimeve sociale që do t'i ofrojnë organizatat joqeveritare, e do të pranohen nga ana e autoriteteve.

Kapaciteti organizativ paraqet një nga aspektet më të dobëta të sektorit civil maqedonas, duke e përfshirë edhe planifikimin strategjik, menaxhimin, aftësitë për tubim të mjeteve, resurset teknike, kuadri (pjesa më e madhe e punësimeve në organizatat joqeveritare ende bëhen në bazë të angazhimit me projekt) etj. Ekziston nevojë e dukshme për profesionalizim më të madh të rganizatave joqeveritare.

Për t'u arritur këto përmirësime në sektorin civil duhet të ekzistojë arsimim më i mirë civil te popullata më e gjerë. Njohuri më të shumta dhe vetëdije e përgjithshme në aspekt të rregullave zgjedhore e procedura do t'i parandalonin përpjekjet e këqija për mashtrime zgjedhore. Nevoja e këtillë i bën organizatat joqeveritare, siç është CIVIL-i, pjesë integrale të procesit të vënie të sërishme të zhvillimit të mëtejshëm të demokracisë maqedonase. Portfolioja e pasur e aktiviteteve të tanishme të CIVIL-it, duke i përfshirë të gjitha metodat bashkëkohore të vëzhgimit dhe zgjedhjeve dhe demokracisë, informimi dhe avancimi i shoqërisë civile, paraqet mode për kyçje qytetare konstruktive, relevante dhe më të madhe në Maqedoni.



#Free elections - YES! Electoral theft - NO!
CIVIL press conference, in front of the Parliament, April 6, 2016

ANALIZË JURIDIKE [1]

CIVIL NË BETEJË PA KOMPROMIS PËR LIRI DHE DEMOKRACI

Sandra Gavrillovska

Kriza

më serioze politike e defnuar (në Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2015), e iniciuar nga skandali me numrin e madh të bisedave të përgjuara nga ana e pushtetit aktual, gjegjësisht, e iniciuar nga shpallja e komunikimeve mes funksionarëve të lartë shtetërorë nga ana e opozitës, mes tjerash, sugjeroi shkeljen e të drejtave themelore të njeriut, përzierje në pavarësinë e gjykatës, rrezikimin e lirisë së mediave dhe zgjedhjeve, si dhe ekzistimin e rrjeteve të zhvilluara të korrupsionit.

Në periudhën e kaluar, demokracia në Maqedoni (demokracia e fituar dhe e trashëguar nga viti 1944, dhe e rivendosur në vitin 1991), vazhdimisht ballafaqehet me probleme serioze, të cilat në vitin 2015 më në fund rezultuan me diagnozë të rrezikshme për një shtet demokratik (jo) të zhvilluar – krizën më serioze politike nga viti 2001.

1. DIAGNOZA

Demokracia e brishtë e Maqedonisë dhe sundimi autokratik që vazhdon pothuajse një dekadë, seriosisht e rrezikoi dhe destabilizoi gjendjen politike dhe gjendjen e të drejtave njerëzore në Republikën e Maqedonisë, posaçërisht në periudhën e zgjedhjeve lokale në vitin 2013, gjatë zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2014, si dhe gjatë negociatave politike në vitin 2015 dhe gjatë krizës aktuale politike.

Mes shumë problemeve tjerë të detektuar, të cilët pa dyshim se ndikuan në ambientin demokratik në Maqedoni dhe të njëjtin e deformuan deri në shkallë të realitetit të sh-trembëruar ose të iluzionit, në veçanti ishin edhe:

- Sundimi partiak (në vend të atij politik), në të gjitha sferat e jetesës dhe veprimit sho-qëror
- Administrata partiake (e partizuar)
- Gjykata e korruptuar
- Manipulimet zgjedhore dhe parregullsi (në vend të proceseve fer dhe demokratike zgjedhore)
- Shkelje dhe abuzim (në vend të respektimit) të të drejtave dhe lirive të njeriut
- Thyerje (në vend të zbatimit) të ligjeve
- Sundimi i represionit (në vend të sundimit të drejtësisë)
- Informimi i kontrolluar të mediave (në vend të informimit të lirë, objektiv dhe të pa-varur).

Kontributi plotësues për dobësimin e demokracisë veç më të dobët dhe anemike, pati efektin domino të bisedave të përgjuara, të cilat e paralajmëruan pranverën e Maqedonisë, e ato ishin protestat e studentëve, honoraristëve, të nxënësve të shkollave të mesme, të gazetarëve, të qytetarëve, protestat për drejtësi, demokraci dhe liri, protestat kundër brutalitetit policor, protestat për ajër të pastër...ose, të gjitha me një emër – protesta kundër pushtetit aktual.

2. TERAPIA

Ideja dhe nevoja e domosdoshme për dalje nga kriza e krijuar politike, e shkaktuar para së gjithash nga sundimi i keq i pushtetit aktual dhe menaxhimi i papërgjegjshëm me shtetin, solli deri në situatë që bashkësia ndërkombëtare t'i nxisë liderët e katër partive më të mëdha në Maqedoni të ulen në tryezë të negociatave, e pas negociatave të gjata dhe të rënda, ta nënshkruajnë Marrëveshjen e Përzhinës. Marrëveshja ka të bëjë me çështjet, nga të cilat varej dhe akoma varet fati dhe mbijetesa e Maqedonisë. Sigurisht, me qëllim të paramenduar dhe të pritur nga nënshkruesit e Marrëveshjes për plotësimin dhe realizimin e plotë të saj.

Në kuptim juridik, Marrëveshja e Përzhinës do të thotë qasje obliguese, në të cilën pjesëmarrësit janë, respektivisht nënkuptohet se do të duhej të jenë të barabartë, të ndërgjegjshëm dhe të ndershëm, dhe të njëjtit të kenë interes të përbashkët për plotësimin e marrëveshjes, vetëm në interes të qytetarëve të Maqedonisë.

Gjithashtu, nga aspekti juridik, Marrëveshja e Përzhinës ka pasur, dhe ende ka për qëllim kthimin e vlerave të humbura demokratike më Maqedoni, të mundësojë sundimin e drejtësisë, të drejtës, respektimit të ligjeve dhe respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, informim të pavarur dhe objektiv nga mediat, dhe më në fund, zgjedhje të drejta dhe të lira, të garantuara me Kushtetutën dhe ligjet.

Kjo (qëllimi i Marrëveshjes) nënkupton ndryshime në kohë dhe cilësore të modelit

zgjedhor, Listës së Votuesve, legjislacionit zgjedhor, punën ligjore dhe transparente të partive politike, organeve shtetërore dhe institucioneve (ordinere dhe speciale), përgjegjësi individuale dhe kolektive, liri të mediave...Me qëllim të vetëm: krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, si dhe çlirimin e të gjitha institucioneve de qytetarëve nga shtypjet dhe kontrolli i pushtetit.

Në këtë kontekst juridik, si parakushte (më të rëndësishme) për mbajtjen e zgjedhjeve fer dhe demokratike, janë:

- Reforma të modelit zgjedhor, i cili duhet të sigurojë pluralizim në skenën politike, rritjen e përgjegjësisë politike dhe morale të të zgjedhurve të popullit dhe vendosje të demokracisë brendapartiake. Ky model, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venedikut, nuk guxon të durojë ndryshime esenciale në gjashtë muajt e fundit para mbajtjes së zgjedhjeve,

- Ndryshime dhe harmonizime të Listës Zgjedhore, në përputhje me të dhënat e azhuruara për qytetarët, nga librat amzë, evidencë për vendbanim, evidencë për shtetësi dhe evidenca tjera zyrtare, të marra nga organet përkatëse,

- Ndryshime dhe plotësime të Kodit Zgjedhor me dispozita për shënimin e përkohshëm të votuesve jashtë nga vendi i qëndrimit në Listën Zgjedhore, me çka do të shmangej nevoja për regjistrimin aktiv të votuesve.

- Financimi ligjor dhe transparent i zgjedhjeve, gjegjësisht, i fushatës zgjedhore, posaçërisht pa mjete nga buxheti i RM, pa mjete nga buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit, si dhe pa mjete nga ndërmarrjet publike.

- Raportime publike dhe transparente të ndërmarrjeve radiodifuzive dhe mediave të shtypit, për hapësirën reklamuese të shfrytëzuar nga secili prej pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore dhe mjetet e paguara ose ato që kërkohen mbi atë bazë.

Pa korrigjime të legjislaturës zgjedhore, e mandej edhe pa respektimin e plotë dhe aplikimin e drejtë, nuk ka dhe nuk mund të pritet plotësimi i Marrëveshjes së Përzhinës, e as kthimi i demokracisë dhe lirisë në Maqedoni.

Kështu që, mbetet e pasigurt, dhe e pamundshme mbajtja e zgjedhjeve parakohshme të lira parlamentare.

3. KONTRIBUTI I CIVIL

Mes faktorëve tjerë të rëndësishëm, edhe CIVIL- Qendra për Liri, në tetë vitet e kaluara, vazhdimisht dhe me durim, tregonte për mosekzistimin e dialogut politik, nivelin e ulët të edukatës politike dhe pamundësinë të arrihet pajtim për çështje të rëndësishme në interes të demokracisë, të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

Nëpër aktivitetet, hulumtimet, analizat dhe rekomandimet e shumta, CIVIL – Qendra për Liri ka folur (me gjuhë të kuptueshme për të gjithë) për:

- Shkeljen e ashpër të të drejtave dhe lirive të njeriut, të garantuara me kushtetutë (në veçanti për lirinë e të shprehurit, drejtësinë sociale dhe të drejtën votuese)
- Diskriminimin mbi bazë etnike dhe fetare
- Dhunën strukturore
- Diskriminimin sipas përkatësisë politike
- Funksionimin e institucioneve publike/shtetërore vetëm në interes dhe për nevoja të pushtetit dhe partisë sunduese
- Keqpërdorimet kriminele të pushtetit
- Korrupsionin dhe jo transparencën e mediave
- Procesin eroziv zgjedhor
- Shprehur me gjuhën e CIVIL: “Vetëm zgjedhjet e lira janë shans për kthimin e sundimit të së drejtës”. “Evropa kërkon dorëheqjen e Gruevskit dhe sigurimin e zgjedhjeve të drejta”, “Raste të shtypjes së ashpër politike”, “ Përballje e vendosur me korrupsionin politik”, “ Shtypje mbi stafin mësimdhënës”, “Gruevski vazhdon me abuzimet”, “ VM-

RO-DPMNE e përvetëson historinë”, “ Maqedonia, frikë dhe shpresë”. “Demokracia e diskualifikuar”

“Lufta pa skrupull për pushtet”, “Kriminelët nuk guxojnë të sundojnë Maqedoninë”. “ Maqedonia nuk guxon të lejojë vjedhje zgjedhore”..

Në konstatimet dhe qëndrimet e detajuara të shumta, të paraqitura para publikut vendas dhe ndërkombëtar, para institucioneve dhe organizatave të vendit dhe ndërkombëtare, CIVIL-Qendra për Liri në vazhdimësi i konstaton dhe zbulon gjendjet aktuale dhe problemet në shtet, edhe atë në shumë segmente nga jetesa shoqërore, duke gjetur dhe propozuar module për forcimin e vetëdijes së qytetarëve, si parakusht i rëndësishëm për tejkalimin e problemeve dhe devijimeve shoqërore.

Në kornizat e punës tyre, CIVIL – Qendra për Liri i mbështet të gjitha veprimet dhe proceset individuale dhe/ose kolektive dhe i ndan me publikun ekspertizat dhe rekomandimet për mbrojtje dhe respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimin e drejtësisë dhe sigurisë juridike, rritjen e shkallës së tolerancës ndëretnike, dialogun politik, sjelljen etike, stabilitetin dhe demokracinë.

Puna e CIVIL- Qendrës për Liri, në esencën e saj, çdo herë ka qenë dhe do të jetë me interes dhe qëllim të vetëm: liri dhe demokraci, që nënkupton betejë pa kompromis për respektimin e të drejtave dhe lirive njerëzore, dhe asgjë më pak nga këto.

TRANSKRIPTE

MAQEDONIA JETON NË REALITET TË SHITREMBËRUAR DHE NË ILUZIONI

Shkup, Mars 17, 2016

Sandra Gavrillovska, avokate dhe eksperte juridike, flet për aspektet politiko-juridike të krizës politike dhe për pasojat dramatike të partizimit të shtetit.

Gjendja e përgjithshme në Maqedoni është e bazuar në krizën politike në shtet që nga viti 2001 e gjer tani, gjë që veçmë konfirmohet në raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë për vitin 2015. Kriza aktuale politike pa dyshim se ndikon në ambientin demokratik maqedonas dhe të njëjtin e shtrembëron gjer në shkallë të realitetit të shtrembëruar dhe iluzionit. Situata e tillë dramatike e krizës politike në Maqedoni, ndër të tjera, reflekton sundim autokratik dhe qeverisje të rreptë partiake dhe demokraci të brishtë dhe anemike.

Në aspektin juridik, vlerat e humbura demokratike kanë domino-efekt në funksionimin e përgjithshëm të sistemit ligjor dhe gjyqësor, i cili qëmoti nuk është shumë funksional. Jemi dëshmitarë të sundimit total të represionit në vend të sundimit të ligjit, të mos-respektimit masovik dhe shkeljes së ligjeve, si dhe të gjyqësisë paturpësisht të korrup-tuar, në vend të një gjyqësori të pavarur, që konfirmohet edhe me zhvillimet e fundit me vendimin e institucionit të Gjykatës Kushtetuese, si një precedent me pasoja serioze juridike dhe politike, me çka, sipas vlerësimit tim, në një mënyrë skajshmërisht të dhunshme, kush e di se cilën herë me radhë, manifestohet ndërhyrje e ekzekutivit në pushtetin gjyqësor, gjë që ndalohet me Kushtetutë.

Në këtë kontekst, pa respekt ndaj Kushtetutës dhe ligjeve, si dhe në mungesë të mbrojtjes ligjore dhe të sigurisë në të gjitha sferat e jetës dhe veprimit shoqëror, shkelja e rëndë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe rrezikimi serioz i lirisë së mediave dhe zgjedhjeve, sado që tingëllon si absurd – është pasojë logjike e qeverisjes së keqe të pushtetit aktual dhe menaxhimit të tij të papërgjegjshëm dhe jo-shtëpiak me shtetin. Duke folur ekskluzivisht nga aspekti juridik, konsideroj se ekzistojnë më shumë parakushte që të dilet nga kriza politike dhe të çlirohen jo vetëm institucionet, por edhe qytetarët, prej kontrollit të pushtetit. Në këtë kontekst, parakusht për daljen nga kriza politike janë ndryshimet dhe akordimi i Listës Zgjedhore, edhe atë jo vetëm në pajtim me të dhënat e përditësuara nga evidenca për shtetësitë, por edhe në pajtueshmëri me të dhënat e qytetarëve nga librat amë, evidenca për banim dhe të gjitha evidencat tjera zyrtare që mund të merren nga autoritetet kompetente. Gjithashtu, nevojitet ndryshim dhe plotësim i Kodit Zgjedhor, edhe atë me dispozita për regjistrimin e përkohshëm

në Listën Zgjedhore të votuesve jashtë nga vendi i banimit, me qëllim që të shmanget nevoja për regjistrim aktiv. Gjithashtu, konsideroj se, përfundimisht, Kodi Zgjedhor duhet të plotësohet me dispozita për kundërvajtje, respektivisht ndëshkuese, për të gjithë subjektet që marrin pjesë në procesin zgjedhor, e që nuk do t'i respektojnë të gjitha detyrimet që janë të përcaktuara me Kodin Zgjedhor.

Parakusht për daljen nga kriza janë edhe reformat në modelin zgjedhor, për të cilat tani është shumë vonë për të folur në rastin konkret, por këto reforma do të mundësonin pluralizëm në skenën politike, si dhe zmadhimin jo vetëm të përgjegjësisë politike, por edhe të përgjegjësisë morale të përfaqësuesve të popullit dhe, përfundimisht, vendosjen e një demokratizimi brenda partiak, gjë që shihet qartë që mungon.

Si parakusht është dhe duhet të insistohet në punën ligjore dhe transparente të institucioneve shtetërore, si të atyre të rregullta ashtu edhe të atyre speciale, si dhe të partive politike, financimin ligjor dhe transparent të zgjedhjeve, respektivisht të kampanjës zgjedhore, pa mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, pa mjete nga buxhetet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit, si dhe pa mjete nga ndërmarrjet dhe institucionet publike. Gjithsesi, edhe çlirim i mediave nga presioni i pushtetit dhe raporte transparente për të gjitha mediat e shtypit dhe radiodifuzive lidhur me reklamimin e pjesëmarrësve në fushatë politike.

Përpjekja për të gjetur zgjidhje për çështjet, nga të cilat varet gjyqësori dhe mbijetesja e demokracisë, ishte Marrëveshja e Përzhinës, të cilën do ta komentoja vetëm nga pikëpamja juridike, si marrëveshje që nënkupton detyrim obligativ të pjesëmarrësve, që nënkupton se të gjithë pjesëmarrësit në këtë marrëveshje, të gjitha palët e dakorduar, duhet të jenë të barabarta, të ndërgjegjshme dhe të ndershme, e të njëjtit të kenë interes për ta përmbushur marrëveshjen vetëm në interes të qytetarëve të Maqedonisë. Kur realizimi i kësaj Marrëveshjeje të Përzhinës do të arrihej në kuptimin e vërtetë juridik, mendoj se do të shihej dalja nga kriza politike. Sa i përket sektorit civil, konsideroj se është i padyshimtë roli dhe ndikimi i sektorit qytetar në ngritjen e vetëdijes dhe në tejkalimin e problemeve të krijuara dhe devijimeve shoqërore. Sektori qytetar,

individualisht dhe bashkërisht, tregon për mosekzistimin e dialogut politik, ekzistimin e një niveli të ulët të kulturës politike, si nga aspekti i lirive dhe të drejtave të garantuara themelore të njeriut, pastaj, për korrupsionin, mungesën e transparencës, keqpërdorimin kriminal të pushtetit, funksionimin e institucioneve publike dhe shtetërore ekskluzivisht në interes të pushtetit dhe partisë qeveritare, kontrollin e informimit të mediave, procesin e eroduar zgjedhor dhe shumë tema të tjera, për të cilat vazhdimisht tregohet nga sektori qytetar dhe, mendoj, që kjo ka efekt tek qytetarët”.

Gavrillovska ishte pjesë e panelit të ekspertëve “Pluralizmi dhe kriza politike”, të mbajtur më 17 mars 2016, i cili pati jehonë të fuqishme në publik për shkak të analizave të thella të procesit zgjedhor dhe krizës politike në vend.

Ngjarja ishte pjesë e projektit “Zgjedhjet e lira për qytetar(e)ë të lirë”, i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë.


ANALIZË LEGALE [2]

PARANDALIMI I MANIPULIMEVE ZGJEDHORE

Aleksandra Joziq-Ilekoviq

Nëkuadër të projektit për ndihmë konsultative të organizatave të shoqërisë civile në Maqedoni – në raport me procesin, jam e angazhuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Çështje Evropiane e Kroacisë dhe nga Qendra e Ekselencës, si një ekspert në fushën e reformave zgjedhore, në Republikën e Maqedonisë.

Si pjesë e implementimit të projektit, bashkë me kolegun Dragan Zeliq nga GONG, kishim tre misione ekspertësh (në periudhën prej 28 gusht deri më 9 shtator viti 2015) me qëllim – mbështetje për CIVIL-in për ngritje të aftësive të tyre profesionale dhe formimin e politikave avokuese publike për përfaqësimin e reformave zgjedhore në Republikën e Maqedonisë.



Duke punuar në këtë projekt, është vërejtur nivel i lartë i profesionalizmit dhe interesim i madh në mesin e kolegëve të CIVIL-it për përparim dhe pajisje me dituri të reja, dhe prandaj edhe bashkëpunimi ishte në nivel të lartë, gjë që kontribuoi për arritjen e qëllimeve dhe rezultateve nga projekti në përgjithësi, e e tërë kjo rezultoi me vullnetin e CIVIL-it dhe organizatave të tjera për lidhje të mëtutjeshme dhe aktivitete të përbashkëta për përmirësimin e legjislaturës zgjedhore, për përcjelljen e procesit zgjedhor dhe për parandalimin e manipulimeve në procesin zgjedhor.

Mbështetje për këtë projekt dha edhe ambasadorja kroate në Republikën e Maqedonisë, znj. Daniela Barishiq, e cila, me qëndrimin e saj të hapur (edhe pse në fillimin e mandatit) dhe përmes pjesëmarrjes në mbledhje publike, edhe më tepër e shfaqti gatishmërinë kroate, përmes Qendrës së Ekselencës të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Çështjeve Evropiane të Republikës së Kroacisë, t'u japë ndihmë profesionale kolegëve nga Republika e Maqedonisë në të gjithë projektet e ardhshme, të cilët përfshijnë bashkëpunim dhe mbështetje në zhvillimin e një shoqërie demokratike. Kolegët nga CIVIL-i e respektojnë angazhimin e ambasadores në mënyrë të veçantë dhe shprehën shpresë për bashkëpunim të mëtutjeshëm mes dy shteteve.

Duke pasur parasysh se Republika e Maqedonisë po përgatitej për zgjedhje të parakohshme parlamentare të planifikuara për muajin prill të vitit 2016, shkëmbimi i njohurive dhe përvojave me kolegët e tyre kroatë, rezultoi me rekomandime konkrete të CIVIL-it për rregullimin e Listës Zgjedhore, për emërimin e Komisionit Shtetëror Zgjedhor të Republikës së Maqedonisë si organ i pavarur dhe profesional, për metodologjinë e mbikëqyrjes jopartiake, për komunikimin e CIVIL-it dhe organizatave të tjera qytetare që punojnë rreth të drejtave njerëzore dhe procesit zgjedhor – për avokim të mundshëm të përbashkët për të përmirësuar e legjislatacionin zgjedhor dhe Listën Zgjedhore.

Po ashtu, është theksuar edhe nevoja për rregullim dhe mbikëqyrje të financimit të fushatave zgjedhore, si element i rëndësishëm për sigurimin e një gare të drejtë zgjedhore dhe luftë kundër korrupsionit.

Përvojat e GONG-ut në punën e vëzhguesve dhe vëzhgimit në të gjitha fazat e procesit

zgjedhor ishin jashtëzakonisht të nevojshme dhe paraqisnin një bazë mbi të cilën janë bazuar planet për përcjellje të procesit zgjedhor dhe strukturës organizative të CIVIL-it, i cili do të organizojë dhe zbatojë mbikëqyrje jopartiake të zgjedhjeve.

Gjatë punës me projektin, CIVIL-i ka organizuar mbledhje dhe punë interaktive nëpunëtori, si dhe mbledhje publike me kolegët e tyre nga MOST-i, me përfaqësues të Fondacionit Shoqëria e Hapur, të Komitetit të Helsinkit në Maqedoni, përfaqësues të OSBE-së dhe NDI-së, Ambasadës Gjermane, Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, me përfaqësues të partive politike dhe ekspertë të pavarur nga fusha e procesit zgjedhor.

1. MISIONI I PARË EKSPERTËSH (28 GUSHT – 2 SHTATOR, 2015)

Tema e misionit të parë të ekspertëve ishte rregullimi i Listës Zgjedhore, vëzhgimi i zgjedhjeve dhe rëndësia e punës së pavarur të institucioneve në zbatimin e zgjedhjeve. Gjatë punës ishim të informuar se në Republikën e Maqedonisë është duke u zhvilluar procesi i negociatave (i mbyllur për opinionin) mes përfaqësuesve të partive parlamentare dhe me ekspertë për ndryshime në Kodin Zgjedhor, me fokus në metodologjinë e planifikimit dhe azhurnimit të Listës Zgjedhore. Ideja ishte që deri në shpalljen e zgjedhjeve të gjendet një model për azhurnimin e Listës Zgjedhore, ndërsa njëri nga propozimet ishte regjistrim aktiv nga ana e votuesve disa ditë para zgjedhjeve, siç na informuan nga CIVIL-i dhe pjesëmarrës të tjerë.

Prezantimi i Ligjit kroat për zgjedhje të deputetëve në parlamentin kroat , Ligjit për Listë Zgjedhore dhe Ligjit për Komisionin Shtetëror Zgjedhor , paraqiti një pasqyrë të kornizave zgjedhore dhe ligjore kroate, me ç'rast u vërejtën ngjashmëri të mëdha me Kodin Zgjedhor të Republikës së Maqedonisë.

Respektivisht, me Kodin Zgjedhor janë të rregulluara të gjitha zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë në një vend, për dallim nga modeli kroat, ku ligje të veçanta e rregullojnë çdo cikël zgjedhor në veçanti, gjë që e vlerësojmë pozitivisht dhe e mbështesim sjelljen e një Ligji Zgjedhor të vetëm, i cili në aspekt të sistemit dhe sistematizimit të legjisla-

cionit është zgjidhje më e mirë dhe më e përshtatshme.

Pjesëmarrësit në projekt paraqitën vërejtje serioze për punën e administratës zgjedhore në fushën e Listës Zgjedhore dhe institucioneve të lidhura me mbajtjen e kësaj evidence publike, siç janë Komisioni Shtetëror Zgjedhor (në tekstin e mëtutjeshëm: KSHZ) dhe Ministria e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtutjeshëm: MPB). Në fakt, siç informuam edhe më lartë, rreth çështjes së përgjegjësisë për saktësinë e Listës Zgjedhore, KSHZ pohon se Lista e Votuesve është nën kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa Kodi Zgjedhor parasheh se “Listën Zgjedhore e udhëheq Komisioni Shtetëror Zgjedhor”. Kërkesa për regjistrim në Listën Zgjedhore është për persona në moshë prej 18 vjet dhe me vendbanim të vazhdueshëm në Republikën e Maqedonisë, si dhe me letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme.

Pra, sa i përket kompetencës, sipas dispozitës së paraqitur, del se KSHZ, i cili e udhëheq Listën e Votuesve, duhet të jetë përgjegjës për saktësinë e të dhënave. Megjithatë, ka interpretime të ndryshme në lidhje me këtë çështje, dhe ne jemi të informuar se KSHZ vlerëson se ai nuk është organ që mund ta vërtetojë saktësinë e Listës Zgjedhore dhe se kjo gjë është nën kompetencë të MPB-së, organ i cili mban evidencë për vendbanim dhe nënshtetësi, e cila, krahas të dhënave nga regjistrat nga librat amzë dhe evidencave të tjera zyrtare, është bazë për përpilimin e Listës Zgjedhore. KSHZ-ja, po ashtu, ka mundësi që kontrollimin e saktësisë ta vërtetojë në bazë të kontrolleve të drejtpërdrejta, me ç’rast nuk përcaktohet mënyra, de facto, se si bëhet (dhe a bëhet) një gjë e tillë.

Duhet në mënyrë të qartë të bëhet dallim mes kompetencave në lidhje me Listat e Votuesve të KSHZ-së dhe MPB-së, dhe të përcaktohet se cili është përgjegjës për saktësinë e Listës Zgjedhore.

Në Kroaci, Lista Zgjedhore është nën kompetencë të Ministrisë së Administratës, e cila bën arkivimin e të dhënave për elektoratin, me çka regjistri i votuesve definohet si shumë e të dhënave personale të të gjithë votuesve, ndërsa Lista Zgjedhore është pjesë e Regjistrimit të Votuesve, i cili përgatitet pas mbylljes së tij dhe paraqet bazë për votim.

Në aspektin e legjislaturës ligjore maqedonase në fushën e Listës Zgjedhore dhe të drejtës së votës, parashtrohet çështja për qytetarët që nuk kanë dokument të vlefshëm, letërnjoftim/pasaportë, dhe si mund ata ta ftojnë të drejtën e votës. Në këtë pjesë ne propozojmë të shqyrtohet mundësia – këta votues të votojnë në bazë të certifikatave të votimit, pas një shqyrtimi paraprak të të drejtave të tyre për të votuar nga organi kompetent.

Në këtë mënyrë rritet mundësia që të votojnë ata votues që në ditën e zgjedhjeve do të jenë (ose janë) jashtë vendit të banimit (veçanërisht për një kategori të caktuar të votuesve, siç janë studentët, punëtorët migrantë...). Në këtë kontekst, i kemi prezantuar vendimet ligjore në Ligjin kroat për regjistrim të votuesve, sipas të cilit parashihet mundësia për regjistrim paraprak të votuesve që jetojnë në Republikën e Kroacisë, të cilët do të votojnë jashtë shtetit, ose regjistrim i përkohshëm në regjistrin e votuesve jashtë vendit të banimit për ata votues që do të gjenden në tjetër qytet/komunë të Republikës së Kroacisë dhe lëshim i certifikatave për votim jashtë vendit të banimit, në bazë të të cilave votuesit do të mund të votojnë në cilindo vendvotim në Republikën e Kroacisë ose jashtë shtetit.

Qëllimi kryesor i këtyre institucioneve të përfshira në Ligjin kroat për regjistrin e votuesve është t'u mundësohet të gjithë votuesve lëvizje e lirë pa pengesë për realizimin e të drejtës për votim.

Në praktikë shpesh ndodh që Listat Zgjedhore të jenë të pasakta, ndërsa si rezultat i mungesës së përvojës së autoriteteve, migrimit të popullatës dhe faktit që qytetarët nuk kontrollojnë nëse janë në Listën Zgjedhore, kur ka qasje për kontrollim, vështirësohet përpilimi i listës Zgjedhore

Në lidhje me aranzhimin/azhurnimin e Listës Zgjedhore, është i rëndësishëm roli i administratës zgjedhore dhe MPB-së, të cilët duhen që para zgjedhjeve të zbatojnë fushatë të fuqishme mediatike dhe aktivizim të qytetarëve, nga njëra anë, ta kryejnë obligimin e tyre prej qytetari dhe t'i azhurnojnë dokumentet e tyre personale, si dhe njëkohësisht, në mënyrë aktive, t'i kyçin edhe qytetarët si një lloj vëzhguesi qytetar, të cilët

do t'i paraqesin në polici të gjitha informatat për parregullsi të vërejtura (për shembull, vendbanim fiktiv), dhe të informohet publikisht për numrin e votuesve në çdo adresë, i cili do të jetë në dispozicion për qytetarët për revizion (ueb-faqja e MPB-së, KSHZ-së) dhe do të mundësojë implementim dhe vërtetim të këtyre informacioneve.

Shërbimi publik mediatik duhet të veprojë në mënyrë më të përqendruar dhe të mundësojë përcjellje të informacioneve deri tek opinioni (njoftime, programe tematike të orientuara për zgjedhje me pjesëmarrës kompetentë, me qëllim që t'i informojë qytetarët për procedurën zgjedhore), kështu që qytetarët do të kishin qenë bashkëpunëtorë dhe do t'ua lehtësonin organeve kompetentë sigurimin e informacioneve nga rrethi i tyre.

E gjithë kjo, kuptohet, paraqet se Lista Zgjedhore është konstante, dhe përfshin obligimin për azhurnimin e rregullt të saj, duke theksuar se nëse regjistrimi i votuesve nuk bëhet në mënyrë automatike, duhet të jepet një periudhë mjaftueshëm e gjatë për regjistrim. Po ashtu, është jetike që Lista Zgjedhore të publikohet dhe të ekzistojë proces administrativ që do të jetë objekt i një kontrolli gjyqësor.

Së fundmi, nuk ka dyshim se shteti përmes aparatit të tij duhet të mundësojë që secili votues ta realizojë të drejtën e tij për votë të garantuar me Kushtetutë, dhe se individët nuk duhet t'i bartin pasojat e një aksioni të gabuar ose mosveprimi në shtet. Në këtë kontekst, për azhurnimin e Listës Zgjedhore është jetike që të gjithë votuesit të kenë, në kushte të njëjta, të drejtë regjistrimi, korrigjimi ose ndryshimi të të dhënave në Listën Zgjedhore.

Në këtë pjesë, është e rëndësishme të inkurajohen organizatat joqeveritare që punojnë në fushën e vëzhgimit të pavarur të procesit zgjedhor dhe/ose në promovim të të drejtave njerëzore dhe qytetare.

Pjesëmarrësve në projektin nga ana e kolegut Zeliq nga GONG-u iu prezantua metodologjia e mbikëqyrjes jopartiake të zgjedhjeve në periudhën parazgjedhore, në ditën e zgjedhjeve dhe në periudhën pas zgjedhjeve. Në bazë të shkëmbimit të njohurive

dhe përvojave, CIVIL-i fitoi ide të reja rreth asaj se si dhe çka të bisedohet me qëllim të përmirësimit të legjislacionit zgjedhor, duke hartuar propozime konkrete dhe masa për veprim në mënyrë që të parandalohen manipulime eventuale në zgjedhjet e ardhshme.

2. MISIONI I DYTË I EKSPERTËVE (17-20 NËNTOR 2015)

Tema e misionit tonë të dytë në Maqedoni ishte financimi i fushatave zgjedhore, me fokus në madhësinë dhe përmbajtjen e tyre, si dhe kontroll në përbërjen e kornizës ligjore për rregullimin e çështjeve të lartpërmendura. Anëtarë dhe bashkëpunëtorë të CIVIL-it morën njohuri shtesë për rregullimin ligjor të financimit të fushatave zgjedhore dhe partive politike në Kroaci, si dhe për standardet ndërkombëtare.

Gjatë procesit të anëtarësimit në BE, Republika e Kroacisë solli kornizë ligjore cilësore për financimin e fushatave zgjedhore dhe partive politike[1], gjë që është e dobishme edhe në kontekstin maqedonas. Shkëmbimi i përvojave dhe njohurive rezultoi me sugjerime konkrete të CIVIL-it për organizim dhe mbikëqyrje të financimit të fushatës parazgjedhore dhe rolit të KSHZ-së. Tubimi publik ka pasur një mbulim të konsiderueshëm mediatik, ndërsa në mbledhjet/punëtoritë e mbyllura bisedohej me përfaqësues edhe të organizatave të tjera të shoqërisë civile, përfaqësues të partive politike dhe ekspertë që merren me procesin zgjedhor.

Derisa bisedonim me kolegët dhe nga informacionet që i kemi marrë gjatë vizitës dhe nga inspektimi i Kodit Zgjedhor, konsiderojmë që është e nevojshme të përcaktohen limite për shpenzimin e të hollave në fushata dhe shuma të jetë funksionale, e pranueshme në mënyrë ekonomike dhe etike, duke e pasur parasysh momentin social të tranzicionit, në të cilin gjendet shoqëria dhe ekonomia e Maqedonisë. Po ashtu, duhet të shqyrtohet nevoja – kontrollimi i financimit të fushatave t'i besohet KSHZ-së, i cili do ta kryente kontrollin në mënyrë të pavarur prej Zyrës Shtetërore të Auditimit, me demarkacione të qarta në kompetenca. Duhet të parashihet edhe se KSHZ-ja do ta kryejë mbikëqyrjen në bashkëpunim me organet e tjera kompetente (për shembull, ad-

ministratën tatimore, Ministrinë e Financave...). Sipas informacioneve që i kemi marrë, KSHZ-ja ka rreth 120 të punësuar në Zyrën Administrative, që për dallim nga 14 të punësuarit në Zyrën Administrative në Komisionin Shtetëror Zgjedhor të Kroacisë (organi që bën mbikëqyrjen e financimit të fushatave) është një numër i madh, ndërsa kjo, pa dyshim, tregon se ka mjaftueshëm resurse njerëzore që të kryhet mbikëqyrje e financimit të fushatave dhe partive politike, në qoftë se ekziston obligim ligjor për të dhe vullnet i shprehur politik. Për më tepër, mund të rishqyrtohet që mundësia për kontroll t'i jepet edhe ndonjë organi tjetër të pavarur, gjë që kërkon debat adekuat politik dhe publik.

Konstatuam se rregullimi i rolit të parave në politikë është çështje qendrore e agjendave politike në gjithë botën. Përcjellja e financimit të fushatave nuk duhet të mbetet shkronjë e vdekur në fletë dhe duhet që në mënyrë të qartë të rregullohen obligimet e pjesëmarrësve në zgjedhje, si dhe përmbajtja e afateve për dorëzimin e raporteve mbi shpenzimet për fushata, e në këtë kuptim të përgatiten obligimet e organit që është i obliguar për mbikëqyrje. Është e nevojshme që raportet të shqyrtohen nga një organ i pavarur, dhe në rast të mosplotësimit të obligimeve, të sigurohen sanksione, të cilat në Kroaci janë administrative dhe për kundërvajtje.

Rregullimi i financimit të të hollave është parakusht bazë për garë të drejtë politike, por për të pasur sukses rregullimi i financimit nuk mjafton vetëm sjellja e ligjeve, por edhe gatishmëria për t'i bërë këto ligje efikase, për çka, besojmë se Republika e Maqedonisë duhet të bëjë përpjekje shtesë. Gjithsesi se kjo gjë përfshin miratimin e standardeve të larta politike të partive udhëheqëse politike të cilat do t'i miratojnë si qëndrime të tyre.

3. MISIONI I TRETË I EKSPERTËVE (9 – 11 DHJETOR 2015)

Vizita e CIVIL-it ishte e përkushtuar për mbikëqyrjen e zgjedhjeve, si dhe aktiviteteteve për planifikim dhe metodologjisë në periudhën e mbikëqyrjes së fushatës, ditës së zgjedhjes dhe periudhës pas zgjedhjeve, për zgjedhjet e ardhshme në Maqedoni. Në

këtë pjesë na u bashkëngjit edhe kolegja Marina Shkraballo nga GONG-u, si njohës i shkëlqyeshëm dhe ekspert në fushën e politikave negociuese, e cila ua përcolli njohuritë e saja kolegëve nga CIVIL-i.

Si pjesë e metodologjisë për vëzhgimin e zgjedhjeve janë hartuar edhe organizata të tjera qytetare të cilat do të kishin mundur të kontribuojnë, në aktivitete të përbashkëta me CIVIL-in, përmes lidhjeve dhe rrjetëzimeve. Në lidhje me aktivitetet e lartpërmendura, kemi biseduar që sipas nevojës të formohet një strukturë organizative për përcjelljen e zgjedhjeve. Anëtarët dhe bashkëpunëtorët e CIVIL-it kanë hartuar një plan aktivitetesh për vëzhgimin e periudhës parazgjedhore, ditës së zgjedhjeve dhe periudhës pas zgjedhjeve. I kemi analizuar kapacitetet e organizatave dhe është zhvilluar një plan për bashkëpunim me organizata të tjera të shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë për mbikëqyrje të përbashkët të zgjedhjeve të ardhshme. Sipas kontekstit politik dhe juridik në Maqedoni, është përpiluar një metodologji për përcjelljen e procesit zgjedhor dhe vetëdijes për nevojë për trajnim të mëtutjeshëm të të gjithë anëtarëve të CIVIL-it për procesin zgjedhor. Anëtarët e CIVIL-it janë të njoftuar në detaje me të drejtat dhe obligimet e vëzhguesve në të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe i morën njohuritë e nevojshme për analizë të pjesëmarrësve. Në bazë të kapaciteteve ekzistuese të CIVIL-it, është hartuar plani për përforcimin e tyre, me qëllim që të formohet një strukturë e re, e nevojshme për vëzhgim të suksesshëm të të gjitha fazave të procesit zgjedhor.

Përvojat e GONG-ut me vëzhguesit dhe vëzhgimin e të gjitha fazave të procesit zgjedhor janë bazë e dobishme për hartimin e planeve për përcjellje të zgjedhjeve dhe formimin e strukturave organizative të CIVIL-it në mbikëqyrjen e zgjedhjeve të ardhshme në Maqedoni. Po ashtu, potencojmë se CIVIL-i filloi bashkëpunim aktiv me përfaqësuesit e organizatave të tjera qytetare që punojnë për të drejtat njerëzore dhe procesin zgjedhor për vëzhgim të mundshëm të përbashkët të zgjedhjeve.

Sa i përket mbulimit mediatik të zgjedhjeve, nikoqirëve tanë iu paraqitën rregullat "e reja" për mediumet elektronike me koncesion nacional në Republikën e Kroacisë gjatë

fushatës zgjedhore[2].

Implementimi i rregullave “të vjetra”[3] shpuri deri në atë pikë që emisionet e debatit, të cilat në Televizionin Kroat zgjasin 50 minuta, siç është përcaktuar sipas rregullave ekzistuese, një përfaqësues i ndonjë liste (nëse në Njësinë Zgjedhore ka 20 lista), të mos flasë më tepër se 2 minuta, ndërsa në emisionet tjera në mediumet tjera, ku rregullat parashohin kohëzgjatje prej 20 minutash, të flasin më pak se një minutë! Gjithashtu, obligimet e mediumeve elektronike në zgjedhjet për deputetë në Kuvendin kroat ishin të përgatitura në mënyrë shumë të detajizuar, me çka parandalohet krijimi i hapësirës për ndërmjetësim të lirë dhe kreativ të gazetarëve në mesin e qytetarëve dhe interesave të tyre dhe kandidatëve dhe interesave të tyre, e me këtë gjë çojnë deri tek informimi dhe edukimi i keq i votuesve në lidhje me partitë, për programet e tyre dhe për kandidatët.

Me rregullat e reja insistohet që në mënyrë sa më të mirë të ndiqen format dhe koha e përcjelljes së propagandës zgjedhore. Me këtë, nga njëra anë, u garantohet trajtim i barabartë pjesëmarrësve në zgjedhje, ndërsa redaktorëve dhe gazetarëve u jepet liria për krijimin e emisioneve dhe përcaktohet një minimum i mbrojtur i termineve, që i përkasin secilit kandidat zgjedhor ose liste zgjedhore.

Është i rëndësishëm zbatimi i parimit të barazisë mes partive dhe kandidatëve në procesin zgjedhor. Barazia duhet të jetë e garantuar dhe për këtë qëllim është e nevojshme që organet shtetërore të kenë qëndrim neutral në raport me: fushatën zgjedhore, mediumet, veçanërisht mediumet shtetërore dhe financimin e partive dhe fushatave nga buxheti.

Në varësi të një subjekti të veçantë, barazia mund të jetë strikte ose proporcionale. Nëse barazia e partive politike është proporcionale, ato duhet të trajtohen sipas rezultateve të arritura në zgjedhje. Barazia veçanërisht i referohet prezantimit në radio/TV, mjeteve buxhetore dhe një lloji tjetër mbështetjeje [4].

PËRFUNDIM

CMe implementimin e këtij projekti ne u përpoqëm ta ofrojmë ndihmën tonë nga ekspertë, kolegëve tanë nga CIVIL-i, me qëllim që CIVIL-i të etablohet edhe më tepër si organizatë relevante për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për promovimin e transparencës dhe për ndjekjen e procesit zgjedhor. Sigurisht, e vlerësojmë pozitivisht vullnetin e CIVIL-it dhe organizatave të tjera për bashkëpunim të mëtutjeshëm dhe për aktivitete të përbashkëta për përmirësimin e legjislacionit zgjedhor, për përcjelljen e procesit zgjedhor dhe për parandalimin e manipulimeve në procesin zgjedhor. Me anë të shkëmbimit të njohurive dhe përvojave, CIVIL-i fitoi ide të reja, si dhe çka të ndërmarra për përmirësimin e procesit zgjedhor në Maqedoni.

[1] Zakon o financiranju političkih aktivnosti i izborne promidžbe („Narodne novine“, broj 24/11, 61/11, 277/13 i 48/13-pročišćeni tekst)

[2] „Narodne novine“, broj 118/14

[3] „Narodne novine“, broj 165/03 i 105/07

[4] Kodeks dobre prakse u izbornim pitanjima, Smjernice i obrazloženja, Venecijanska komisija, listopad 2002.

[5] Neni 41, pika 1, KZ

Ekipi i ekspertëve i CIVIL-it - Qendra për Liri, në kuadër të veprimtarisë të zakonshme, përgatiti analiza të reja gjithëpërfshirëse juridiko-politike për situatat politike, për krizën dhe procesin zgjedhor në Republikën e Maqedonisë.

Bashkëpunëtorja e CIVIL-it, Aleksandra Joziq-Ilekoviq (Republika e Kroacisë), presidente shumëvjeçare e Komisionit Shtetëror Zgjedhor të Kroacisë, në kuadër të projektit “Mbështetje për CIVIL-in për ngritjen e kapacitetit profesional dhe zhvillimit të politikës të avokimit publik në përfaqësimin e reformave zgjedhore në Republikën e Maqedonisë”, në janar të vitit 2016 përpiloi një analizë për implementimin e shembujve kroatë për përmirësimin e legjislacionit zgjedhor në Maqedoni, me qëllim – parandalimin e

manipulimeve në procesin zgjedhor, e që u botua në dy vazhdime.


Gjatë muajit shkurt, CIVIL Media e publikoi, në katër vazhdime, analizën e dr. Sasho Ordanoski "Maqedonia: Vendi i mundësive të humbura demokratike", ndërsa do ta botojmë edhe analizën e avokates Sandra Gavrillovska.

Në bazë të këtyre analizave, si dhe analizave dhe rekomandimeve nga ekspertë, CIVIL-i edhe në periudhën e ardhshme do të mundohet të japë kontribut për të krijuar kushte për mbajtje të zgjedhjeve të lira dhe për tejkalimin e krizës politike në Republikën e Maqedonisë.

Analizat dhe rekomandimet që i ka përgatitur CIVIL-i gjatë kësaj periudhe janë pjesë e aktiviteteve të projektit "Zgjedhje të lira për qytetare dhe qytetarë të lirë", i mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë.



Aleksandra Jozić - Ileković



TRANSCRIPTS

TË GJITHË DUHET TË JENË TË BARABARTË PARA LIGJIT!

Shkup, Nëntor 20, 2015

Dragan Zeliq, ekspert nga organizata partnere GONG nga Kroacia, ka mbajtur fjalime të shumta në evenimentet publike të organizuara nga CIVIL-i, ndërsa ka dhënë deklarata dhe intervista për CIVIL Media dhe për mediumet e tjera në vend. I veçojmë transkriptat nga dy deklarata të tij në periudhën e kaluar.

Tema është finansimi i partive dhe fushatave politike, dhe besoj se të gjithë jemi të njoftuar, për fat të keq, me çështjen e finansimit të partive politike. Kroacia ka pasur një përvojë traumatike, e cila ende vazhdon, në lidhje me finansimin jotransparent të fushatave politike të partisë që asokohe ishte në pushtet, HDZ, dhe për fat të keq, kryeministri i mëparshëm është ende në paraburgim dhe është ngritur procedurë kundër partisë politike. Dhe kjo është një çështje serioze. Ne më parë kemi paralajmëruar për këtë, por nuk është reaguuar kur është dashur. Tani mund të kritikohet Ivo Sanader nga kjo perspektivë, dhe të hidhen drunj dhe gurë pas partisë HDZ, por duhet të këmbëngulet që të mos lejohet që këto gjëra të përsëriten dhe të nxjerret ndonjë mësim nga kjo. Jo vetëm HDZ, por edhe të gjitha partitë tjera politike, institucionet, mediumet dhe shoqatat nuk duhet të lejojnë që të ndodhin gjëra të tilla. Me pak fjalë, ne kemi kaluar nëpër tërë këto.

Të gjithë ne e dimë sa i rëndësishëm është roli i parasë në politikë. Nuk mund të organizoni ndonjë fushatë, t'i informoni votuesit, pa pasur mjete. Nuk duhet qenë demagog dhe të flitet kundër partive politike. Partitë janë një nga temat e demokracisë dhe, kuptohet, se ato duhet të finansohen. Ato duhet patjetër të komunikojnë me votuesit, t'ua përcjellin porositë e tyre, megjithatë, e tërë kjo duhet qenë transparente. Është OK të harxhoni para, të merrni para, por duhet ta publikoni se kush ju finanson, sepse ne duhet ta dimë se çfarë po ndodh.

Mes tjerash, një nga kushtet për mbylljen e kapitullit të gjyqësorit në Kroaci, për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ishte ta rregullojmë çështjen e finansimit të partive dhe fushatave politike. Konkretisht, kjo do të thotë të mos mund të nxirren para nga ndërmarrjet publike. Nuk lejohet t'u jepet punë kompanive për nevojat e prokurimit publik, të cilat më pas ua kthejnë paratë partive ose të njëjtat përfundojnë në xhepa private.

Është e nevojshme një mbikëqyrje institucionale, e cila duhet të jetë e pavarur. Ajo nuk duhet të jetë nën kontroll politik. Nëse parkoni gabimisht, do të merrni denim pa problem. Shteti do të reagojë shpejtë, mirëpo, nëse bëni ndonjë manipulim më trashanik,

atëherë mendoj se do të jetë pak më vështirë të ketë denim.

Prandaj, nëse institucioni mund të na denojë për parkim të gabuar, atëherë le ta denojë partinë në qoftë se manipulon me shuma më të mëdha. Më kujtohet një deklaratë e Sanaderit se zgjedhjet fitohen me një të tretën e parave në tavolinë dhe dy të tretat e atyre nën tavolinë! Nëse ndodh kjo, nuk janë të gjithë të barabartë në garë, dikush ka qasje në paratë publike dhe i nxjerr, ndërsa dikush nuk ka, kështu që, nuk ka as kushte minimale për zgjedhje të drejta.

Duhet patjetër të kemi mbikëqyrje institucionale, e cila, për fat të keq, në Kroaci nuk funksiononte. Prokuroria shtetërore, edhe pas ardhjes së Jadranka Kosorit, dha rezultate të shkëlqyeshme, gjë që ishte element kyç.

Me aq sa jam në dijeni, ju keni një prokurore speciale publike dhe mendoj se edhe ajo ka përgjegjësi të madhe. Megjithatë, përgjegjësia nuk është vetëm mbi institucionet, por edhe mbi organizatat joqeveritare. Ja, e kemi CIVIL-in, e cila punon shkëlqyeshëm. Duhet që kjo temë të vihet në rend dite, pasi që nga kjo çështje kemi interes publik – të detyrohen partitë politike të jenë transparente dhe t'i tregojnë llogaritë. Rol të madh këtu luajnë edhe mediumet. Ne, në Kroaci, pa mediumet nuk mundemi të bëjmë asgjë rreth kësaj çështjeje. Me të gjitha mangësitë, pasi që askush nuk është i përkryer, mediumet e njohën rëndësinë e atyre temave dhe ata janë meritore për përforcimin e transparencës rreth kësaj çështjeje. Mediumet janë të interesuar dhe janë syhapur rreth finansimit, siç ishte rasti edhe me zgjedhjet e fundit parlamentare në Kroaci.

Mendoj se edhe në Maqedoni mediumet do ta shohin se sa e rëndësishme është kjo temë dhe do t'i përforcojnë rolet e tyre prej vëzhguesi. Mediumet, nuk do të thojnë se duhet vetëm të njoftojnë, të argëtojnë dhe të edukojnë, por duhet edhe të kontrollojnë, pasi që kjo është jetike për një demokraci të shëndoshë. Është e rëndësishme që mediumet dhe institucionet të vëzhgojnë dhe t'i lënë institucionet që ta kryejnë punën e tyre në mënyrë të pavarur. Mendoj se atëherë do të kishim raporte shumë transparente mbi finansimin e fushatave, do të dijmë se në interes të kujt sillen disa vendime, kur vie një pushtet i ri, në interes të donatorit apo në interes të mbajtjes së pushtetit.

INTERVIEW

FRIKA NUK SHKON SË BASHKU ME DEMOKRACINË

Dragan Zelić

Interviewed by Biljana Jordanovska, CIVIL Media
Shkup, 3 shtator 2015

Republika e Kroacisë ka kaluar përvoja të ndryshme në procesin e saj të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, por jo vetëm për shkak të BE-së, po edhe për shkak të vullnetit të arrijmë standarde të larta demokratike në të gjitha fushat. Do të ishte keq Kroacia të mos i ndajë përvojat e saja, veçanarisht me vendet nga regjioni, sepse mendoj se është në interes të Kroacisë dhe vendeve tjera të kemi vende të zhvilluara demokratike në regjion, që të jenë në nivel të përafërt ose të njëjtë dhe të mund të bashkëpunojmë.

Poashtu, ky shkëmbim përvojash është i rëndësishëm që t'i mos i bëjnë gabimet e njëjta edhe vendet e tjera, dhe në këtë aspekt është mirë që Ministria për Punë të Jashtme dhe Evropiane e Kroacisë e vërejtë rëndësinë e shkëmbimit të njohurive dhe përvojave.

Shpresoj se nesër kur në Kroaci të vijë një qeveri e re, Qendra e Ekselencës nuk do të pushojë së vepruari.

Unë sot do t'ju flas për atë se si të arrihen zgjedhje të lira. Në vendet ku kemi zgjedhje të lira dhe standarde të larta, kjo gjë merret shtruar, praktikisht, kemi zgjedhje të lira, askush nuk vjedh, nuk ka nevojë për mbikëqyrje.

Por edhe atje procesi zgjedhor duhet çdoherë të avancohet. Unë isha në një mision monitorimi në Floridë, SHBA, në vitin 2012, ku, në një demokraci të pjekur, të vjetër, ka shumë hapësirë për avancimin e procesit zgjedhor. Të mos flasim për një Kroaci ose për një Maqedoni.

Në këtë aspekt, ai proces zgjedhor duhet gjithmonë të ujitet, gjegjësisht të mirëmbahet, pasi që ai është si një bimë e brishtë dhe brenda natës mund të vijë deri te ulja e standardeve, nëse i kemi ngritur fare, po mendoj se janë të ngritura. Gjithmonë ka vend për avancimin e procesit.

Tani, shkurtimisht, kolegja ime Aleksandra përmeni disa dokumente dhe standarde ndërkombëtare, une po e veçoj deklaratën e përgjithshme të OKB-së për të drejtat e njeriut, në lidhje me zgjedhje të lira dhe të drejta, pastaj dokumenti i KQZ-së nga Kopenhaga, viti 1990, Kodeksi i praktikës së mirë i Komisionit të Venedikut të PE-së, i cili përshkruan detalisht se si duhet të jenë zgjedhjet; për analiza të ndryshme profesionale ka shumë shembuj.

Do të mundohem t'ju tregoj se si ne, në Kroaci, kemi arritur disa përparime në procesin zgjedhor, si dhe në rritjen e cilësisë, edhe pse një gjë e tillë nuk ishte fare e lehtë. Unë jam në GONG që nga viti 2001, kam punuar gjatë qeverisjes së disa pushteteve, disa nga to e kanë kuptuar, ndërsa disa të tjera nuk e kanë kuptuar rëndësinë e procesit zgjedhor, dhe çdoherë them se nuk është lehtë dhe asgjë nuk ndodh brenda natës. Ju duhet shumë këmbëngulje, durim, duhet të kërkonit bashkëpunëtorë dhe mbështetje që në fund të keni ndonjë rezultat.

Në vitin 1997, kur është themeluar, GONG-ut nuk i është lejuar t'i vëzhgojë zgjedhjet

dhe vëzhguesit kanë qenë të dëbuar nga vendvotimet. Pse? Pasi që me ligj nuk ishte i lejuar vëzhgimi jopartiak i zgjedhjeve. Pse i përmenda standardet dhe dokumentet ndërkombëtare? Pasi që GONG i ka shfrytëzuar pikërisht ato argumente ligjore dhe me Komitetin e atëhershëm kroat të Helsinkut, i cili tanimë nuk është ai që ka qenë asokohe, për shkak të situatës momentale politike, u drejtuam tek Gjykata Kushtetuese dhe kërkuam rishqyrtim për ligjet e atëhershme zgjedhore. Ne mendonim se vëzhgimi shtëpiak duhet të jetë i lejuar dhe Gjykata Kushtetuese vendosi se vëzhgimi shtëpiak duhet të futet në ligj. Kur u bë kjo, arritëm që përmes amandamentit “të portokalltë” (ngjyra e GONG-ut), siç e quajtëm ne, i dorëzuar nga disa deputetë, ta ndryshojmë Ligjin zgjedhor dhe në kuadër të tij ta kyçim edhe vëzhgimin shtëpiak të zgjedhjeve. Ky akcion u zhvillua në 28 qytete, ku mbledhëm nënshkrime dhe kërkuam mbështetje publike. Kështu, ne arritëm zhvillim të suksesshëm qysh në fillim.

Me çka po ballafaqohet Kroacia në 15 vitet e fundit në raport me zgjedhjet? Kemi pasur probleme me regjistrimin e votuesve, me “votimin” nga të vdekurit, probleme me finansimin e fushatave dhe finansimin e partive... Ne në vitin 2007 i shpallëm zgjedhjet në Kroaci jotransparente dhe haptas treguam dhe paralajmëruam se kryeministri, dhe lider i partisë HDZ, kishte lejuar finansim jotransparent. Këto ishin raste të mëdha të keqpërdorimit të parave publike dhe, në fund, u dëshmuua se kishim pasur të drejtë dhe besoj se jeni duke e përcjellur situatën dhe e dini se kryeministri i mëparshëm sot është në paraburgim, mes tjerash, për shkak të atij rasti.

Unë shpresoj se me të vërtetë mësuam diçka nga kjo dhe sollëm Ligj për finansimin e partive për fushata zgjedhore, i cili, sipas meje, sinqerisht, është një ndër më të mirët sot në Evropë. Dhe, nëse ju bëni një gjë të tillë, kjo mund të jetë një bazë e mirë për sjelljen e një ligji të tillë.

Kolegja ime e përmendi edhe Komisionin shtetëror zgjedhor. Vetëm sa për ilustrim për skandalet e vitit 2005, kur vërtetuam se kishte votim nga të vdekurit, përmes një rasti kur një zonjë që kishte vdekur qysh në vitin 2000, është “paraqitur” në vendin e votimit dhe kishte votuar pesë vite më vonë. Sot në Kroaci nuk janë të mundshme rastet e tilla,

pasi që e kemi ndryshuar ligjin, kemi vepra të caktuara penale për procesin zgjedhor, mirëpo nuk do të dëshiroja t'ju mundoj shumë me ato gjëra. Ne mund ta ndryshojmë Kodin Zgjedhor dhe mund t'i themelojmë të gjitha institucionet e nevojshme, por nëse nuk kemi ambient të përshtatshëm politik dhe standarde të zhvilluara demokratike në fusha të tjera, mendoj se nuk është e mundur të organizohen zgjedhje të lira.

E shihni se sa kemi luftuar ne që të fitojmë një strukturë cilësore politike, por edhe kjo nuk mjafton, kjo është një pikë themelore nga e cila mund të ndërtohen zgjedhje të lira dhe të drejta në një ambient demokratik, ku votuesi nuk do të ndiejë asnjëfarë frike varësisht se a do të dalë në zgjedhje apo jo. Ai duhet të ketë të drejtë të mos dalë të votojë, nëse nuk dëshiron. Askush nuk mund të më detyrojë të shkoj apo të mos shkoj të votoj. Këto gjëra duhet të jenë normale, ndërsa ne në Kroaci nuk kemi shumë raste të tilla në nivel shtetëror, por edhe lokal. Aty ku tensionet janë pak më të larta ka raste të tilla.

Duhet patjetër të ekzistojë vullnet i qartë politik për ndryshimin e Kodit Zgjedhor, përndryshe nuk mund të bojmë asgjë. Kodi Zgjedhor, si i tillë, nuk është politikisht potent, nuk është ndonjë çështje si ato sociale, a do të ndahet diçka ose jo, dhe nuk është aq e famshme politikisht. Prandaj, duhet që pushteti të detyrohet në kohë ta ndryshojë, të bëhet shtypje, nga ekspertë, organizata...

GONG-u e pati të vështirë të nxisë ndryshime, dhe prandaj bashkëpunim dhe ndërtonim platforma me organizata të tjera joqeveritare. Kur të bashkoheni, është më lehtë dhe ju shohin më seriozisht dhe, normalisht, nuk mund të bisedoni për ndryshimin e Kodit Zgjedhor nëse nuk ofroni zgjidhje konkrete. Duhet të edukoheni dhe t'i shikoni praktikat komparative dhe, në bazë të kësaj, të propozoni ndryshime dhe zgjidhje.

Duhet të merreni vesh a do të luftoni përmes një procedurë parlamentare ose duke lobuar në ministrinë resore. E nëse e tërë kjo nuk ka sukses, atëherë dilni në rrugë. Mirëpo me këtë nuk e kam fjalën për shkatërrim. Ne, për shembull, e pritëm kryetarin tonë të Qeverisë në rrugë dhe i dhamë material dhe, në fund, arritëm të veprojmë që të miratohen ndryshime në ligj. Gjithsesi, jo vetëm se e pritëm para Qeverisë, por kjo ishte një ndër mjetet për shtypje. Prandaj është jetike që edhe organizatat në Maqedoni të

punojnë bashkë, të shkëmbejnë përvoja dhe të njihet pika më e fuqishme e secilit, dhe kështu të bashkuar mund të bëjnë shtypje për ligjin zgjedhor, që ndoshta për garniturën udhëheqëse është i fundit në listë...

Shohim se edhe tani kjo çështje nuk është tema kryesore, dhe është mirë që po diskutohet mbi të, pasi që vërehen zgjidhje të mundshme... Është i rëndësishëm roli i BE-së dhe komunitetit ndërkombëtar. GONG-ut ndihmën më të madhe ia kanë dhënë Delegacioni i BE-së, SHBA-të, Holanda, Britania..., sepse me ndihmën e tyre kemi bërë shtypje edhe më të madhe, gjë që ishte shumë e dobishme. Dhe tani e shfrytëzoj rastin që t'i falenderoj.

Unë shpresoj se edhe në Maqedoni, komuniteti ndërkombëtar do të luajë, ose veçmë ka luajtur, rol të rëndësishëm, të jetë një nga lojtarët kryesor që do ta ndryshojnë ligjin për zgjedhje dhe për ngritjen e standardeve demokratike në fushat tjera. Prandaj është e rëndësishme që të keni bashkëbisedues të mirë që do të kishte mundur t'ju ndihmonte në negocim. Ne në Kroaci, si pjesë e BE-së, tanimë nuk kemi mbështetje për lobim, por ju, për fat të mirë, ende keni, dhe shpresoj se do ta shfrytëzoni. Është jetike që komuniteti ndërkombëtar të njoftohet me problemet dhe ta vërejë rolin e rëndësishëm të organizatave qytetare që t'u ndihmojë të arrihen disa standarde demokratike. Poashtu, është e rëndësishme që secili shtet t'i respektojë obligimet ndërkombëtare. Domethënë, nëse veçmë kemi nënshkruar ndonjë dokument ndërkombëtar, duhet edhe si shtet t'i përmbahemi atij standardi. Në fakt, roli i opinionit vendor, por edhe atij të huaj, është të shqyrtohet se a i plotëson standardet një shtet i caktuar. Është e rëndësishme, gjithashtu, qytetarët të jenë të vetëdijësuar, e jo subjekte, siç kemi dëshirë t'i quajmë ne me shaka në Kroaci. Pra, duhet të luftoni për të drejtat tuaja dhe të jeni, në njëfarë mënyrë, korrektor i pushtetit, përmes vetëorganizimit dhe me argumente të paralamëroni për pikat e dobëta. Dhe, atëherë do të mësoni diçka edhe ju, po edhe institucionet. Pastaj, është e rëndësishme që secili shtet të ketë institucione plotësuese.

Meqë e përmenda BE-në, në Kroaci ligji zgjedhor nuk ishte kusht për mbylljen e kapitullit me gjyqësorin dhe mendoj se për Maqedoninë, poashtu, nuk është kusht, por ne

nuk guxojmë të harrojmë – edhe pse mendoj se edhe BE-ja nuk harron – se ka një sërë gjërash të tjera që janë të rëndësishme për zgjedhjet. Për shembull, kur është fjala për apele dhe ankesa, ju duhet të keni gjyqësor të pavarur, dhe kjo është e tëra. Nëse nuk keni gjyqësor të pavarur, nuk ka dobi prej një ligji zgjedhor të përkryer. Kështu, mbrojtja e të drejtës së votës nuk do të jetë në nivel të kënaqshëm. Pra, rastet me blerjen e votave, me frikësimin e votuesve në Kroaci janë vepra penale. GONG-u mundet të paralajmërojë, edhe CIVIL-i dhe MOST-i, por prokuroria e shtetit duhet ta ndjekë dhe ta dënojë kryesin. Prokuroria duhet ta kryejë punën e saj.

Edhe në vitin 2007 GONG-u bënte thirrje për gjëra të tilla, por askush nuk i kushtonte vëmendje. Kur u ndërrua qeveria dhe kur erdhi kryeministrja Kosor, filloi me procesim. Por pa ato mekanizma, pa ato rrota të vogla që janë të lidhura me procesin zgjedhor, nuk do të kemi standarde vërtetë të larta. Prandaj, GONG-u do të përgatisë paketkërkesa edhe për qeverinë e re, për përmirësimin e legjisllacionit zgjedhor, pasi që puna asnjëherë nuk kryhet.

Unë me të vërtetë shprej se ju, këtu në Maqedoni, do të keni shumë sukses në rregullimin e Kodit Zgjedhor, në arritjen e depolitizimit të institucioneve dhe gjyqësorit të pavarur, si dhe një prokuror që do të reagojë në apele dhe do të procesojë që të mos mbetet asnjë i paprekshëm. Të gjithë para ligjit duhet të jenë të barabartë.

Edhe ajo që është tmerrësisht e rëndësishme, sigurisht, është liria e medimeve! Pa medime dhe pa gazetarë, nuk ka zhvillim të madh. Për GONG-un medimet kanë qenë aleatë të mëdhenj.

Është në interes edhe të Maqedonisë, po edhe të qytetarëve të saj, jo vetëm t'i plotësoni kushtet e komunitetit ndërkombëtar dhe BE-së, por edhe të punoni që të keni cilësi dhe demokraci në vendin tuaj. Mendoj se është në dobi të Maqedonisë dhe keni të drejtë të keni medime të lira dhe gazetari të lirë.

CIVIL MEDIA: CILAT JANË REKOMANDIMET TUAJA KONKRETE PËR MAQEDONINË?

Do të filloj me dy fjalë: mbikëqyrje dhe frikë. Frika nuk shkon bashkë me demokracinë, sepse aty ku qytetarët kanë frikë, ekziston problem i madh dhe duhet të pyetemi se pse është kjo gjë kështu? Domethënë, në atë shtet kemi institucione që i paguajnë qytetarët ta kryejnë atë punë: të edukojnë ose të ofrojnë shërbime shëndetësore ose të kujdesen për mbrojtjen, finansat.

Dhe nuk duhet të kenë përgjegjësi për punën e tyre. Është evidente se ka problem me institucionet, por duhet të kemi medime që do t'i paralajmërojnë këto punë. Nga ana tjetër, as qytetarët nuk janë shenjtorë, ka qytetarë që i shkelin ligjet, pa dallim se a janë politikanë, deputetë, por edhe për personat e tillë ekzistojnë institucione që duhet t'i procesojnë. Pra, edhe ata i paguajmë ne, dhe nëse vjedh kryeministri, prokurori publik duhet të ngrisë proces kundër tij. Ose kundër meje, nëse unë vjedhi...

Shpeshherë qytetarët na drejtohen, sikur të ishte GONG-u polic, arrestojeni këtë ose bëjeni këtë. Jo, njerëz, ne jemi shoqëri qytetare, ka institucione që duhet të punojnë për këto raste. Prandaj duhet t'i inkurajojmë që ta kryejnë punën.

Çfarë mund të bëjë shoqëria civile? Ju mund të bëni zhurmë, por me argumente. Unë mund t'ju jap shembuj se si kemi vepruar ne. Qeveria e Sanaderit nga rezervat, për, mos dhashtë Zoti, vërshime ose termete, në bazë vjetore ka ndarë më shumë se 20 milionë euro në seanca të mbyllura. Qeveria mund të ndajë, por cilat janë kriteret dhe pse mbahet kjo gjë në fshehtësi? A u ndahen mjetet Kryqit të Kuq, për shembull, ose dikujt tjetër aty? Kur ne filluam të insistojmë në këtë çështje, Qeveria filloi të publikojë raporte ditore për seancat e mbyllura. Pasi që, nëse Kroacia dëshiron të anëtarësohet në BE, nëse Maqedonia dhe Serbia dëshirojnë, OK, urdhëroni, miratoni kriteret. Tek ne ky është mentaliteti i elitës politike, e cila ka shumë kujdes sa i përket rekomandimeve të komunitetit ndërkombëtar.

Ne, për shembull, ende nuk e dimë pse kryeministri ynë dha dorëheqje. Kjo gjë është

enigmë, disa spekulojnë se ka ndodhur si rezultat i shtypjes nga komuniteti ndërkom-bëtar, unë nuk e di, por është e rëndësishme që ai proces i vëzhgimit të vazhdojë. Unë edhe procesin zgjedhor e shoh vetëm si pjesë e procesit demokratik. Të gjitha ven-det mund të vijnë deri te një krizë demokratike, Kroacia mund të futet në një krizë demokratike brenda natës, shikoni se çfarë po ndodh me Hungarinë... Pra, vëzhgimi është tejet i rëndësishëm, poashtu edhe guximi i qytetarëve. Unë i kuptoj qytetarët e disa vendeve që nuk kanë guxim, mund t'i kuptoj, por frika është e papranueshme në çfarëdo lloj forme, qytetarët nuk guxojnë të frikësohen... Në kroaci, në zgjedhjet lokale, qytetarët lajmëroheshin dhe tregonin se po frikësohen nga ndonjë sherif lokal, pra, nuk frikësohen nga Qeveria ose Ministria, por kanë sherif lokal... Ka kryetarë komunash të përkryer, por gjithmonë ka përjashtime, që kërcënohen se dikush do ta humbasë pu-nën, koncesionin në plazhë... Gjëra të vogla, po të rëndësishme për jetën. Sistemi duhet të funksionojë, vëzhgim duhet të ketë dhe frika nuk guxon të ekzistojë...

CIVIL MEDIA: SITË KETË BESIM NË SEKTORIN CIVIL KUR EKZISTOJNË ORGANI-ZATA TË SHUMTA JOQEVERITARE FIKTIVE, NËN PATRONAZH TË PUSHTETIT?

Një nga të drejtat themelore është liria e shoqërimit. Në Kroaci është e garantuar e drej-ta e lirisë së shoqërimit dhe është e lejuar mbikëqyrja e lirë e zgjedhjeve. Ne konsidero-jmë se është e rëndësishme që një numër sa më i madh aktorësh të vetëorganizohen. Ne, në GONG, nuk dëshirojmë që vetëm ne t'i mbikëqyrim zgjedhjet, por dëshirojmë që sa më tepër organizata t'i vëzhgojnë zgjedhjet, por nën kushte të caktuara: të jenë të edukuar, të respektojnë standarde të caktuara. Dhe, sigurisht, nëse dilni në opinion dhe thoni se dëshironi të monitoroni dhe keni monitorues të edukuar, gjëja e parë që duhet ta cekni është kush ju finanson! Kjo është një mirësjellje minimale, disa masa minimale higjienike kur dilni në opinion dhe merreni me opinionin. Nëse thoni se do t'i monito-roni zgjedhjet në mënyrë objektive, atëherë duhet t'ju interesojë procesi zgjedhor dhe ta dini çka po monitoroni, si do të monitoroni dhe si do të njoftoni... Vëzhgimi shtëpiak është i rëndësishëm që të parandalohen dhe të zbulohen manipulimet, që të munden qytetarët të kenë besim në proceset zgjedhore. Nëse shihni qytetarë relevantë si vëzh-gues, atëherë mund të shpresoni se gjithçka është OK në atë vendvotim të caktuar dhe

se ka dikush që do të reagojë.

Të rëndësishëm janë edhe vëzhguesit ndërkombëtar, ata shpesh kanë infrastrukturë të mirë dhe mund të vijnë të përgatitur dhe në numër më të madh dhe në më shumë vende,



por është e rëndësishme që edhe ata të jenë të edukuar.

Tani, nëse paraqitet ndonjë organizatë fiktime, opinioni duhet ta shqyrtojë punën e tyre dhe t'i parashtrojë pyetjet: kush ju finanson, si jeni të organizuar, njëjtë sikurse i kanë pyetur politikanët.

Në Kroaci e kemi pasur rastin me organizatën "Familje", e cila vendosi t'i vëzhgojë zgjedhjet dhe na pyeti në një konferencë shtypi se a mendojnë se kemi konkurrencë. Ne u përgjigjëm – jo, sa më shumë vëzhgues, aq më mirë. Por dëshironim të dijmë se kush i finanson dhe si janë të edukuar vëzhguesit e tyre. Do të përsëris, sa më shumë vëzhgues, aq më mirë, por të vëzhgojnë nën kushte të caktuara dhe t'u përmbahen standardeve ndërkombëtare.

FINANCIMI POLITIK

KEQPËRDORIMET PA SKRUPULL DHE PARTIZIMI

Goran NAUMOVSKI

Prej Qershor 2015 deri në Korrik2015, si pjesë e projektit Zgjedhje të Lira për Qytetarë të Lirë, Civili ndër morri iniciativë për studimin e financimit për zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë. Gjatë kësaj kohe kemi angazhuar një numër të madh të ekspertëve ligjor për të analizuar Ligjin e zgjedhjeve të Maqedonisë, duke përfshirë ndryshimet e bëra në korrik 2015 pas Marrëveshjes së Përzhinës, me vëmendje të veçantë të dhënë për mekanizmat e zbatimit të ligjit dhe mbikëqyrjes të qeverisë dhe organet përkatëse. Ekipi ynë gjithashtu bërë intervista me ekspertë të shumtë dhe zyrtarë mire të përgatitur në subjektin e financave dhe fushatës. (ata të cilët ranë në dakord për të folur në mënyrë anonime) dhe zbuloi abuzime të rënda në pjesën e financimit politik.



Ndryshimet

cilësore dhe plotësimet e ligjeve për zgjedhjet, të cilat i përkasin financimit të fushatave zgjedhore të realizuara pas marrëveshjes së Przhinës, e imponuan pyetjen:

Vallë ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve të zgjedhjeve janë të mjaftueshme që ta ndalojnë financimin shumëvjeçar kriminal dhe korruptues të fushatave zgjedhore, por edhe të funksionimit të partive në përgjithësi, si dhe manipulimin e raportimeve financiare të partive?

Në nenin 4 nga Ligji për Financimin e Partive Politike, është qartë e përcaktuar se financimi i partive politike është publik dhe transparent, me inspektim të plotë të qytetarëve dhe organit përkatës për kontrollimin e punës financiare - materiale. Gjithashtu, burimet e financimeve të partive politike janë publike dhe janë objekt i kontrollit nga organet përkatëse në këtë lëmi.

Neni 5 nga ky Ligj, mundëson që çdo qytetar të ketë të drejtën e qasjes së barabartë në inspektimin e financimit të partive politike, por, edhe përsëri obligimit ligjor, publiku pothuajse aspak nuk është i njoftuar me burimet e mjeteve për financim të partive dhe harxhimin e tyre.

Në ueb faqen e disa partive politike aspak nuk janë të shpallura raportet vjetore financiare, ndërsa një pjesë e opinionit qytetar dhe ekspert shprehin dyshimin edhe në kontrollin të cilin duhet kryer, para së gjithash, për shkak të institucioneve të partizuara (në këtë rast, përkatëse është Ministria për Financa), dhe nëse në të vërtetë bëhet kontrollim mbi financat e partisë në pushtet.

Duke mos u ndalur në interpretimin e mëtejshëm të ligjit, bashkëpunimi i CIVIL- Qendrës për Liri me ekspertë të shquar nga Maqedonia dhe Kroacia, rezulton me konstatim gjeneral se zgjidhjet ligjore, të cilat e rregullojnë këtë materie, janë kryesisht të mira, dhe se institucionet për kontrollimin e financave, së paku në letër, kanë autorizime dhe kompetenca serioze.

Sidoqoftë, trupat në kornizat e institucioneve, përgjegjës për kontrollimin e punës financiare të partive, vetëm konstatojnë gjendje të caktuara dhe nuk ndërmarrin masa të mëtejme, që ka të bëjë me, para së gjithash, pavarësinë e kufizuar të këtyre trupave, gjegjësisht, për shkak të partizimit të plotë të institucioneve.

Në përmbledhjen e Entit Shtetëror të Revizionit për punën vjetore financiare të partive politike, pas revizionit të kryer, shpesh shprehet mendim me rezervë ndaj të vërtetës dhe objektivitetit të raportimeve financiare të partive dhe ndaj përshtatjes me rregulloren ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Inercia, partizimi i institucioneve dhe mos veprimi pas njohjes së veprimeve të caktuara joligjore, posaçërisht vërehet në pjesën e financimit të partive në fustën zgjedhore.

Në Kodin Zgjedhor është e cekur në mënyrë precize se çdo parti pjesëmarrëse në zgjedhje e ka për detyrë të hapë xhirrollogari të veçantë, nga e cila partitë do të mundën t'i financojnë fushatat e tyre (kuotat e anëtarësisë dhe donacione nga persona fizikë dhe juridikë), si dhe se kanë obligim ligjor të japin raport për të ardhurat dhe shpenzimet për 10 ditët e para dhe të dyta të fushatës deri te KSHZ, Enti i Revizionit, Komisioni Shtetëror Kundër Korrupsionit, si dhe raport përfundimtar më së voni 15 ditë pas kryerjes së fushatës.

Nëse shihen këto raporte nga zgjedhjet e fundit të parakohshme presidenciale në vitin 2014, do të konstatohen manipulime serioze, të cilat janë më të shprehura në raportet e partisë në pushtet, VMRO-DPMNE.

Në raportin e parë dhe të dytë janë cekur vetëm afati dhe forma, mirëpo nuk ka të ardhura nga donacione, që në raportin final të paraqitet një shumë e konsiderueshme pikërisht nga donacionet, i cili më vonë është korigjuar, kështu që dallimi mes të ardhurave (nga kuotat e anëtarësisë dhe donacioneve), dhe shpenzimeve, është negative, deri në denar e saktë për shumën që duhet ta paguajë partia nga buxheti sipas numrit të vendeve të fituara si deputetë.

Këto manipulime janë vetëm edhe një vërtetim për financimin korruptiv të partisë në pushtet, e cila, paratë e fituara në mënyrë jo- legale, kur paraqitet nevoja, përmes llogarive të transaksionit të dëgjueshmëve të tyre partiak i paguan në llogarinë e tyre. Në opinion u paraqitën disa deklarata nga persona që gjenden në listën e donatorëve, por nuk kanë dhënë mjete. Për praktikën e këtilla tregojnë edhe shumë paraqitje nga qytetarë deri te ekipet mbikëqyrëse të CIVIL gjatë proceseve të kaluara zgjedhore.

Jo realiteti i raportimeve del nga fakti se përfshihet vetëm periudha e fushatës zgjedhore, dhe llogaria e hapur vetëm për atë qëllim, ndërsa jemi dëshmitarë të një fushate të vazhdueshme agresive të partisë në pushtet, e cila pa ndërprerje ndodhë mes cikleve zgjedhore.

Në periudhën prej 1 qershor 2015 – 30 qershor 2016, të përfshirë nga projekti “Zgjedhje të lira për qytetare dhe qytetarë të lirë”, CIVIL konstaton thyerje pa skrupull të ligjeve me barazim të vazhdueshëm të aktiviteteve të qeverisë me të partisë.

Aktiviteti i vazhdueshëm në teren dhe mbikëqyrja afatgjatë e ekipeve të monitorimit të CIVIL, takimet me qytetarët, afaristët, përfaqësuesit e partive, si dhe paraqitjet nga qytetare dhe qytetarë, zbulojnë njohuri rrëqethëse për financime të vazhdueshme kriminale të partisë në pushtet, gjë që veçanërisht intensifikohet në periudhat parazgjedhore.

Shumat e mëdha të mjeteve me vite partia në pushtet i mbledh në mënyrë joligjore, përmes veprimeve korruptuese, shtypjeve, kërcënimeve, dhe shumë metodave tjera të palejuara.

Tenderët e rregulluar dhe provizioni i detyrueshëm i lartë prej tyre, është dukuri e rregullt të të gjitha nivelet e praktikimit të pushtetit, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

Është vërejtur tendencë e funksionarëve partiakë dhe të punësuarve në administratë që janë të pranuar me çelës partiak, të kenë obligim që një pjesë nga të ardhurat e tyre

t'i derdhin në arkat partiake. Përmes punësimeve partiake, partitë në pushtet e rrisin trupin e tyre votues, por edhe konton në llogaritë e tyre.

Për këtë arsye, partisë në pushtet i duhet të ndalojë promovimin e tentimit për administratë efikase dhe profesionale, ndërsa në praktikë të punojë në drejtim të kundërt me punësim të përditshëm të qindra anëtarëve partiakë.

Korrupsioni është shumë i shprehur edhe në relacion mes partisë qeverisëse dhe medieve. Derdhja e shumave të mëdha të parave popullore përmes of–shor kompanive, në të cilat nuk figurojnë, por pas të cilave qëndrojnë fuqi të caktuara partiake, duhet të jetë lëndë e hetimeve serioze.

Ekspertët e CIVIL janë të njëzëshëm se partitë janë burimi kryesor i korrupsionit.

Mirëpo, për të sjellë veprimet korruptuese në minimum, dhe për parandalimin e praktikës kriminale të financimit të partive, është e domosdoshme ndarja e partisë nga shteti, funksionimi efikas i shtetit ligjor, respektimi i ligjeve, profesionalizimi, por edhe përforcimi i kapacitetit të institucioneve përgjegjëse për kontrollimin e rregullsisë së financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore.

TRANSKRIPTE

OPINIONI DUHET TË DJË

Shkup, 20 Nëntor, 2015

Ekipi i ekspertëve, Aleksandra Joziq –Ile-
ković nga Qendra për Përsosmëri pranë
MPJ të Kroacisë dhe Dragan Zeliq nga
GONG i ndanë përvojat nga Kroacia, e
cila më herët pati përvoja të ngjashme
dhe sfida si Maqedonia.


Çdo shpenzim duhet të shkojë përmes llogarisë së veçantë. Kur flasim për njoftimet, të cilat me rregullore i përcakton ministri i financave, bëhet fjalë për më shumë njoftime, dhe të gjitha ato duhet të jenë të detajuara, me më tepër përmbajtje, së pari, raportim për donacione, pastaj raportim për shpenzime. Për GONG, interesant ishte veçanërisht raportimi për çmimet dhe për lirimet e realizuara në reklamimin të fushatave në media.

Këto janë tre elementet të cilat duhet të përmbajnë të dhëna shumë të sakta. Ju udhëzoj, nëse doni të hulumtoni, ndërsa shoh se keni dëshirë të punoni dhe mësoni, ta shihni mirë ueb –faqen e KSHZ të Kroacisë www.izbori.hr. Në ueb –faqen janë të shpallura raportime nga pjesëmarrës në zgjedhjet e fundit parlamentare në Kroaci, sa për krahasim dhe të shihni se sa është i madh dallimi mes të dhënave që kërkohen sipas ligjit tuaj dhe të dhënave që ne i kërkojmë. Ndërsa bëhet fjalë për një, potenciaj, një rregullore ligjore shumë të ngjashme.

Disa hulumtime treguan se zgjedhësit te ne i ndëshkojnë fushatat e shtrenjta dhe politikanët prepotentë. Dhe, pikërisht për këtë arsye është me shumë rëndësi të dihet se sa është shpenzimi, e sa është shpenzimi i deklaruar dhe dallimet mes tyre. Gjithashtu, duhet të dihet se si të vërehen edhe "satelitët", të cilët gjenden përkaj pjesëmarrësve në zgjedhje...Për shembull, për shoqatat e ndryshme tregtare, themelues të të cilave është pikërisht parti e caktuar, të shihet se cili është roli i tyre në procesin zgjedhor. Kjo, gjithashtu, është shumë interesante.

Nëse e krahasojmë modelin e përmbajtjes të Kodit Zgjedhor të Maqedonisë dhe ligjin e Kroacisë, ato janë absolutisht shumë të afërta. Atje ku detektua dallimin më të madh është se KSHZ e Maqedonisë, është në fakt trup, i cili i përmbledh raportimet nga pjesëmarrësit zgjedhor dhe i shpall, mirëpo nuk bën mbikëqyrjen faktike mbi ato raportime. Dhe, kjo është një nga rekomandimet, kështu që mendimi ynë është që ky trup, kjo dispozitë e ligjit duhet në hollësi të përcaktohet."





ANALIZË ZGJEDHORE

**ZGJEDHJE TË
LIRA: AQ AFËR,
MEGJITHATË AQ
LARG**

Xhabir DERALLA

Fqinjë

të cilët nuk këmbëjnë më vizita, vëllezër që nuk flasin njëri me tjetrin, prindër që frikësohen të flasin për politikë para fëmijëve të tyre nga frika që mos u tregojnë ata ndonjë gjë arsimtarëve të tyre nëpër shkolla... Arsyeja për këtë: politizimi i rrënjosur thellë në secilin aspekt të jetesës së njerëzve dhe frika shumë e përhapur. Frikë nga humbja e punës, nga hakmarrja, përrulja publike...frikë nga varfëria, nga varfëria edhe më e madhe...më tej, frika nga të tjerët, pavarësisht nga ajo se i përkasin ndonjë tjetër etnie, religjioni, shteti, orientimi seksual ose...partie politike! Dhe urrejtje...

Kjo nuk paraqet fillim të skenarit për film historik. Ky është realiteti i jetës së njerëzve në Maqedoni. Ata që besonin në të, që ishin larg nga e tërë kjo...kishin nevojë për vetëm disa ditë qëndrim në këtë vend që të kuptojnë se gjendja është edhe më e keqe edhe nga fillimi i këtij teksti. E dhe më groteske.

Historinë e sëmundjeve politike mund ta vëzhgojmë duke filluar shumë më prapa, duke i analizuar sëmundjet nga të gjitha perspektivat dhe kontekstet, por një gjë është e qartë: legjitimiteti i pushtetit politik është e jo ekzistues qysh nga zgjedhjet e parakohshme të vitit 2008.

Vit pas viti, ky vend kalonte nëpërmjet proceseve zgjedhore, të cilat e mbanin shoqërinë dhe sistemin në gjendje të pafund të shokut, duke zbuluar sëmundje thellë të rrënjosura shoqërore, etnike, religjioze dhe politike.

Për më pak se tetë vite (2006- 2014) vendi kaloi nëpër katër zgjedhje parlamentare, nga të cilat tre ishin të parakohshme. Zgjedhjet në vend mbaheshin në kushte të institucioneve shumë të politizuara, mediave të kontrolluara dhe tensioneve ndëretnike. Partia e njëjti i fiton zgjedhjet çdo herë, me ministrat pothuajse të njëjtë në sektorët kyç, e i njëjti person është zgjedhur për kryeministër dhe lider të partisë qeverisëse. Ndërsa, në ditën pas zgjedhjeve, fillon vala e re dhe e shtrenjtë e propagandës. I tërë ambienti politik në Republikën e Maqedonisë zhvillohet në kontekst të tensionuar zgjedhor.

Krizat politike kanë filluar shumë më herët nga ajo që tregohet në raporte. Largimi i

dhunshëm i deputetëve të opozitës nga ana e forcave speciale policore me 24 dhjetor tregonte vetëm një nga kulmet e krizës politike. Opozita zbuloi se rreth 25.000 qytetarë kanë qenë të përgjuar në mënyrë jo ligjore në aksionin e porositur nga kryeministri Nikolla Gruevski dhe Sasho Mijalkov, shef i shërbimit për siguri. Kjo është fakt. Bisedimet e përgjuara tregojnë për veprime penale serioze, keqpërdorime, korrupsion, si dhe mashtrime zgjedhore të zbatuara nga përfaqësues më të lartë politik dhe të pushtetit. Kjo është fakt.

Parlamenti ishte jofunksional deri në shtator të vitit 2015, për arsye të disa bojkotimeve nga opozita nga fillimi i krizës në vitin 2012, e veçanërisht pas zgjedhjeve parlamentare në prill të vitit 2014, rezultatet e të cilave u mohuan. Parlamenti është përsëri pothuajse jofunksional nga fillimi i vitit 2016 deri në momentin e mbarimit të këtij raportimi.

Zgjedhjet patjetër duhet të jenë të lira. Ky është qëllimi i fundit. Megjithatë, kjo deklaratë për qytetarin mesatar të Evropës me siguri se tingëllon si e jashtëzakonshme, sepse nuk ka fare kuptim të mbahen zgjedhje nëse ato nuk janë të lira. Ekziston një dozë turpi në këtë ftesë të vazhdueshme për zgjedhje të lira në disa vitet e fundit në një vend që është fundosur në, deri tani, krizën më të thellë politike pas pavarësisht nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë në vitin 1991. Thjeshtë, zgjedhjet janë çdo gjë, përveç të lira, posaçërisht prej vitit 2008 e këndeje. Ky është viti në të cilin, me shumë ose më pak, debati ishte i fshirë nga sfera publike. Në vend të debatit, u vendos mizoria, dhe propaganda vulgare dhe agresive.

Marrëveshja për tejkalimin e krizës politike (2 qershor), e ndërmjetësuar nga bashkësia ndërkombëtare dhe e nënshkruar nga katër liderët e partive të koalicionit qeverisës dhe opozitës (në ambient pothuajse të njëjtë si gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit në vitin 2001) - vendosi proces të komplikuar dhe turbulent politik, të plotësuar me shumë ndryshime drastike të situatës politike, prolongim të disahershëm të datës për zgjedhje, sfida sigurie, si dhe shkelje tjera politike dhe shoqërore. Kthimi i opozitës në parlament dhe emërimi i ministrave dhe zëvendës - ministrave nga opozita në sektorët kyçe ishte një nga kushtet e marrëveshjes për sigurimin e zgjedhjeve të lira. Por...

Keqpërdorimi i fuqisë, dhuna strukturore dhe korrupsioni politik vazhduan me tempo të njëjtë, edhe përskaj të gjitha orvatjeve për gjetjen e zgjidhjes për krizën politike. Vazhdoi edhe përlja publike dhe satanizimi, burgosjet dhe persekutimi i aktivistëve qytetarë, të aktivistëve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të intelektualëve, liderëve të opozitës politike, si dhe gazetarëve. Që situata të jetë edhe më e keqe, jemi dëshmitarë të manipulimeve të vazhdueshme dhe të fshehta, gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve serioze të paraqitjeve publike të përfaqësuesve politikë.

Nuk është vetëm fuqia politike ajo që imponohet mbi institucionet kyçe në shtet. I tërë shteti kontrollohet në mënyrë të sëmurë, deri në detajet më të imëta.

Shëndetësia, arsimiti, kultura, siguria, sigurimi shëndetësor- çdo gjë është vendosur nën kontrollin e aparatçikëve partiakë, të cilët i rregullojnë ligjet sipas nevojave ose i keqpërdorin në interes të shefave partiakë.

Frika dhe pasiguria mes qytetarëve janë shumë të përhapura, si praktikat dhe politikat e diskriminimit dhe shkelja e të drejtave të njeriut, përfshirë edhe të drejtat votuese. Votuesit nuk kanë të drejtë ose nuk i njohin të drejtat e tyre votuese. Ata u gjuhëzohen paragjyqimeve, gjegjësisht deluzioneve për atë se çka në fakt do të thotë demokracia dhe zgjedhjet. Duke u frikësuar për kaq shumë punë, të manipuluar dhe të trembur, një pjesë e madhe e votuesve janë vetëm subjekte memece të praktikave manipuluese të realizuara nga partitë politike dhe institucioneve të partizuara.

Rritja e pritjeve me premtime për vende të punës, të cilat nuk realizohen, duket se është mjeti më i dashur i politikanëve në vend. Shumë nga premtimet janë vendosje praktike e korrupsionit politik me përmasa të mëdha. Të tilla janë premtimet se do të krijohen më shumë vende pune, më shumë benefite, pensione më të mëdha...Premtimit për vende të reja pune pas zgjedhjeve kanë edhe një dimension, edhe pse zbatohen në mënyrë të korruptuar. Veçanërisht në këtë periudhë të krizës politike dhe të prolongimit të zgjedhjeve. Ata, të cilëve u janë premtuar vende pune pas zgjedhjeve, janë mjet manipulimi, për të cilët opozita, organizatat qytetare dhe " të huajt" janë fajtorë për prolongimin e marrëdhënies së punës. Prandaj, disa prej atyre, të cilëve u janë premtuar vende pune,

vullnetarisht marrin pjesë në kontra -protesta dhe kyçen në propagandë dhe mobilizim të ashpër partiak.

Duke i pasur parasysh dështimet dhe pengesat e Marrëveshjes për tejkalimin e krizës politike, ndalimi i negociatave për zbatimin e saj, pengesat e vazhdueshme në punën e PSP, kontrollin 4 fuqishëm të pushtetit ndaj mediave, si dhe punën shumë problematike të KSHZ, veçanërisht në pjesën e Listës së Votuesve, është shumë e qartë se nuk janë krijuar kushte për zgjedhje të lira, e as që po krijohen.

Më tutje, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për autorizimin e ri që presidenti të mundet të falë persona që kanë kryer mashtrim zgjedhor, që menjëherë pas kësaj të pasojë vendimi i kryetarit Ivanov për abolim të politikanëve të lartë, përfshirë edhe kryeministrin, i pandehur ose i akuzuar për keqpërdorim, korrupsion, vepra penale dhe mashtrime zgjedhore – imponoi pengesë të madhe në orvatjet për kthimin e demokracisë dhe sundimit të drejtësisë. Pas abolimit që e nënshkruajti Presidenti Ivanov me 12 prill, filluan protesta masive nëpër tërë vendin. Ivanov u tërhoq, në dy pjesë, me abolimin e tij famëkeq pas protestave dy mujore dhe me fjalimin, në të cilin pothuajse në mënyrë të hapur u kërcënua me grusht ushtarak me qëllim që “të zgjidhet kriza politike”. Të gjitha këto pengesa janë të vendosura për proceset e kufizuara me afate kohore dhe aktivitetet për sigurimin e kushteve për zgjedhje të lira dhe punën e pa penguar të PSP.

Vëzhguesit e CIVIL raportojnë për një numër të madh keqpërdorimesh dhe shtypjesh politike, kërcënime dhe frikësime. Keqpërdorimi i kategorive vulnerabile të qytetarëve, para së gjithash, të kategorive të dobëta sociale të qytetarëve, po vazhdon edhe më tej. Mediat nuk raportojnë për cilëndo nga këto dukuri, ndërsa njerëzit mbahen në terr. E tërë kjo duhet marrë parasysh në periudhën që vijon.

Vendi me siguri do të duhet të kalojë nëpër zgjedhje të parakohshme parlamentare në vitin 2016, deri sa termini i rregullt kohor për zgjedhjet lokale akoma do të paraqesë sfidë në pranverën e vitit 2017. Sfidat shtohen.

Revizion i Kodit Zgjedhor, ndryshime në sistemin zgjedhor, me të cilat Maqedonia do

të bëhet një njësi zgjedhore, vendosja e listave të hapura, pastrim themelor i Listave të Votuesve, reforma në KSHZ, ndarjen e partisë nga shteti, lirinë e mediave, formimin e institucionit për hetime në bazë të bisedimeve të përgjuara, hetime për krizën e sigurisë në Kumanovë dhe zbatimi i zgjedhjeve të lira në fund të këtij procesi – ishin kërkesat CIVIL pas kulminimit të krizës politike në fillim të vitit 2015, por edhe më herët. Ne tentuam që në mënyrë konstruktive të japim propozime deri te institucionet dhe deri te bartësit e vendimeve, së bashku me aktivitetet e shumë organizatave tjera dhe ekspertëve në drejtimin e njëjtë. Disa nga rekomandimet u pranuan, janë ndërmarrë hapa të caktuar, gjë që jep shpresë se gjendja në vend mund të përmirësohet.

Megjithatë, është e nevojshme të shohim më shumë punë, përkushtim më të madh dhe ndershmëri më të madhe nga bartësit e vendimeve dhe nga politikanët në vend, që më në fund të tejkalohen këto kohëra të vështira.

MEDIA ANALYSIS [1]

**MEDIAT
PAS PËRZHINËS
- GËSHTENJË
E NXEHTË
QË ASKUSH
NUK DO TA ZGJIDHË**

Petrit Saraçini



Foto: Vanço Xhambaski

Në periudhën pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Përzhinës, që, mes tjerash, përmban edhe detyrime të marra nga palët kontraktuese me të cilat adresohet dhe do të duhej të përmirësohej “pasqyra e gjakut” e mediave dhe lirisë së shprehjes, në Maqedoni, për fat të keq, po përballemi me vazhdimin e trendeve negative dhe degradim plotësues të lirive të mediave. Kriza politike që po eskalon që prej se opinionit publik mësoi për skandalin me përgjimet dhe për përmbajtjen e bisedimeve, të cilat zbuluan keqpërdorime të mëdha nga funksionarë të lartë qeveritarë, po reflektohet edhe ndaj medimeve, e me këtë edhe ndaj opinionit të gjerë publik. Në të gjitha raportet relevante ndërkombëtare Maqedonia po shënon rënie. Dhuna dhe shtypjet ndaj gazetarëve dhe mediave po rriten, institucionet nuk po veprojnë ose po veprojnë në mënyrë selektive, kurse pushteti po vazhdon të dominojë diskursin mediatik, duke e mbajtur pjesën më të madhe të mediave në përfaqim klientelesk. Në narracionet e mediave dominon etnonacionalizmi dhe urrejtja ndaj gjithçkaje që nuk përket në taborin “adekuat”.

Mirëpo, arsytet për gjendjet e këtilla nuk janë të kohëve të fundit. Ato janë të shumta dhe mund të njihen në të gjitha sferat të funksionimit të mediave, edhe atë për një kohë të gjatë.

Faktet tregojnë se Maqedonia ka një numër të mjaftueshëm (madje të tepërt) medimesh (veçanërisht elektronike), që më së shpeshti sqarohet si “pluralizëm” në hapësirën mediatike, mirëpo, në fakt, nuk është ajo. Në këtë kënetë të vogël të mbushur me krokodilla që luftojnë për publik më pak se dy milionë nuk ka treg të vërtetë, ndërsa dominojnë mediat private (kryesojnë televizionet nacionale) ndaj medimeve publike. Në kushte të këtilla, deshën apo s’deshën, në vend se t’i shërbejnë interesit publik, numri më i madh i medimeve u shërbejnë interesave të qendrave të fuqisë politike e ekonomike, kryesisht atyre që janë të afërta me pushtetin, që “disponojnë” me “qypin më të madh të parave” në vendin tonë, buxhetin e RM-së.

Rregullativa dhe vetërregullimi i ndjekin direktivat evropiane për zhvillim të politikave mediatike, por vetëm formalisht. Në praktikë, mungon zbatimi konzistent dhe joselektiv i ligjeve dhe vërehet mosrespektim i plotë i normave etike nga një numër i madh



mediumesh dhe shpërfillje e vetërregullimit e normave etike.

Servisi publik radiodifuziv duhet të kryejë veprimtari të interesit publik përmes disa kanaleve televizive dhe të radios, por po vazhdon të jetë megafon propagandistik i shumicës qeverisëse. Në të, edhe më përpara, edhe sot, çdo pushtet ka emëruar njerëzit e vet në pozitat udhëheqëse, edhe përkundër rregullave të shkruara qartë për zgjedhjen e tyre. Kështu, servisi publik vazhdon të sillt sikur t'ia ketë borxh pushtetit pavarësinë e vet redaktuese, kadrovike e financiare (edhe pse financohet nga tatimi radiodifuziv dhe nga buxheti – gjegjësisht nga qytetarët).

Kuadri i gazetarëve është i edukuar dhe i organizuar në shoqatë dhe sindikatë, por ato dhe anëtarësia e tyre janë nën shtypje të vazhdueshme, përkundër favorizimit të organizatave, në të cilat anëtarësohen njerëz që punojnë në media të afërta me pushtetin, shpeshherë kundër vullnetit të vet. Funksionimi i organizatave mediatike profesionale është forcuar, e aktivitetet që kontribuojnë për përmirësimin e gjendjeve në media janë shpeshuar, por ndikimi i tyre ende është i kufizuar, para së gjithash, për shkak të mungesës së solidaritetit në "bazë", që, sërish, është rezultat i shtypjes ndaj pronarëve, që në shoqërimin gazetaresk shpeshherë bile shohin rrezik më të madh sesa nga konkurrentët e tyre në politikë apo biznes. Mbretëron censura, por edhe autocensura.

Simbioza ndërmjet pushtetit dhe pronarëve të mediave – biznesmenë është e dukshme. Ajo e përcakton strukturën dhe përmbajtjen e produkteve mediatike, me çka ndikon mbi mënyrën në të cilën opinioni i gjërë publik i vëzhgon dhe informohet për ngjarjet shoqërore.

Madje, përmbajtja gjithnjë e më tepër nuk po prodhohet më në redaksi, po jashtë saj, në qendrat për komunikime të partive, e pastaj riprodhohet në formën e njëjtë në disa kanale televizive, të radios, të shtypura dhe të internetit.

Pozitat kyçe të redaksisë i mbajnë të dëgjueshmit, e ata që do të tregonin autonomi, marginalizohen dhe sanksionohen. Koncentrimi i pronësisë në mediat private në pak

duar e rrezikon shumëllojshmërinë dhe pluralizmin e mediave, kurse përpjekja për profit, që në mënyrë dominante fitohet prej mjeteve shtetërore (reklamave qeveritare dhe "prurjeve" të tjera të parave publike), në mënyrë direkte pasqyrohet mbi politikën redaktuese.

Praktikisht, mejnstrim-mediat thuajse tërësisht i janë nënshtruar instrumentalizimit për qëllime biznesoro-politike, prej cilit nuk kursehen as mediat lokale, por nga politika dhe biznesmenët në nivel lokal .

TË GJITHA RAPORTET NDËRKOMBËTARE FLASIN:

LIRITË MEDIUMORE JANË NË RËNIETË LIRË

Edhe këtë vit, gjendja me liritë mediatike, njësoj si edhe në vitet paraprake, shënon trend rënës shqetësues në të gjitha raportet dhe indeksat ndërkombëtarë. Organizata famëmadhe "Fridom Haus", në indeksin vjetor për "Lirinë e shtypit", për herë të parë e vlerësoi Maqedoninë si vend jo të lirë. Raporti i "Reporterëve pa kufij" e rangon Maqedoninë në vendin famëkeq të 118 të në botë.

Në raportin e fundit për përparimin për në BE për Maqedoninë, në pjesën e kriterëve politike, potencohet se kriza më e vështirë me të cilën po përballet vendi pas vitit 2001, për shkak të përgjimeve, në të cilat, siç konstaton Raporti, janë kyçur përfaqësues të pushtetit, përmes këtij skandali sugjerohet përzierje, mes tjerash, edhe në lirinë e mediave. Sipas KE-së, vendi ka një nivel të caktuar të përgatitjes sa i përket lirisë së shprehjes. Mirëpo, edhe përkaj asaj se korniza ligjore është kryesisht në përputhje me të drejtën e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare, megjithatë KE-ja konstaton se liria e shprehjes dhe e medimeve mbetet sfidë serioze në kulturën e tanishme mediatike dhe klimën politike, si dhe se vendi ka vazhduar me rrëshqitjen prapa gjatë vitit të kaluar.

Në zgjidhjen e mangësive që i potencon KE-ja në Raportin e Përparimit, thuhet se në vitin e ardhshëm vendi veçanërisht duhet të kushtojë vëmendje në sigurimin e trans-

parencës së tërësishme për reklamat qeveritare dhe zhvillimin e një mekanizmi për shpalljet e papaguara publike që me të vërtetë janë të interesit publik. Përveç kësaj, në rrafshin politik, sugjerohet përmbajtje nga ana e politikanëve dhe nëpunësve publikë nga ngritja e akuzave për shpifje, në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Si prioritet i tretë, raporti sugjeron që opinionit të gjerë t'i sigurohet qasje në raportim objektiv dhe të saktë, si dhe vështirime të ndryshme nëpërmjet mejnstrim-mediumeve, veçanërisht në servis publik radiodifuziv.

Mes tjerash, në lidhje me mediat dhe lirinë e shprehjes dhe informimit, në Raport thuhet se qasja në informata të karakterit publik është e kufizuar, kurse Komisioni është me kapacitet të pamjaftueshëm për ta zbatuar ligjin, si dhe se shoqëria civile po vazhdon të shprehë brengosje për shkak të përkushtimit fare të vogël ndaj dialogut nga ana e autoriteteve dhe të sulmeve të ashpra ndaj sektorit civil nga ana e mediave proqeveritare .

DHUNË, PENGIME DHE ARROGANCË – PËRDITSHMËRI E GAZETARËVE

Por, këtu nuk janë vetëm sulmet e ashpra ndaj shoqërisë civile, si koncept më i ngushtë. Një nga viktimat më të mëdha gjatë gjithë këtyre viteve sa ka zgjatur kjo krizë është komuniteti i gazetarëve (sipas disa modeleve teorike dhe ai është pjesë e shoqërisë civile). Edhe pas Përzhinës, vazhduan sulmet fizike ndaj gazetarëve, prej të cilëve asnjë nuk është zbardhur, vazhdoi pengimi në kryerjen e punës nga ana e policisë apo personave të tjerë zyrtarë a privatë, vazhdoi fshirja e incizimeve, ndalimet nga policia, kufizimi i lirisë së lëvizjes, goditja e gazetarëve në protesta...

Në ditën kur u nënshkrua aneksi i Përzhinës, më 15 korrik 2016, zëvendëskryeministri Vlladimir Peshevski fizikisht e sulmoi kryeredaktorin e ueb-portalit "Maktell", Sashe Ivanovski-Politiko, gjersa po i afrohej dhe po i parashtronte pyetje në lidhje me Marrëveshjen e Përzhinës. Sulmi është filmuar në video.

Vitin e kaluar në korrik, disa ditë pas nënshkrimit të aneksit të Marrëveshjes së Përzhinës, pronari i portalit "Dokaz", Marjan Stamenkovski, u rrah brutalisht para një kafiterie

në Shkup. Me këtë rast mori disa lëndime serioze në kokë dhe iu thye hunda.

Në mars të vitit 2016, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë pa kurrfarë shpjegimi ua ndaloi gazetarëve ndjekjen e seancës, në të cilën vlerësohej kushtetushmëria e Ligjit për Falje, edhe pse kjo gjë është në kundërshtim me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilës seancat mund të mbyllën për opinionin e gjerë publik vetëm nëse këtë e kërkon interesi i sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, ruajtjes së shtetit, ruajtjes së ndonjë fshehtësie zyrtare apo shterërore apo ruajtja e moralit publik.

Në muajin e njëjtë, redaktorit të televizionit nacional kabllorik "TV Shenja", Muhamed Zekirit, iu drejtuan kërcënime verbale nga përfaqësues të partisë në pushtet BDI.

Prilli i vitit 2016 është veçanërisht muaj "pjellor" kur kemi të bëjmë me dhunën dhe shtypjen mbi gazetarët. Gazetari dhe fotoreporter i Petar Stavrev nga Manastiri u sulmua fizikisht nga personi K.B. gjersa raportonte për protestat kundër kryetarit të komunës Vladimir Taleski, pas së cilës kishte intervenuar policia. Kameramani i TV Mega-s nga Manastiri, Vladimir Boshkovski, që sulmuar nga pjesëmarrës të protestës opozitare para Komunës së Manastirit. Kameramani që shtyrë e ofenduar dhe i që ndaluar të incizojë. Një grup qytetarësh të protestës kundërqeveritare ia patën demoluar hapësirat punuese Radios Maqedonia e Lirë (RML) në Shkup. Në këtë muaj, tre gazetarëve të gazetës "24 orë" nga Bullgaria u që ndaluar hyrja në vend në vendkalimin kufitar Deve Bair. Në fillim të prillit të vitit 2016, gazetari Jane Mamuçevski nga portali "Maleshevski Vesnik", me urdhër të kryetarit të komunës Dragi Nanxhiski, që larguar nga seanca e Këshillit të Berovës. Gazetari Mamuçevski pohon se për shkak të të njëjtave arsye i që dëmtuar edhe vetura private.

Më 13 prill 2016, një grup gazetarësh e fotoreporterësh qenë sulmuar fizikisht nga policia derisa raportonin nga protestat për shkak të vendimit për abolim para Zyrës për kontakt me qytetarë të presidentit Gjorge Ivanov. Gazetari Goran Naumovski i portalit "Pllusinfo" që goditur me shufër në kokë, me ç'rast kishte humbur vetëdijen, gjersa fo-

toreporterët Ognen Teofilovski nga "Vest", Naqe Batev nga "Veçer" dhe Borçe Popovski nga "Sloboden pečat", ashtu si edhe Tome Georgiev nga "Fokus" qenë sulmuar nga policë, edhe përsëri asaj se kanë qenë të shenjuar si duhet si gazetarë profesionalë. I goditur me mburojë policore ishte edhe kameramani i CIVIL-it, Nikolla Ugrinovski.

Në maj të këtij viti gazetarja Vanja Micevska nga radioja private nacionale "Kanal 77" u pengua fizikisht që të fotografojë dhe ta ndjekë tubimin e Lëvizjes Qytetare për Mbrojtje të Maqedonisë (LQMM) nga një pjesë e pjesëmarrësve. Ngjarja kishte ndodhur në prani të policisë. Jo vetëm që nuk kishte qenë e mbrojtur gazetarja, po policët kishin kërkuar prej saj të ikë nga tubimi.

Shembujt e fundit janë të freskët, të qershorit të vitit 2016. Në një rast, dy pjesëtarë të sigurimit të ish-kryeministrit Nikolla Gruevski hynë në oborrin e TV 21 dhe ia fshinë incizimet nga celulari zyrtar gazetarit Kristijan Llandov, i cili paraprakisht kishte incizuar ish-kryeministrin Nikolla Gruevski se si po kalonte në rrugën "Maqedonia".

Gazetari Tomislav Kezharovski që thirrur në bisedë informative në polici për shkak të pjesëmarrjes në Revolucionin e Larmë. Prokuroria e hodhi poshtë denoncimin për sulm fizik kundër pronarit të protalit "Skaj" nga Ohri, Sasho Denesoski.

Siç përmendëm edhe më lart, shumica e këtyre rasteve janë denoncuar në polici, mirëpo deri më tani opinioni nuk është i njoftuar se a është përballur me përgjegjësi ndonjëri prej atyre që kanë rrezikuar sigurinë e gazetarëve. Përkundrazi, pandëshkueshmëria e dhunuesve dhe mosazhurniteti i institucioneve janë gjithnjë e më të dukshme.

Përpos këtyre rasteve, janë regjistruar edhe dhjetëra ankesa ndaj gazetarëve për shkak të pengimit të lirisë së lëvizjes dhe pengimit të punës profesionale disa herë, por këto shkelje tashmë as vetë gazetarët nuk i konsiderojnë serioze dhe fare nuk nisin kurrfarë procedure, sepse janë të zhgënjyer nga shembujt e shumtë të anësisë së dukshme të gjykatave, kur janë nën goditje mediat dhe gazetarët që nuk janë të afërt me pushtetin. E le të mos flasim për shembujt e përditshëm të gjuhës së hapur të urrejtjes dhe thirrjeve për dhunë nga propagandistë të shquar të pushtetit, të cilët kalojnë pa u ndëshkuar.

Rasti i këtillë i fundit është hedhja poshtë e paraqitjes për thirrje për dhunë nga Milenko Nedellkovski ndaj shumë gazetarëve e personash publikë, që edhe Prokuroria e Lartë e hodhi poshtë në mes të qershorit të vitit 2016, me arsyetimin se bëhej fjalë për ofendime “personale”, edhe pse nga e shkruara qartë shihet urrejtja që ndërtohet mbi bazë karakteristikash grupore.

MORATORIUM TË FUSHATAVE PUBLIKE, PUSHTETI GJEN MËNYRA TË TJERA PËR “DERDHJE” TË PARAVE PUBLIKE DERITE MEDIAT E DËGJUESHME

Edhe pse mediat duhej të ishin pika e parë e bisedimeve që pasuan pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Përzhinës, reformat dhe marrëveshja konkrete e nënshkruesve të Përzhinës vazhdimisht shtyhej, kurse ato çështje edhe sot e kësaj dite mbetën të pazgjidhura.

Fillmi dukej premtues. Moratoriumi i fushatave qeveritare, i cili filloi të zbatohet që nga korriku i vitit 2015, menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes, në fakt, ishte pjesë e pakos së reformave në sferën e mediave, të cilat duhej të ishin të parat në agjendën e zbatimit të Marrëveshjes së Përzhinës. Moratoriumit i paraprinë njohuri për pagim enorm të mjeteve për fushata qeveritare në disa televizione nacionale të afërta me pushtetin.

Megjithatë, edhe përkundër këtij moratoriumi, pushteti vazhdoi të gjejë mënyra për “derdhje” të mjeteve publike te mediat, të cilat, si kundërshpërblim, plasonin përmbajtje me të cilat përkrahen politikat e pushtetit, kurse stigmatizohen opozita dhe shoqëria civile.

Si forma ndikimi ende mbeten paratë nga shpalljet publike (për konkurse, tenderë e të ngjashme). Përveç kësaj, për shembull, si mënyrë e vazhimit të përkrahjes financiare qenë përdorur edhe mjete që u lihen në dispozicion mediave televizive për prodhim të programit filmik vendor. Ky mekanizëm, i futur me legjisllacionin e ri mediatik, funk-

sionon në mënyrë jotransparente, kurse mjetet ndahen nga një organ ministror ndërresoror, i cili nuk e posedon ekspertizën e duhur për vlerësim të nevojave për këtë lloj programi. Sa për ilustrim, tri televizioneve u janë dhënë mjete në një vit për të incizuar tip të njëjtë programesh – tregime popullore maqedonase!

Përveç kësaj, një nga mënyrat për bartje të mjeteve është përmes një pjese të klientëve komercialë të afërt me partinë në pushtet, që i drejtojnë reklamat te këto medime. Me ato mjete, siç duket, përpos reklamës, paguhen edhe “shërbime” tjera.

Ndërkohë, në tregun e Maqedonisë u shfaqën disa medi të reja. Përpos televizionit të ri TV NOVA në gjuhën maqedonase (me lajme edhe në gjuhën shqipe), ambienti mediatik u pasurua edhe me dy televizione në gjuhën shqipe: TV 21, që ka lajme, debat dhe përmbajtje të tjera edhe në maqedonishte, ashtu si edhe TV Shenja. Të tri këto kanale televizive operojnë sipas licencës për mbulim nacional përmes rrjetit publik telekomunikativ. Gjithashtu, në treg u shfaq edhe një gazetë e re e përditshme në gjuhën shqipe “2+1”.

Ndërkohë, në kushte jashtëzakonisht të këqija për mbijetesë komerciale dhe thuajse pa kurrfarë përkrahje strukturore vazhdoi trendi i rrezikimit dhe mbylljes së mediave lokale dhe mediave të komuniteteve. Viktima e fundit e këtij trendi ishte mediumi më i vjetër privat në gjuhën rome TV BTR, i cili para do kohe ndërpreu transmetimin. Themi trend, për shkak të faktit më pak të njohur për opinionin e gjerë publik se në dekadën e fundit u shuan mbi 20 televizione, radio, gazeta ditore e të përjavshme të komuniteteve, edhe përkundër detyrimit të qartë të marrë për ndihmim të tyre, që qëndron në Marrëveshjen e Ohrit prej vitit 2001.

Në kontekst të këtij raporti dhe ofertës së mediave, që nënkupton zgjedhje të informuar të qytetarëve për ofertën politike dhe pluralizmin në përmbajtjet politike, mund të konstatojmë se oferta është rritur pak në kuantitet, por kur është në pyetje kualiteti – gjendja është pak më ndryshe.

Përkundër viteve kur pothuajse kishte mungesë të debateve televizive, tani ato janë

të pranishme me bollëk. Tani thuhet se çdo televizion që rrezaton nacionalisht, po edhe një pjesë e madhe e atyre që operojnë lokalisht, kanë emisione debati. Megjithatë, te mediat në gjuhën maqedonase (përveç disa përjashtimeve që e vërtetojnë rregullin, si, për shembull, debati ndërmjet deputeteve Kunovska nga LSDM-ja dhe Rangellova nga VMRO-DPMNE-ja, që ndodhi në këtë periudhë) vazhdoi të mungojë përballja direkte e pushtetit me opozitën, në varësi prej politikës redaktuese të mediumit.

Te një pjesë e mediave që punojnë në kuadër të standardeve profesionale, kjo mungesë e debatit të mirëfilltë ndërmjet pushtetit dhe opozitës po kamuflohet me zëvendësim të atij debati me debat ekspertësh, përfaqësuesish të shoqërisë civile dhe figurave të tjera publike, qëndrimet e të cilëve determinohen si të afërta "ndaj njëres palë apo të tjetrës" (edhe pse jo gjithmonë është ashtu), që nuk e zgjidh problemin e refuzimit të pushtetit të ulet me kundërshtarin e vet politik kryesor që po zgjat më shumë se një dekadë, dhe mospushtetin e mediave të bëjnë shtypje për përballje të tillë.

Gjithashtu, vërehet se përzgjedhja e mysafirëve në këto emisione në të gjitha televizionet si duket bëhet në një rreth prej njëqind vetash, që, kuptohet, nuk do të thotë se një pjesë e tyre nuk janë bashkëbisedues relevantë, por tregon për një rutinizim të debateve nga vetë mediumet.

Në vjeshtë dhe deri në fund të vitit 2015, në mediat e afërta me pushtetin janë vërejtur përpjekje për "hapje" të tyre ndaj opozitës, siç duket me sugjerim të faktorit ndërkombëtar, që në mënyrë indirekte e pranoi edhe kryeredaktorja e Kanal 5 në intervistën e drejtpërdrejtë që e kishte në lajmet kryesore në Kanal 5 me nënkryetaren e LSDM-së, Radmilla Shekerinskën . Kjo përpjekje për "pluralizëm demokratik" në mediat proqeveritare përfundoi në mënyrë groteske, me disa intervista sulmuese me lidhshpirtin e LSDM-së dhe me ministrat që hynë në qeverinë për zbatimitin e zgjedhjeve të parapara me Marrëveshjen e Përzhinës.

Megjithatë, te mediat shqiptare, debatet në kanalet televizive futën një cilësi shtesë në informimin e qytetarëve, por edhe i treguan anomali të tyre. Për shembull, vërehet se dialogu ndërmjet PDSH-së dhe BDI-së bëhet në debate mediumore, por vërehet një trend i ri i selektimit të realitetit, edhe atë: këto dy parti deri më tani më të fuqishme te shqiptarët shumë shpesh kanë refuzuar të ulen në përballje televizive me partitë "më

të vogla”, e deri më tani këtë dëshirë e respektojnë edhe mediumet. Përveç kësaj, prej mediave në gjuhën shqipe ka munguar kritikë relevante ndaj përfaqësuesve politikë dhe ndaj atyre që i përfaqësojnë interesat e votuesve shqiptarë në institucione, që zëvendësohet me kritikë, por për çështje të tjera jo aq domethënëse.

LIGJE DHE KUNDËRLIGJE

–THELB I KOKLAVITUR NË LABIRINTHE BUROKATIKE

Në Raportin e Pribesë në pjesën e mediave potencohen disa rekomandime:

- Të gjitha mediat duhet të jenë të jenë të liruara nga çfarëdo shtypje politike, pa përzierje e kërcënime.

- Mediumet duhet të distancohen nga politikat partiake dhe nuk duhet të jenë në shërbim të politikanëve dhe partive politike.

- Servisi publik nacional duhet të këmbëngulë/të përpiqet të jetë tërësisht i paanshëm dhe i pavarur nga ndikimet politike, komerciale apo ndikime a ideologji të tjera dhe të kontribuojë për një shoqëri të informuar.

- Mediat luajnë rol të veçantë në situata të krizës politike. Interesi publik është të zbulojnë gabime të mundshme në funksionimin e shtetit apo shoqërisë. Që këtu, organet publike duhet të përmbahen nga dekurajimi i mediave për ta bërë mandatin e tyre.

- Veprimet në lidhje me shpifjet nuk duhet të përdoren si mjet për të ngulfatur debatin apo për ta parandaluar thirrjen në përgjegjësi të figurave publike. Është veçanërisht shqetësuese kur politikanët padisin politikanë për shpifje, por gjithashtu kur padisin figura të tjera publike, në vend se të merren me zgjidhjen e dallimeve të tyre nëpërmjet mjeteve tjera, siç është debati publik.

- Gjykatat duhet të merren me paditë për shpifje në mënyrë të balancuar, pavarësisht nga implikimet e mundshme politike për rastin konkret. Gjykatat duhet të zhvillojnë praktikë të qartë dhe të parashikueshme për mbrojtje të lirisë së shprehjes në aspekt të padive për shpifje. Edhe ndërmjetësimi e vetërregullimi duhet të luajnë rol të veçantë në zvogëlimin e numrit të madh të rasteve që vijnë në gjykatë. Duhet të mendohet

zgjeroni i mbulimit të "kulmeve" ligjore aktuale për përgjegjësinë për shpifje të mediave për të gjitha llojet e të akuzuarve.

- "Blerja" e përkrahjes politike prej mediave përmes përkrahjes financiare të mediave është e papranueshme. Duhet të zbatohen rregulla të ashpra për reklamimin qeveritar.
- Pronësia e mediave dhe financimi i mediave duhet të jenë transparente.
- Kushtet e gazetarëve për punë duhet të përmirësohen me qëllim të zvogëlimit të vetë-censurimit .

Gjatë gjithë periudhës, grupet biseduese për mediat punuan për t'u marrë vesh për zgjidhje legjislative për zbatim të këtyre rekomandimeve. Në opinionin e gjerë dhe në kuloare qarkullonin propozime sa prej njëres, sa prej tjetres parti, shpeshherë gabimisht të transmetuara prej mediave, duke krijuar mjegull prej së cilës qartas mundej të lexohej vetëm një gjë: te pushteti mungon vullneti që në mënyrë thelbësore të zgjidhet kjo çështje, sepse mu mediumet janë një prej mjeteve kryesore përmes të cilëve kjo garniturë po mbahet në pushtet. Mirëpo, përveç moratoriumit formal të fushatave qeveritare, si dhe ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, ku thelbësor ishte vetëm pamundësimi i mediave të jenë donatorë të partive politike (që ishte e mundshme me Kodin paraprak), nuk kishte hapa të tjerë thelbësore në këtë drejtim.

Madje, edhe "oferta" e partisë në pushtet VMRO-DPMNE që opozita të zgjedhë çfarëdo ligji evropian për medime, të cilin pushteti menjëherë do ta kishte votuar, është porosi më vete. Veçanërisht kur edhe ligjet e deritanishme, që nuk ishin të këqija, nuk funksiononin, sepse pushteti i kontrollon ata që fillimisht duhet t'i zbatojnë këto ligje e që nuk e bëjnë atë, gjë që vërehet në të gjitha raportet ndërkombëtare e vendore për mediat në Maqedoni që disa vite me radhë. Në anën tjetër, partitë shqiptare në bisedime fokusoheshin vetëm në kërkesën për kanal të veçantë në gjuhën shqipe në servis publik të MTV-së, pa pothuajse asnjë kontribut tjetër në diskutime dhe negociata.

Në atë kuptim, nuk duhet të pritët ndryshim rrënjësor në strategjinë e pushtetit ndaj reformave në media – sa më pak thelb, e sa më shumë formë, të gjitha lëshimet janë të mundshme, vetëm jo kontrolli mbi paratë dhe institucionet që mund të sanksiono-

jnë sjellje të dhunshme, nderëse a urrejtëse, që, siç duket, po stimulohet pikërisht nga pushteti.

Në gjithë këtë lojë me propozime e kundërpropozime, ligje e kundërligje, ia vlen të përmendet propozimi, të cilin me ndihmën e diplomatit belg Piter Vanhaute e përpiluan ShGM-ja, bashkë me Sindikatën e Pavarur të Gazetarëve, IMM-në, QZHM-në, e që fitoi përkrahje nga një pjesë e madhe e bashkësisë mediatike liridashëse dhe nga shoqëria civile.

Propozimi parashihte zgjedhje të këshilltarëve në Agjencinë e Mediave dhe Shërbimeve Audiovizuale Mediatike dhe në këshillin programor të RTM-së përmes një konkursi, me përkrahje të organizatave profesionale e akademike, dhe zgjedhje me shumicën e dy të tretave në Kuvend. Ndryshimet parashihnin model tjetër për zgjedhje dhe mandat të drejtorit të agjencisë, detyrime për pluralizëm politik për programet informative, financim të TVM-së me 1% të Buxhetit, por edhe dispozita për llogaridhënie më të madhe financiare e programore të servisit publik, ashtu si edhe kthim të sanksioneve për gjuhë të urrejtjes.

Ky propozim, që u dorëzua edhe formalisht në Kuvend më 4 prill 2016, u refuzua nga shtëpia ligjvënëse.

SI TË VIJMË TE DALJA DHE ÇFARË TË BËJMË PO QE SE PRAPË HYJMË NË TUNEL?

Në këtë konstelacion do të ishte shumë optimiste të pritet që mediat të luajnë çfarëdo roli konstruktiv në opinionin publik dhe proceset politike në vend në të ardhmen e afërt.

E para dhe më kryesorja: pa u përmirësuar paraprakisht gjendja politike, nuk mund të pritet përmirësim i gjendjes së mediave. Mediat janë pasqyrë e shoqërisë, e çdo shoqëri ka pushtetin dhe mediat që i meriton. Fotografia e shëmtuar e shoqërisë në Maqedoni duhet patjetër të përmirësohet në shumë aspekte, e për të gjitha këto, fjalë kyçe janë – vullneti politik.

Pa filluar së funksionuari në mënyrë të pavarur institucionet dhe mekanizmat e shtetit të lidhura me mediat, që momentalisht janë uzurpuar nga partitë në pushtet, pa gjyqësi që do të sanksionojë gjuhën e urrejtjes dhe thirrjet publike për linç, dhunë, vrasje, pa zbatim të përpiktë e joselektiv të ligjeve për shpifje dhe ofendim duke e marrë parasysh praktikën e Gjyqit të Strazburgut, nuk mund të kemi medie të përgjegjshme e transparente.

Pa mundësim të kushteve të drejta të tregut për mediat dhe kushte të drejta për punë për gazetarët, pa filluar të funksionojë në Maqedoni “dora e padukshme e tregut”, e jo “dora e gjatë” e pushtetit, nuk mund të kemi medime të lira.

Pa respektim të standardeve të profesionit dhe kodeksit të etikës, nuk ka medie të lira. Po qe se gazetarët vetë nuk i zgjidhin çështjet, gjithmonë do të lënë hapësirë që dikush tjetër prej jashtë t’ua zgjidhë ato. Vetërregullimi është një prej boshteve, mbi të cilët prehet gazetaria e pavarur. Ai duhet të përqafohet e të kultivohet, e jo të sabotohet e të banalizohet.

Pa servis publik të pavarur, i cili do të jetë shembulli pishtar për mediat e tjera për standarde e cilësi, as cilësia e përmbajtjeve në mediumet private, që megjithatë kanë interesa private biznesore, nuk do të ndryshojë.

Po qe se punët mbeten kështu siç janë, gjendjet nuk do të ndryshojnë në të ardhmen e afërt. Përkundrazi, do të përkeqësohen dhe do të degradohen edhe më shumë, me çka do të ndikohet negativisht edhe në mundësitë që Maqedonia të dalë nga kjo krizë shoqërore, gjë që mund të ketë edhe implikime të tjera më të gjera rajonale.

MEDIA ANALYSIS [2]

TERRI MEDIATIK DHE ZGJEDHJET

Sinisha Stanković



Pas çlirimit të servilit publik MRTV dhe pas konvertimit shpifës të pronarëve të mediave deri tani të kontrolluara kombëtare –“sponsorë” të partive në pushtet, amortizimi paralel i shtypjeve mbi disa media të mbetura pro demokratike me bufer- zonën çdo herë e më të gjerë të qytetare(ë)ve të vetëdijesuar dhe inkurajuar, gjerësia e definicionit “kredibil”, ndoshta, edhe do të përfshijë zgjedhje të tilla... Por, pas një dekade helmimi të organizuar dhe të planifikuar në detaje të publikut, për zgjedhje të vërteta demokratike, Maqedonisë do t’i duhet kohë e gjatë për detoksikim demokratik. Procesi i pastrimit dhe për shërim dhe vetëdijesim të popullatës, deri në cilën shkallë është përmbysur shteti, si dhe për kthimin e kriterëve të vlerave dhe ndryshimeve rrënjësore për vendosjen e normave morale dhe profesionale.

Për një dekadë Maqedonia është vilajet i errët, edhe nëse krahasohet me pjesën e mbetur të Ballkanit të mjerë, edhe grope e zezë, e cila në kuptim të mediave është me vite drite larg nga standardet dhe normat evropiane dhe e cila, që të jetë edhe më tragjike, çdo ditë me shpejtësi të madhe po largohet nga bota e civilizuar. Dhe, për këtë arsye, njerëzve racional dhe me mendje të lirë në këtë vilajet, nuk u duhen as të dhënat për uljet rishtuese të Maqedonisë në listat e shteteve (jo) të lira të “Reporterëve pa kufij”, “Freedom report” ose “Amnesty International”, sepse këta, të detyruar të jetojnë në shtet në të cilin pushteti është i shurdhër dhe pa ndjenja ndaj të gjitha apeleve dhe paralajmërimeve nga Maqedonia – derisa për të huajt me hipokrizi pretendojnë se do të ndryshojë, vetëm që për më vonë të luajë lojën me ta në plan shtëpiak – thjeshtë, mbi lëkurën e tyre i ndjejnë pasojat nga terri i dendur mediatik. (Të gjithë ata që kanë mbledhur para dhe guxim, 600. 000 njerëz të edukuar dhe të ndershëm, me diploma dhe aftësi, ikën për të mos e kthyer kokën, sa më larg nga “oaza e paqes” të cilën “rilindësit” e dehur nga antika dhe baroku, e degraduan në kiç- kryeqytet karikaturë të Evropës”).

Nëse në dhjetë vitet e para të Maqedonisë sovraane, monopoli i NGB “Nova Make-donija” dhe i RTVM lehtë gufaste shpërthimet e rralla të guximit gazetaresk që të flitet për ngritjet në qiell të pushtetit të atëhershëm të LSDM, ministrat e së cilës i lejonin

vetes që në mënyrë të hapur dhe pa dënim të u kërcënohen gazetarëve me shpalljen e dosjeve të tyre ose të porosisin me ironi se gazetarët e mërzitshëm që marrin guximin të parashtrojnë pyetje për arrogancën e tyre, vetëm duhet të ushqehen me fekale (variant më i ashpër i versionit bullgar për "hedhje të ashtit" gazetarëve, me ardhjen e "japi- versionit" të VMRO- DPMNE (bujarisht e ndihmuar nga e dëgjueshmja BDI, pacifizmi i të cilës mbeti në recitime për NATO dhe BE, me ndonjë shuplakë për gazetarët e padëgjueshëm dhe me deklarata të ndryshme "kujt i bie", të përshtatura për ndërkom-bëtarene e mandej për etniken - maqedonase, e mandej për publikun etnik shqiptar), filloi plani monstruoz për mbyrtjen e mendimit të lirë në Maqedoni, mbi çdo tentim për mendim të kundërt, e mos dhëntë zoti, për kritikë të butë të gazmuesve popullor nga pushteti...

Kaosi me krijimin e qëllimtë të qindra dyqan - medimeve elektronike (urimeve dhe përshëndetjeve për dëgjuesit tonë) dhe shkatërrimi gradual por efikas i mediave të shtypit me konkurrencë të padrejtë gjatë reklamimit të partisë qeverisëse dhe institucioneve shtetërore (të ndihmuar nga ego- tripat e një pjese të pronarëve të mediave të shtypit, të cilët, për dallim nga situata në shtetet tjera, duke mos u gjetur në kushtet e reja, në fakt me lajtmotiv të bëhen " kalifë në vend të kalifit", me inat, vetë e mposhtën çmimin e medimeve të tyre), e trasoi rrugën drejt pamundësisë aktuale.

Dalëngadalë, pushteti e zhvendosi tehun e goditjes prej gazetarëve drejt pronarëve të medimeve. Ndërsa, pjesa më e madhe e tyre, të humbur në biznesin e mediave, nga frika, nën shantazh brutal, ose për shkak të mbushjes së çekmexhesë, edhe pse kryesisht me tendenca të hallvaxhinjve dhe bozaxhinjve ndaj politikës dhe gazetarisë, megjithatë, kishin sukses në gjetjen e numrit të mjaftueshëm të redaktorëve të tel-edirigjuar, që pa fjalë i kryenin urdhrat nga Zyra qendrore (Qendra për Komunikim e VMRO-DPMNE, ose, në vitet e fundit, vetëm anëtarët e Familjes..), dhe, duke i prerë në rrënjë tentimet e rralla dhe pa frymë të gazetarëve që të merren me profesionin e tyre dhe ta mbrojnë dinjitetin dhe nderin e tyre.

Kështu që, përmbytja e mediave, ne vend se me kuantitet të diferencojë cilësi, qiti në pah shumë erë të keqe dhe mbeturina...Para syve të publikut të habitur ose të pajtuar me fatin, në gazetari mbinë një sërë guracakësh – shitës të profesionit, u shtuan, hejterë, të marginalizuar, persona të zbrazët të cilët frustrimet e tyre të jetëve të tyre të gabuara i pështyjnë drejt në eter, duke nxitur urrejtje ndaj atyre që mendojnë ndryshe dhe duke e ndotur sferën e mediave, duke e modeluar realitetin virtual përmes propagandës së ulët dhe të tejdukshme, gënjeshtër e të cilës, për fat të keq, me përsëritjen e tyre si lloj mantrë për qeverinë më të suksesshme e cila ndërton dhe "realizon", për konspiracionet botërore kundër "vendit biblik" dhe për tradhtarët e vendit dhe spiunët e shërbimeve të huaja, u bënë e vërteta për një pjesë të mirë të popullatës të pa informuar. Në veçanti për atë ruralen, si dhe për kategoritë e qytetarëve më të moshuar, të blerë me subvencione ose me përfitime (me të cilat fshatrat dhe bujqësia janë edhe më të shkretuara dhe me borxhe për disa gjenerata të nipave dhe stërnipave)...Dhe, për më keq, gënjeshtër u bënë një lloj zileje qelqi e blinduar për qindra mija buxhetorë (pa marrë parasysh nëse janë të shtypur nëpër zyra me libreza partiake të VMRO-DPMNE ose të BDI, për "pajton- partitë" satelitore, e të mos harxhohet fjalë për – sipas motos, që nga "luaj derën- merr rrogën" u shndërrua në rrahje për karrige të atyre që shkojnë në punë ose në "rri në shtëpi – merr rrogë" për përfaqësim të drejtë, por jo në plan ndërnacional, por në plan koalicioni), ose janë vetëm njerëz " të thjeshtë", të cilët kanë qenë profesionistë, por për një dekadë të tërë, të ngrirë nga frika për ekzistencë, heshtin dhe durojnë..

Bdurojnë..

Pushteti në mënyrë brutale i ekzekuton mediat tradicionale pro - demokratike në Maqedoni, edhe gazetarinë ka kohë që e kemi në shuarje. Jeton sa për të jetuar, përmes mediave të reja, në rrjetet sociale, përmes britmës së gazetarëve qytetarë, aktivistëve, luftëtarëve për liri...Mirëpo, edhe kjo hapësirë, si më herët me okupimin e hapësirës së mediave në nivel lokal me rrjetin e televizioneve komunale ose rajonale nën ombrellën

e VMRO-DPMNE, është infektuar me qindra kinse - portale me pronarë dhe burime të të ardhurave të panjohura, baza e të cilave është përhapja e gënjeshtreve dhe nxitja e urrejtjes.

Derisa në Maqedoni nëpër media heshtet për 80 foshnje të vdekura dhe 40 pacientë të vdekur në spitalin psikiatrik, ndërkohë që shpallen lajme për prerjen solemne të shiritit për kalim për këmbësorë nga ish - kryeministri, thjeshtë, nuk ka shans për ringjallje të skenës së mediave...Për fat të keq, me media të tilla, me të vërtetë nuk janë të mundshme zgjedhje fer dhe të lira në Maqedoni për një kohë të gjatë...

RAPORTE TË AKTIVITETEVE

**NGJARJE PUBLIKE
PËR ZGJEDHJE TË
LIRA**

Përgatiti: Ekipi i Civil-it





RAPORT [1]

NGJARJE PUBLIKE

Marija TEGOVSKA

CIVIL mbajti 25 ngjarje publike anembanë vendit, gjatë zbatimit të projektit Zgjedhje të Lira për Qytetarë(ë) të Lirë. Mbi 30 parti politike, mbi 50 OJO në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe qindra qytetarë, morën pjesë në ngjarjet tona publike që u organizuan në hapsira të mbyllura dhe të hapura. Këto raporte përmbajnë vetëm një seleksionim të shkurtë të aktiviteteve të komponentëve të këtij projekti.

Debate publike “Pluralizmi dhe kriza politike”

Mungesa e debatit politik është evidente në dhjetë vitet e fundit në Republikën e Maqedonisë. Debatit mungonte edhe gjatë procesit për tejkalimin e krizës politike në Maqedoni për arsye të ekskluzivitetit të formatit të negociatave. Këto pothuajse në tërësi i mënjanuan partitë me më pak vota të fituara në zgjedhjet e kaluara dhe partitë jashtë-parlamentare, ndërsa vend në atë proces nuk pati as për organizatat e shoqërisë civile, lëvizjet dhe iniciativat, si dhe për bashkësinë eksperte.

CIVIL – Qendra për Liri organizoi katër debate publike mbi temën: “Pluralizmi dhe kriza politike”, me qëllim të kontribuojë për debatin shoqëror, dhe përmes pjesëmarrjes së partive politike dhe bashkësisë së ekspertëve të ofrojë zgjidhje për dalje nga kriza në vend. Qysh nga fillimi i procesit, i cili u përputh me fillimin e implementimit të projektit “Zgjedhje të lira për qytetare dhe qytetarë të lirë”, CIVIL insiston në inkluzivitet në procesin, ndërkohë që dha kontribut serioz dhe të dukshëm ndaj debatit shoqëror, përmes kyçjes të një numri të madh të partive politike, ekspertëve dhe organizatave qytetare nëpërmjet ngjarjeve publike, në të cilat morën pjesë edhe numër i madh i mediave, diplomatëve dhe qytetareve dhe qytetarëve të interesuar. Të gjitha materialet dhe video – regjistrimet lidhur me këto ngjarje mund të gjenden në onlajn- kanalet e CIVIL, si dhe në shumë media tjera, të cilat e morën këtë përmbajtje ose vetë prodhuan përmbajtje adekuate informative. Në këtë përmbledhje shkurt do të paraqesim një pjesë nga ngjarjet publike në korniza të projektit.

Në debatet publike morën pjesë liderët dhe përfaqësuesit e lartë të një numri të madh të partive politike që nuk janë pjesë e negociatave për tejkalimin e krizës politike. Ata

dhanë kontribut të çmueshëm për hapjen e çështjeve, të cilat janë me rëndësi thelbësore për proceset politike që po zhvillohen në vend. Prezentimet e tyre përmbajnë informata të rëndësishme dhe qëndrime për gjendjet, por, që është më me rëndësi, atë ofruan vizione dhe zgjidhje për dalje nga kriza. Në debatin e fundit publik të këtij lloji, i ftuam edhe përfaqësuesit e katër partive politike të kyçura në negociatat për dalje nga kriza politike. Asaj ftese iu përgjigj vetëm lideri i opozitares LSDM, Zoran Zaev.

Në të gjitha debatet publike së bashku morën pjesë mbi 30 liderë dhe përfaqësues të lartë të partive politike, numër i madh ekspertësh, ndërsa në prezencë të numrit të madh të mediave dhe përfaqësuesve të korit diplomatik, shoqërisë civile dhe misioneve mbikëqyrëse

Teza fillestare për debatin publik “Pluralizmi dhe kriza politike”, e cila u mbajt me 4 prill të vitit 2016, ishte: Marrëveshja për tejkalimin e krizës politike (Përzhinë, 2015) është vetëm pjesërisht e implementuar. Institucionet, të cilat janë të obliguara të sigurojnë zgjedhje fer dhe sundimin e drejtësisë, ballafaqohen me pengesa politike dhe mediatike, si dhe me pengesa nga institucione tjera. Vallë janë të mundshme zgjedhjet me 5 qershor? Cilat janë qëndrimet dhe zgjedhjet për tejkalimin e krizës të cilat mundën t’i ofrojnë partitë politike të cilat nuk janë të kyçura në procesin e Përzhinës?

Morën pjesë liderë dhe përfaqësues të lartë të 18 partive, ndërsa ngjarja nxiti interesim edhe më të madh në opinion.

Civil organizoi edhe panel- diskutim ekspertësh, nën titullimin e njëjtë, me 17 mars të vitit 2016.

Në këtë panel morën pjesë ekspertë të mirënjohur, të cilët i paraqitën ekspertizat e tyre për krizën politike dhe për procesin zgjedhor në vend. Qëllimi i këtij debati ishte kontributi për zhvillimin e ambientit pluralist dhe debatit në shoqëri, përmes paraqitjes së qëndrimeve të ndryshme të bashkësisë eksperte.

Pjesëmarrës në panelin ishin Sandra Gavrillovska, avokate dhe eksperte juridike, d-r Sasho Ordanoski, analist politik dhe profesor universitar, dhe Aleksandar Novakoski,

avokat, ekspert juridik dhe kryetar i mëparshëm i KSHZ.

Debatin e hapi Ekselencia e Saj, ambasadorja e Republikës Federale të Gjermanisë d-r Kristine D. Althauzer. Ky debat ekspertësh jehoi larg në opinion dhe paraqiste hap ndaj prolongimit të parë të datës së zgjedhjeve (24 prill), për të cilin prolongim CIVIL insistoi qysh nga fillimi i procesit politik në qershor të vitit 2015.

CIVIL e organizoi edhe debatin e katërt publik mbi temën: “Pluralizmi dhe kriza politike”,



në të cilin morën pjesë përfaqësues nga 21 parti politike në Maqedoni. Në këtë ngjarje të madhe publike ishin të ftuar të marrin pjesë përfaqësues nga të gjitha partitë politike. Në debatin publik, përskaj partive politike, ishin prezent mbi 50 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të mediave, të iniciativave qytetare dhe të përfaqësive diplomatike dhe misioneve monitoruese në Re-

publikën e Maqedonisë.

Kritika të ashpra në llogari të pushtetit, prolongim të zgjedhjeve të paralajmëruara për 5 qershor, tërheqjen e faljes të Ivanovit, çlirim të mediave, departizim të gjykatës dhe shumë masa dhe reforma tjera për daljen nga kriza politike në Maqedoni..., ishin vetëm një pjesë e analizës së CIVIL, e cila ishte e paraqitur para pjesëmarrësve në fillimin e debatit.

Pasuan qëndrimet e përfaqësuesve më të lartë të partive politike që morën pjesë në debat. Prezent ishin edhe numër i madh i mediave, përfaqësues të sektorit civil dhe të përfaqësive diplomatike dhe misioneve mbikëqyrëse në vend.

PANEL-DISKUTIMI:

E drejta votuese dhe financimi politik

Panel - diskutimi me temë “Zgjedhje të lira për qytetare dhe qytetarë të lirë” u mbajt në kornizat e vargut të ngjarjeve, konsultimeve, trajnimeve dhe mbledhjeve koordinuese nën titullin e njëjtë “Ditët e të drejtës votuese”. Ngjarja u mbajt me 11 dhjetor, pas Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor, që të theksohet rëndësia e të drejtës votuese, një nga të drejtat fundamentale të njeriut. Ngjarjen e hapi Ekselencia e Saj, ambasadorja e Republikës së Kroacisë, Daniela Barishiq.

Panelistë ishin ekspertët nga Kroacia, Marina Shkrabalo dhe Dragan Zeliq nga organizata joqeveritare kroate – GONG dhe Aleksandra Joziq - Ilekoviq nga Qendra për Përsosmëri pranë Ministrisë për Punë të Jashtme dhe Çështje Evropiane të Republikës së Kroacisë. Qëndrimet e CIVIL i paraqitën Xhabir Deralla dhe Sinisha Stankoviq.

CIVIL ftoi qytetarët dhe qytetarët të ndihmojnë në tejkalimin e krizës së rëndë politike dhe të kontribuojnë për krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të lira: “Vlerësojmë se është e mundshme, përkaj afatit të shkurtë kohor, të krijohen kushte për zgjedhje të lira, por vetëm nëse ka vullnet politik nga bartësit përgjegjës të vendimeve.

Gjithashtu, pjesëmarrja e të gjithë qytetareve dhe qytetarëve do të jetë vendimtare në këtë proces. Ftojmë të gjithë qytetarët dhe qytetarët, çdo individ, të ndihmojnë që Republika e Maqedonisë të zbatojë zgjedhje cilësore, fer dhe demokratike. Secili duhet të aktivizohet dhe të kontribuojë. Çdo parregullsi dhe sjellje korruptuese, çdo shtypje dhe abuzim, çdo lloj dhune, duhet paraqitur. Në atë mënyrë secili nga ne fiton mundësinë për të dhënë kontribut në përmirësimin e gjendjeve në vendin tonë”.



qytetarë të lirë”, u mbajt edhe ngjarja publike me temë: “Financimi i partive politike dhe fushatat zgjedhore” me ekipin e ekspertëve nga Kroacia, Aleksandra Joziq - Ilekoviq, nga Qendra për Përsosmëri pranë Ministrisë kroate për Punë të Jashtme, dhe Dragan Zeliq nga GONG. Në takimin ishin të ftuar përfaqësues nga të gjitha partitë politike, organizatat e shoqërisë civile, aktivistë, media dhe qytetare e qytetarë të interesuar.

Me këtë rast dhe me qëllim të shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, CIVIL shpalli analizë, në të cilën u dha pasqyrë e vitit të kaluar, manipulimeve me të drejtën e votimit dhe shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut. Analiza është e titulluar “Maqedonia: frikë dhe shpresë”.

Në kuadër të projektit “Zgjedhje të lira për qytetare dhe

Kontakti i drejtpërdrejtë me qytetaret dhe qytetarët

Në katër qytete (Shtip, Manastir, Gjevgjeli dhe Kumanovë) të cilat janë të përfshira me projektin “Zgjedhje të lira për qytetare(ë) të lirë”, CIVIL mbajti ngjarje publike, ku përmes formës së medias rrugore, u distribuuan materiale informative për zgjedhjet, ndërsa qytetaret dhe qytetarët patën mundësinë të informohen për të drejtat e tyre si votues, për nevojën për mbajtje të zgjedhjeve të lira, fer dhe demokratike, si dhe për rolin e të gjithëve në këtë proces.

Në Ohër, për arsye të interesit të madh dhe pranisë së madhe në takimet e kaluara, u mbajt ngjarje e madhe publike.

Në ngjarjen publike nën moton “Të gjithë për zgjedhje të lira” në Shtip, ekipi i CIVIL për 90 minuta bisedoi me qytetarë të Shtipit për të gjitha çështjet që i mundojnë në aspekt të të drejtave të njeriut, në veçanti në kontekst zgjedhor. Me shumë muzikë dhe artikuj nga audio - produksioni i CIVIL-Media, xhingla për zgjedhje të lira dhe të drejtat e votuesve, ekipi i CIVIL ka ndarë qindra fletushka dhe material të llojllojshëm për zgjedhjet e ardhshme dhe bisedoi me të gjithë qytetarët e interesuar, të cilët shprehën dëshirë për bisedë. Edhe pse kishte dëborë dhe moti ishte i ftohtë, ngjarja u mbajt në frymën e maksimës së CIVIL – se të gjitha kushtet e motit janë të përshtatshme për aktivizëm. Në deklaratë për mediat e Shtipit, përfaqësuesit e CIVIL edhe njëherë ftuan qytetaret dhe qytetarët të kyçen drejt orvatjeve për sigurimin e zgjedhjeve të lira, por edhe drejt institucioneve dhe partive politike për departizim urgjent të institucioneve, çlirimin e mediave dhe shprehjes së lirë në Maqedoni, dhe pastrimin e Listës Votuese.

Mbi 600 qytetare dhe qytetarë të Manastirit morën pjesë në ngjarjen publike “Të gjithë për zgjedhje të lira”. Ngjarja ishte e organizuar me mbështetje nga shoqata “Për ne bëhet fjalë”. Gjithashtu, u zbatua edhe foto-peticioni, në të cilin morën pjesë pesëdhjetë vizitorë, ndërsa pjesëmarrësit i ndoqën audio dhe video materialet e CIVIL, të cilat e ilustronë realitetin në Republikën e Maqedonisë. “Kjo nuk është në lajmet dhe në TV- stacionet nacionale!” – është tizeri ngacmues i CIVIL për këtë ngjarje, të cilin mediat e Manastirit e paralajmëruan disa ditë më parë si “lajme në natyrë”.

Përfaqësuesit e CIVIL dhe “Për ne bëhet fjalë” mbajtën edhe pres konferencë për mediat e Manastirit, të cilët iu përgjigjën ftesës të organizatorëve të ngjarjes, dhe së bashku falënderuan për mbështetjen e madhe nga qytetaret dhe qytetarët e Manastirit dhe nga tërë vendi.

Mbi 600 qytetare dhe qytetarë të Kumanovës morën pjesë në ngjarjen publike “Të gjithë për zgjedhje të lira”. U zbatua edhe foto-peticion, ndërsa pjesëmarrësit i ndoqën audio dhe video materialet e CIVIL, të cilat e ilustronë realitetin në Republikën e Maqedonisë. Përfaqësuesit e CIVIL mbajtën edhe pres – konferencë për mediat e Kumanovës.

Me muzikë, xhingla, video klipe, foto - petition “Të gjithë për zgjedhje të lira”, fletushka për të drejtat e votuesve dhe biseda me qytetare dhe qytetarë të Gjevgjeliës, u mbajt ngjarja publike në këtë qytet. Përforcimi i vetëdijesimit për të drejtat votuese dhe kontributi drejt krijimit të kushteve për zgjedhje të lira, e shënuan ngjarjen publike.

Ngjarjen publike “Të gjithë për zgjedhje të lira” në Ohër, e hapi Angel Janev, zëvendës kryetari i qytetit të Ohrit. Ai shprehi mbështetje për kërkesat për zgjedhje të lira, e përshëndeti punën e CIVIL dhe paraqiti akuza ndaj opozitës se ik nga zgjedhjet. U mbajt debat për krizën politike dhe për kushtet për mbajtjen e zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë. Edhe pse në momente i ashpër dhe i antagonizuar, me prezencë të dukshme të bartësve të funksioneve të pushtetit lokal në Ohër, të cilët morën pjesë në debat me akuza drejt CIVIL, debati megjithatë, kaloi kryesisht në frymë demokratike.

Ngjarjet publike në Shtip, Manastir, Kumanovë, Gjevgjeli dhe Ohër, u mbajtën në periudhën nga dhjetori i vitit 2015 deri në shkurt të vitit 2016.

RAPORT [2]

**EDUKIM DHE
TRAJNIME
QYTETARE**

Dehran MURATOV

Seminare për zgjedhje të lira

Në korniza të projektit “Zgjedhje të lira për qytetare dhe qytetarë të lirë”, përfaqësuesit e CIVIL –Qendrës për liri mbajtën 6 seminare për zgjedhje të lira në Shkup, Kumanovë, Manastir, Ohër, Shtip dhe Gjevgjeli.

Në seminarët morën pjesë anëtarë dhe mbështetës të CIVIL, organizata dhe iniciative lokale qytetare, si dhe qytetare dhe qytetarë të interesuar të cilët aplikuan për pjesëmarrje në seminarët. Në seminarët morën pjesë 155 pjesëmarrës, nga të cilët – në Manastir 38, në Ohër 21, në Shtip 23, Kumanovë 30, në Gjevgjeli 19 dhe në Shkup 24. Si çdo herë, CIVIL u kujdes për baraspeshën gjinore dhe diversitetin etnik në seminarët.

Pjesëmarrësit në seminarët u njohën me të gjitha aspektet e punës së CIVIL lidhur me zgjedhjet, të drejtën votuese dhe të drejtat e njeriut dhe liritë në përgjithësi. Gjatë kësaj, filloi proces i formimit të rrjetit të qytetarëve aktiv, të cilët kontribuojnë për vëzhgimin e procesit dhe ngjarjet relevante të projektit, si dhe formimin e rrjetit të gjerë për mbështetje të proceseve, të cilat duhet të çojnë drejt zgjedhjeve të lira.

Seminaret përfshinin aspekte teorike dhe empirike të proceseve zgjedhore, sistemeve zgjedhore dhe mangësive sistemore, fushatë politike dhe rolin e mediave, monitorimin, lajmërimin dhe edukimin për proceset zgjedhore, të drejtën votuese, të drejtat e njeriut dhe liritë në përgjithësi, si dhe udhëzime praktike për monitorim të proceseve zgjedhore.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në seminar mbetën aktivë dhe kohë pas kohe dërgojnë informata për gjendjet në teren, njëkohësisht janë edhe edukatorë dhe i shpërndajnë informatat dhe dijenitë nëpër rrethet e tyre.

Në seminaret, CIVIL formoi edhe Grupe punuese rajonale për zgjedhje të lira, në të cilat ftoi përfaqësues të partive politike, komunave, organizatave civile, mediave, institucioneve lokale, biznes shoqërinë, liderët e shoqërive dhe qytetare dhe qytetarë tjerë të interesuar.

Në seminaret ishin mysafirë ekspertë të mirënjohur nga Maqedonia, por edhe nga Republika e Kroacisë (Qendra për Përsosmëri pranë MPJ Kroate dhe GONG, organizatë shumë e njohur për përvojën e tyre dhe ekspertizën në monitorimin zgjedhor dhe sistemet zgjedhore).



Stenda informative dhe zona të lira të CIVIL-it

CIVIL – Qendra për Liri për projektin “Zgjedhje të lira për qytetare e qytetarë të lirë” organizoi mbi 60 stenda informative nëpër gjithë vendin, prej të cilëve 19 ishin vendosur në lokacione të ndryshme të Shkupit. Përmes këtij aktiviteti, ekipet e CIVIL-it kontaktuan drejtpërdrejt me pothuajse 20.000 qytetare e qytetarë

Stendat informative kishin për qëllim njoftimin e drejtpërdrejtë me aktivitetet e organizatës, për distribuimin e materialeve edukative dhe për të drejtën e votës, ashtu si edhe për të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi, për kërkesat e propozimet e CIVIL-it për reforma në sistemin zgjedhor dhe masat që duhet të ndërmerren për tejkalimin e krizës politike dhe sigurimin e kushteve për mbajtje të zgjedhjeve të lira.

Stenda e parë informative në suaza të këtij projekti ishte vendosur më 17 shtator 2015 në qendër të Shkupit.

Në këto stenda informative përfaqësuesit e aktivistët e CIVIL-it shpërndanin material të shtypur në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe, ndërsa në vëllim më të vogël edhe në gjuhën rome, turke e serbe. Vizitorët njoftoheshin se të gjitha materialet, po edhe përmbajtje të tjera relevante janë në dispozicion në www.civil.org.mk.

Në stendat informative të CIVIL-it organizohej edhe foto-peticion me porosinë “Unë jam për zgjedhje të lira”. Qytetaret e qytetarët e interesuar kishin mundësinë ta shprehin përkrahjen e vet dhe të kërkojnë zgjedhje të lira. Shumica prej tyre, përmes komu-

nikimit me ekipet e organizatës, drejtuan kërkesë të drejtpërdrejtë deri te elitat politike për ta dëgjuar zërin e tyre dhe që të kontribuojnë për respektim maksimal për të drejtën e tyre të votës. Disa qindra qytetare e qytetarë u fotografuan me porosinë për zgjedhje të lira. Një pjesë e madhe e tyre mund të gjendet edhe në faqen në Fejsbuk të CIVIL-it (www.facebook.com/civil.mk).

Përveç kësaj, në stendat informative mund të nënshkruhej edhe Deklaratë për përkrahje të CIVIL-it, por disa këtë e bënë në mënyrë elektronike, qëkur informoheshin se si të kenë qasje deri te ai formular. Me plotësimin e atij formulari, ata fitojnë mundësi të gjenden në listat e pranuesve të porosive elektronike të CIVIL-it dhe të bëhen pjesë e rrjetit më të gjerë të bashkëpunëtorëve e vëzhguesve qytetarë të CIVIL-it.

Gjithashtu, qytetaret e qytetarët informoheshin se mund të paraqesin parregullsi, shkelje të së drejtës së votës dhe lloje të tjera të shkeljes së të drejtave e lirive të nje-



riut në kontekstin zgjedhor në ueb-faqen www.slobodniizbori.info. Stendat informative ishin mundësi e shkëlqyeshme, veçanërisht për personat që nuk kanë shkathtësi të internetit, për të parashtruar formular vetë ata personalisht, në komunikim me përfaqësuesit e ekipeve për vëzhgim dhe aktivistëve të CIVIL-it. Ata kishin mundësi të marrin kopje me formularë të shtypur për paraqitje dhe t'i dërgojnë me postë.

Më 29 dhjetor 2015 CIVIL-i në mënyrë simbolike i shpalli stendat informative dhe selinë e organizatës "Zonë të lirë", me ç'gjë edhe një herë u potencua se ato janë vende ku qytetaret e qytetarët mund të shprehen lirisht, por edhe të drejtojnë kërkesë për zgjedhje të lira dhe të aktivizohen në përpjekjet për sigurim të kushteve për mbajtje të zgjedhjeve të lira në vend. për CIVIL-in është me domethënie të gjithë të interesuarit të ndihen të ftuar për të ardhur te CIVIL-i në çdo kohë, për të këmbyer informata, për t'u edukuar dhe për t'u aktivizuar.

RAPORT [3]

GRUPET E FOKUSIT I VËRTETUAN GJETJET E CIVIL-IT: PRAKTIKA KORRUPTIVE TË SHTRIRA GJITHANDEJ

Biljana JORDANOVSKA

Hulumtimi është një nga komponentët e rëndësishëm të projektit “Zgjedhje të lira për qytetare(ë) të lirë”. Një nga format e hulumtimit kualitativ që është aplikuar nga CIVIL-i janë grupet e fokusit.

Grupet e fokusit që u zbatuan në këtë projekt dhanë njohuri mbi perceptimet, qëndrimet dhe ndjenjat e përfaqësuesve të bashkësive të ndryshme, gjegjësisht kategorive të qytetarëve e qytetareve për dukuri të lidhura me procese socio - politike dhe ngjarje në kontekst zgjedhor, për nivelin e njohjes së të drejtës të votës, gjendjes së të drejtave e lirive të njeriut në përgjithësi, ashtu si edhe mbajtjes së proceseve zgjedhore paraprake.

Rezultatet e këtyre grupeve të fokusit nuk dallohen nga gjetjet e CIVIL-it përgjatë zbatimit të monitoringut dhe formave të ndryshme të hulumtimit, onlajn apo në terren. Thuajse një vit pas zbatimit të grupeve të fokusit, gjetjet e këtij hulumtimi befasojnë në precizitetin dhe aktualitetin e tyre.

Grupet e fokusit u bënë në Kumanovë, Manastir, Ohër, Gjevgjeli e Shtip në korrik të vitit 2015, në fazën e parë të projektit “Zgjedhje të lira për qytetare e qytetarë të lirë”. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në grupet e fokusit ishte 40. Sipas përbërjes së tyre, morën pjesë 21 meshkuj dhe 19 femra, të moshës 18-65-vjeçare. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit u përgjigjën 10 pyetjeve.

Rezultatet treguan se pjesëmarrësit e grupeve të fokusit për çështje të caktuara pajtoheshin në masë të madhe, pavarësisht vendit të banimit, moshës, përkatësisë etnike, politike, gjinore apo tjetër. Megjithatë, për çështjet që kishin të bëjnë në mënyrë direkte me proceset dhe ngjarjet politike, pjesëmarrësit ose ishin të hapur, të ashpër apo kritikë, ose ishin të shkurtër, të frikësuar apo konfuzë në përgjigje. Hulumtimi tregoi se qëndrimi i përgjithshëm i pjesëmarrësve e reflekton frikën nga ndryshimet e pritura, por edhe disponimin negativ e dyshimin se diçka do të ndryshohet për të mirë.

1. PROCESË ZGJEDHORE PARAPRAKË

Në pyetjen se vallë është votimi në zgjedhje shprehje e vullnetit të lirë të qytetarëve, nga gjithsej 40 pjesëmarrës në grupet e fokusit – 25 u përgjigjën se, për fat të keq, në Maqedoni e drejta për votim të lirë e të fshehtë u është marrë qytetarëve, 13 prej pjesëmarrësve, duke u nisur, para së gjithash, nga përvoja e tyre, u pajtuan se votimi në zgjedhje është shprehje e vullnetit të tyre të lirë, kurse dy prej pjesëmarrësve nuk mundën të japin përgjigje. Sipas përvojës së disa prej të anketuarve, pyetja e këtillë i sjell në situatë ta shqyrtojnë momentin e votimit në ditën e zgjedhjeve, se a i ka vëzhguar ndokush, a i ka ndjekur, a ka qenë në listë të ndokujt, gjersa kanë menduar ta realizojnë të drejtën e tyre të votës në mënyrë të lirë dhe të fshehtë. Megjithatë, kur bëhet fjalë për realizimin në proceset zgjedhore, pjesëmarrësit kishin fotografi më të qartë për atë se si realizohen zgjedhjet në Maqedoni dhe me çfarë sfidash përballen qytetaret e qytetarët. Kur i

pyetëm se a zbatohen zgjedhje të drejta e të lira në Maqedoni, madje 37 nga pjesëmarrësit, duke i analizuar proceset zgjedhore e dhjetë viteve të fundit, me vendosmëri u përgjigjën se nuk mund të flasin për zgjedhje të drejta e të lira, kur secili prej proceseve zgjedhore kalon me numër të madh parregullsish. Ja një pjesë e përgjigjeve të tyre:

“Zgjedhjet në Maqedoni nuk janë të drejta e demokratike, para së gjithash, për shkak të standardit të ulët që e kemi ne dhe varësia e lartë ekonomike e njerëzve nga partitë.”

“Propagandë, korrupsion, kërcënime, shantazhe, kjo e është e gjitha që mund të them për disa nga zgjedhjet e fundit.”

“Si mund të ketë zgjedhje të lira kur të kërcënojnë se po të mos votosh, do të largojnë nga puna apo të ofrojnë punë nëse voton për ta?!”

“As nuk janë të lira, as të drejta, duke e pasur parasysh se si janë fushatat parazgjedhore, dita e zgjedhjeve është vetëm formalitet, ku edhe atëherë bëjnë shtypje ndaj atyre që nuk kanë arritur t’u bëjnë shtypje përgjatë fushatës zgjedhore.”

Për tre pjesëmarrësit e tjerë, nga gjithsej 40, proceset zgjedhore në Maqedoni janë demokratike dhe të drejta. Përgjigjet e tyre ishin të shkurtra dhe nuk deshën ta arsyetojnë qëndrimin e tyre për këtë çështje.

Në periudhën e zbatimit të grupeve të fokusit, kriza politike në Maqedoni thellohej, kurse bashkësia ndërkombëtare hyri si ndërmjetësues në zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Pribesë.

2. REFORMA NË SISTEMIN ZGJEDHOR

Tema aktuale ishin reformat në sistemin zgjedhor, kurse sipas rekomandimeve të CIVIL-it, një nga ndryshimet ishte Maqedonia të jetë me një njësi zgjedhore dhe të bëhet me lista të hapura. Për këtë, reformat zgjedhore ishin pjesë e pyetjeve dhe temave të grupeve të fokusit të CIVIL-it.

Në pyetjen se a duhet Maqedonia të jetë me një njësi zgjedhore, nga gjithsej 40 pjesëmarrës, 22 u përgjigjën pozitivisht, duke konsideruar se në atë mënyrë partitë më të

vogla politike do të kenë mundësi të dalin nga hija nga katër partitë politike, nënshkruese të Marrëveshjes së Përzhinës. Qëndrimin e tyre e bazonin edhe në bindjen se në atë mënyrë do të përmirësohej gjendja politike në vend, që do ta kultivojë liderësinë në vend të qeverisjes.

Pjesëmarrësit e tjerë, 18, nuk ishin të sigurt se e kuptojnë konceptin e një njësie zgjedhore dhe se si kjo gjë do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes politike në Maqedoni. Prej tyre, 15 konsiderojnë se qytetarët nuk janë të njoftuar mjaftueshëm me Kodin Zgjedhor dhe me modelet zgjedhore që të mundën të vlerësojnë se çka është e mirë e çka është e keqe në situata të këtilla.

3. PROPAGANDË AGRESIVE, KORRUPSION POLITIK DHE SHTYPJE

Marrëveshja për tejkalim të krizës politike që e nënshkruan liderët e katër partive politike më të mëdha në Përzhinë, nuk e parandaloi strukturën në pushtet të vazhdojë me fushatë zgjedhore të vazhdueshme.

Që nga viti 2006 e këtej, Maqedonia ka kaluar në 8 procese zgjedhore. Ajo që i shënjoj ciklet e shpeshta zgjedhore ishte shtypja, kërcënimet mbi trupin votues, diskriminimi në bazë të përcaktimit artiak, keqpërdorimi i resurseve publike dhe kontrollimi i plotë e partizimi i administratës publike.

Në pyetjen se a u ka premtuar ndonjë përfaqësues apo aktivist i ndonjë partie politike ndonjë vend pune apo beneficion tjetër, personalisht atyre apo ndokujt që ata e njohin, po qe se do të kishin votuar apo nëse do të bënin listë me votues të sigurt për atë parti, nga gjithsej 40 pjesëmarrës në grupet e fokusit, 35 personalisht asnjëherë nuk janë përballur me shtypje të tillë. Nga gjithsej 35 pjesëmarrës që nuk kishin pasur kurrë përvojë personale, 24 pjesëmarrës kishin parë apo dëgjuar nga miq të afërt apo familjarë se kanë për detyrë të bëjnë lista votuesish të sigurt apo për të votuar për ndonjë parti të caktuar.

Çmimi që duhet ta paguajnë po qe se nuk pajtohen apo nuk e përmbushin “detyrën”, siç thonë pjesëmarrësit, gjithmonë është ose largimin nga puna të atyre personalisht, ose

e ndonjë familjari të tyre të familjes. "Shpërblimi" është punësim, avancim apo rritje të rrogës. Vetëm 5 pjesëmarrës të grupeve të fokusit kanë pasur përvojë personale.

Një pjesëmarrës kishte refuzuar të jetë pjesë e, siç thotë, "makinerisë së pushtetit", edhe përkundër të gjitha premtimeve për punësim, kurse një tjetër pjesëmarrës disa herë kishte bërë lista me votues të sigurt, por asnjëherë nuk i qenë përmbushur premtimet. Edhe përkundër vetëdijes për manipulimin, megjithatë kishte shpresuar se të paktën diçka do të përmbushin prej premtimeve të dhëna. Pas një kohe të caktuar kishte ndërprerë së besuari e të punojë si i dëgjueshëm partiak.

4. KEQPËRDORIM I KATEGORIVE TË NDJESHME SOCIALE

Në grupet e fokusit morën pjesë 19 persona të papunësuar. Duke e pasur parasysh se shkalla e varfërisë në Maqedoni është 28,6% prej të cilëve 46% e popullatës janë të papunë e të varfër, kurse 82,5% e numrit të përgjithshëm të të papunësuarve janë të papunë që një kohë të gjatë, sipas hulumtimeve që i bëri CIVIL-i në kuadër të projektit "Drejtesi sociale tash!", mund të bihet në përfundim se shtypja më e madhe dhe manipulimi politik bëhet mbi kategoritë më të ndjeshme sociale.

Për këtë, një nga pyetjet për të anketuarit në grupe e fokusit ishte se a kërcënohen apo keqpërdoren kategoritë e ndjeshme sociale në mënyra të tjera me qëllim që të detyrohen të votojnë për partitë në pushtet. Madje, 39 prej pjesëmarrësve ishin të pajtimit se të varfrit dhe kategoritë e tjera sociale janë më së lehti të manipuluar dhe të korruptueshme dhe se janë nën shtypje të vazhdueshme e kërcënime gjatë fushatës parazgjedhore. Jua paraqesim një pjesë nga përgjigjet në këtë temë:

"Jam absolutisht i sigurt se mbi të varfrit po bëhet shtypja më e madhe për të menduar e vepruar në kundërshtim me bindjet e tyre."

"Partitë në pushtet e shkatërrojnë klasën e mesme."

"Kategoritë e ndjeshme sociale janë më të varurit e pushtetit, para së gjithash, popullata rome, po edhe studentët – për bursa, për vendosje në konviktet studentore, pastaj

pensionistët e shumë të tjera.”

“Njerëzit janë varfëruar aq shumë, saqë janë vënë në situatë të blihen për një thes miell e vaj, sado që të jenë të vetëdijshëm dhe sado që ua ofendojnë inteligjencën, por nuk kanë ku!”

“Pushteti kishte kohë të mjaftueshme për të zhvilluar mekanizma për manipulim të popullit.”

Pjesëmarrësi i vetëm i grupeve të fokusit që konsideronte se partia në pushtet nuk i kërcënon dhe as që i keqpërdor si trup votues të varfrit e kategoritë e tjera të ndieshme, me një fjali e argumentoi qëndrimin e vet:

“Jo, sepse të gjithë kanë të drejtat e barabarta.”

5. . KEQPËRDORIMI I ADMINISTRATËS PËR QËLLIME PARTIAKE

Në pyetjen se a i keqpërdor administrata për qëllime politike, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, vetëm 1 pjesëmarrës konsideron se administrata punon profesionalisht dhe se nuk ka kurrfarë arsye të keqpërdoret për qëllime politike e partiake të askujt.

39 pjesëmarrësit e tjerë janë të bindur se manipulimi e keqpërdorimi më i lehtë partiak, veçanërisht në periudhën parazgjedhore, bëhet mbi administratën. Ndër pjesëmarrësit në grupet e fokusit katër janë punësuar në administratë dhe treguan me përvoja personale për keqpërdorimet e të punësuarve në administratë. Si ilustrim i këtyre gjendjeve mund të shërbejë përgjigjja e një nga pjesëmarrësit për përvojën e tyre dhe dëshmimin për punësim në një shkollë:

“Pagova një mijë euro për punësim në qendrën shtetërore muzikore, për drejtoreshën e shkollës, përmes një ndërmjetësuesi, burrit të saj. Aq ishte çmimi për punësim në atë shkollë. Kjo është puna e parë. Pastaj, kur të punësohesh, fillon të paguash anëtarësi për partinë, që mblidhet në kesh, e e njëjta vlen për të gjithë të punësuarit në shkollë, nga 600 e deri në 1400 denarë, varësisht nga përvoja e punës dhe pozita. Çmimi për ata që janë me më shumë përvojë është më i vogël, kurse nëse ke përvojë më pak, paguan

1500 denarë për partinë. Përveç kësaj, të japin listë me detyra, udhëzim për të shkruar në të gjitha mitingjet dhe një varg obligimesh të tjera.”

Më 24 dhjetor 2012 opozita me dhunë u largua me pjesëtarë të forcave speciale policore nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në momentin kur duhej të votohej buxheti për vitin 2013. Me sigurim të madh policor, në mënyrë të dhunshme, u qitën jashtë deputetët dhe gazetarët, e me të u suspendua demokracia. Nga ai moment i keq për demokracinë maqedonase, sipas të gjitha raporteve dhe analizave të CIVIL-it, nuk ka kurrfarë përgjegjësie për thyerjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, e deri në çastin e mbajtjes së grupeve të fokusit, Kuvendi ende është në gjendje të keqe, ku janë prurë qindra ligje dhe ndryshime ligjesh me procedurë të shkurtër dhe në varësi prej dëshirave dhe nevojave të partisë në pushtet, pa debat publik dhe pa opozitë.

Për këtë arsye, një nga pyetjet për pjesëmarrësit e grupeve të fokusit ishte se a i kontrollon Qeveria deputetët në Kuvend të Republikës së Maqedonisë. 36 pjesëmarrës ishin të sigurt se Kuvendi në mënyrë të rreptë kontrollohet nga Qeveria. Po ju japim disa qëndrime të pjesëmarrësve në grupet e fokusit:

“Te ne, Kushtetuta garanton një, pushteti ligjvënës zbaton një gjë tjetër. Plotësisht në kundërshtim me Kushtetutën, deputetët në Kuvend janë të kontrolluar.”

“Edhe Kuvendi, edhe Qeveria kontrollohen.”

“Ne kemi vetëm një makineri për ngritje të dorës.”

“Sjellja e ligjeve në shtetin tonë është sikur ndërrimi i çorapeve – përditë, nga mëngjesi e deri në mbrëmje.”

“Kuvendi nuk i pasqyron nevojat e qytetarëve, po bizneseve të caktuara që i udhëheqin fytyrat kryesore. Gjithçka është në vënë në rrafshin e elitizmit. Ka dy fytyra në këtë shtet, gjegjësisht kryeministri dhe lideri i opozitës.”

Pjesëmarrësit e tjerë që u përgjigjën se deputetët në Kuvend nuk mund të mos kontrollohen nga Qeveria, arsyetuan shkurtas, se madje edhe po të ekzistonte dëshirë për kontrollim, deputetët i përfaqësojnë qytetarët, jo Qeveria.

6. FUSHATA

Në pyetjen se a po vazhdon pushteti me fushatë në medime, edhe përkundër moratoriumit në fushata komerciale të Qeverisë, 38 nga pjesëmarrësit u përgjigjën pozitivisht.

Vetëm dy veta konsideronin se fushatë intensive mediatike nuk ka vetëm pushteti, po edhe të gjithë subjektet e tjera politike përgjatë periudhës parazgjedhore.

7. DORËHEQJA E NIKOLLA GRUEVSKIT

Një nga kushtet e Marrëveshjes së Përzhinës ishte edhe dorëheqja e kryeministrit. Me publikimin e “bombave” të opozitës edhe më shumë u shtua kërkesa për largim përfundimtar të Nikolla Gruevskit nga pozita e kryeministrit. Më 15 janar të vitit 2016 Nikolla Gruevski dha dorëheqje te kryetari i Kuvendit, Trajko Veljanoski. Me largimin e tij nga pozita e kryeministrit, pyetja ishte a do të largohet nga skena politike apo do të ketë përfundim juridik për akuzat për keqpërdorime, korrupsion dhe vjedhje zgjedhore.

Që aty, duke pasur parasysh mosdijen që mbretëronte në periudhën për zbatimin e grupeve të fokusit, dy pyetjet e fundit lidheshin pikërisht me dorëheqjen e Gruevskit, si një hap më tej për tejkalimin e krizës politike.

Nga gjithsej 40 pjesëmarrës në grupet e fokusit, 32 u përgjigjën se kërkesa e opozitës për dorëheqje të kryeministrit Gruevski është e arsyeshme. Një grup më i vogël i të anketuarve nuk u pajtuan se kjo është mënyra se si duhet të dilet nga kriza politike. Sipas tyre, kryeministri është zgjedhur në mënyrë legjitime dhe po qe se dikujt nuk i pëlqen puna e tij, atë duhet ta shprehë përmes votimit në zgjedhje.

Në pyetjen e fundit se a besojnë që me dorëheqjen e kryeministrit Nikolla Gruevski do të ndryshohet mënyra e qeverisjes në Republikën e Maqedonisë, pjesëmarrësit u futën në analizim më të detajizuar sepse ndërrimi i kryeministrit nuk do të ndikojë shumë në drejtim të ndryshimeve dhe demokratizimit të vendit dhe tejkalimit të krizës politike. Të gjithë u pajtuan me faktin se po qe se vjen deri te ndryshimet, ato do të jenë jo relevante në aspekt të të gjitha reformave në sistemin politik që do të duhej urgjentisht të

zbatohen për kthim të demokracisë në Maqedoni.

Ju paraqesim një pjesë të përgjigjeve të pjesëmarrësve në grupet e fokusit:

“Me dorëheqjen e kryeministrit do të ndryshohen shumë punë. Po qe se mbetet partia e njëjtë në qeveri, nuk do të ndryshohet asgjë, sepse ai sërish do të dirigjojë nën hije dhe gjithçka do të jetë nën ndikimin e tij. Pra, vetëm me zgjedhje të drejta dhe me ndryshim të pushtetit mund të ndryshohet udhëheqja e Republikës së Maqedonisë.”

“Edhe po qe se vihet deri te ndërrimi i pushtetit dhe të ndërrohet Nikolla Gruevski, konsideroj se ai do të qeverisë nga hija. Shpëtimi i vetëm është ai të zhduket apo të përfundojë në ndonjë burg.”

“Duhet të ndërrohet e tërë garnitura, e jo vetëm Nikolla Gruevski. Vetëm me dorëheqjen e tij ndoshta do të ketë përmirësime, por nuk besoj, sepse të gjithë janë të lidhur.”

“Dorëheqja e Nikollës është hapi i parë i ndryshimit, kurse më tej duhet të shkohet edhe më thellë. Ata kanë shkatërruar nëntë vite, kurse do të na duhen 15 vjet për të përmirësuar. Njerëzit i harruan të drejtat e tyre dhe sërish do të duhet të edukohen për këtë çështje. E harruan dinjitetin e tyre, sepse edhe ai iu shkatërrua. Po, do të ketë ndryshime, por shumë ngadalë do të bëhen.”

“Mendoj se asgjë nuk do të ndryshojë. Për shkak se secili po e shikon dobinë e vet, e askush dobinë e shtetit.”

CIVIL-i vazhdoi me aktivitetet hulumtuese deri në fund të projektit, vazhdimisht duke e ndjekur pulsën e ngjarjeve. Të gjitha këto gjetje CIVIL-i i boton në kanalet e veta onlajn, por edhe në ngjarje publike ku i paraqet raportet dhe analizat.

ANKETA ONLAJN

MATJA E PULSIT TE OPINIONIT

Biljana JORDANOVSKA

Komponenta hulumtuese e projektit “Zgjedhje të lira për qytetare dhe qytetarë të lirë” ka shtuar edhe gjashtë onlajn- anketa, të cilat vazhdimisht e kanë përcjellë zhvillimin e procesit politik, duke parashtruar pyetje aktuale në periudhën e zbatimit të tyre.

Përmes anketave erdhëm deri te informata për qëndrimet, njohuritë dhe njohjet e proceseve zgjedhore, modelit zgjedhor, parregullsisve zgjedhore, shtypjeve, manipulimeve, kërcënimeve dhe kushtëzimeve, si dhe për rolin e KSHZ, PSP, Marrëveshjes së Përzhinës dhe rrjeteve sociale.

Anketat nuk pretendonin të jenë tregues relevantë të qëndrimit të



opinionit më të gjerë, mirëpo mundësuan depërtim në disponimin e opinionit në tërësi. Përgjigjet e onlajn- pyetjeve të parashtruara në anketat janë shumë të rëndësishme, posaçërisht për shkak të mungesës së debatit shoqëror mbi temat që përpunohen.

Si pjesë e një game më të gjerë të aktiviteteve hulumtuese dhe të monitorimit, këto anketa, patjetër se janë kontribut domethënës për projektin dhe më gjerë.

Në gjashtë onlajn-anketat e zbatuara morën pjesë gjithsej 4.472 të anketuar në periudhën nga tetori 2015 deri prill 2016.

Në hulumtimin e parë- onlajn erdhëm deri te të dhëna kuantitative, deri te qëndrimet dhe njohuritë e të anketuarve për proceset zgjedhore, modelin zgjedhor, parregullsitë dhe shtypjet, me të cilat ballafaqohen ata. 92.4 nga të anketuarit mendojnë se në Republikën e Maqedonisë nuk zbatohen zgjedhje të lira dhe fer, ndërsa 95.1% nga ata mendojnë se të varfrit dhe kategoritë tjera vulnerabile janë të kushtëzuar dhe keqpërdoren në mënyrë tjetër me qëllim të detyrohen të votojnë për partitë në pushtet.

Sipas rezultateve nga kjo anketë, 92.4% nga të anketuarit mendojnë se deputetët në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë janë të kontrolluara nga Qeveria. Gjithashu, numri i madh prej 96.7% mendojnë se edhe mediat janë nën kontrollin e pushtetit. Mirëpo, 70% nga të anketuarve nuk kanë frikë ta kritikojnë pushtetin.

Në onlajn - anketën e dytë u parashtruan pyetje të cilat kanë të bëjnë me proceset politike aktuale në vend, me rolin dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve kryesorë në negociatat politike për tejkalimin e krizës, si dhe me pyetje të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjet e jashtëzakonshme të paralajmëruara për prill 2016.

Onlajn – anketa zgjati deri me 9 nëntor, para se të emërohen ministrat e ri dhe zëvendësministrat nga radhët e opozitës në qeverinë e Maqedonisë, sipas kushteve nga Marrëveshja e Përzhinës.

Në këtë kontekst, në pyetjen që përfshinte negociatat, 60% nga të anketuarit e njohin bashkësinë ndërkombëtare si faktor kyç në tejkalimin e krizës në vend, ndërsa frenimin dhe mos zbatimin e Marrëveshjes për tejkalimin e krizës ia atribuojnë partisë qeverisëse VMRO-DPMNE me 84.25%.

E parashtruam pyetjen nëse njëkohësisht me zgjedhjet e parakohshme parlamentare

duhet të mbahen edhe zgjedhje të parakohshme presidenciale, që është edhe pjesë e orvatjeve publike të CIVIL qysh nga fillimi i procesit politik në vend. Përgjigje pohuese në këtë pyetje dhanë 70,38% nga të anketuarit, që përputhet edhe me kërkesave publike të CIVIL.

Përkundër shtypjeve të ndalohen “bombat” politike të opozitës, 85.69% nga të anketuarit mendojnë se ajo duhet të vazhdojë me shpalljen e bisedave të përgjuara, të cilat dëshmojnë për abuzimet dhe krimin e pushtetit.

Më shumë se 80% nga qytetarët dhe qytetarët që morën pjesë në onlajn- anketën e tretë “Marrëveshja e Përzhinës dhe zgjedhjet” e CIVIL- Qendra për Liri, mendojnë se pushteti e pengon plotësimin e Marrëveshjes së Përzhinës, ndërsa pothuajse të gjithë të anketuarit (89%) u përgjigjën se institucionet dhe administrata keqpërdoren për qëllime partiake.

Në periudhën kur përgatiteshin pyetjet, dhe gjatë anketës, 24 prilli ishte termini i paraparë për zgjedhjet.

Në pyetjen – Vallë janë krijuar kushtet për mbajtjen e zgjedhjeve fer dhe të lira më 24 prill? – 86% nga të anketuarit u përgjigjën se kushtet nuk janë të plotësuar. Përqindja e njëjtë e të anketuarve u përgjigj pozitivisht në pyetjen – A mendoni se zgjedhjet duhet të anulohen dhe të mbahen pasi të jetë pastruar Lista e Votuesve dhe të zbatohen reformat e mediave?

Në onlajn – anketën “KSHZ dhe Lista e votuesve”, të cilën e zbatoi CIVIL – Qendra për Liri në periudhën nga 23 marsi deri 31 mars, me datë aktuale të zgjedhjeve 5 qershor, në pyetjen e parë “A mendoni se Lista e votuesve është e rregullt?”- 91.53% nga qytetarët dhe qytetarët e anketuar mendojnë se Lista e Votuesve nuk është e rregullt. Megjithatë, 86.30% nga ata besojnë se shpallja publike e Listës së votuesve ishte hap pozitiv i KSHZ.

Në pyetjen “Vallë keni vërejtur edhe vetë parregullsi në Listën e votuesve”, 75.65% nga të anketuarit janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 91.75% nga të anketuarit janë përgjigjur negativisht në pyetjen që kishte të bëjë me vendimin e KSHZ për tërheqjen e aplikacionit për paraqitjen e parregullsive në Listën e Votuesve.

Mund të përfundohet se nga aty vjen dyshimi i 76.90% nga të anketuarve për mundës-

inë që Lista e Votuesve të jetë e pastruar për mbajtjen e zgjedhjeve të besueshme me 5 qershor.

75.91% nga të anketuarit e arsyetojnë bojkotimin e zgjedhjeve në onlajn- anketën "Vallë do të ketë zgjedhje me 5 qershor, dhe si do të jenë ato?", përmes cilës CIVIL – Qendra për Liri e detektoi mendimin e qytetarëve dhe qytetarëve për përcaktimin e shumicës nga partitë opozitare për bojkotim të zgjedhjeve me 5 qershor.

86.64% nga të anketuarit besonin se zgjedhjet me 5 qershor nuk do të mundësojnë daljen nga kriza politike në të cilën gjendet Maqedonia.

Edhe pse si parakusht për zgjedhje të lira, sipas Marrëveshjes së Përzhinës është Lista e pastruar e votuesve, 85.43% nga të anketuarit ishin të bindur se Lista e Votuesve do të mbetet e pa pastruar për zgjedhjet me 5 qershor.

90.28% nga të anketuarit janë të sigurt se edhe këto zgjedhje do të kalojnë me keqpërdorim të resurseve shtetërore për fushatë, ndërsa 90.18% mendojnë se i gjithë procesi zgjedhor do të jetë i lidhur edhe me shtypje mbi të punësuarit në administratën publike.

Në pyetjen e parë nga onlajn-anketa "Protestat në Maqedoni – zgjidhje ose thellim i krizës" e CIVIL- Qendrës për Liri, 83.40% janë përgjigjur se plotësisht i mbështesin protestat, ndërsa 9.31% nga të anketuarit janë përgjigjur se fare nuk e mbështesin "Revolucionin e larmë". Kërkesat e demonstruesve të "Revolucionit të larmë" i njohin 85.70% nga të anketuarit, ndërsa i mbështesin 83.27% nga të anketuarit. Efektin e larmisë demonstruesit e arritën me hedhje të ngjyrës dhe vezëve mbi skulpturat e projektit "Shkupi 2014". 75.57% e mbështesin këtë veprim të demonstruesve, ndërsa 16.87% nuk pajtohen me këtë mënyrë të shprehjes së revoltës. Tubimet ose kontra-protestimet e GDOM plotësisht nuk i mbështesin 82.59% nga të gjithë të anketuarit, megjithatë, 53.17% prej të anketuarve janë të njoftuar me kërkesat e tyre, si dhe 87.31% nuk i mbështesin kërkesat e tyre për ndalimin e përkohshëm të partive dhe organizatave joqeveritare të cilat e mbështesin "Revolucionin e larmë".



RAPORT [4]

INTERVISTA PËR PËRKRAHJE TË DEBATIT

Marija TEGOVSKA

CIVIL ka shpallur mbi 60 video- intervista dhe mbi 150 video-deklarata nga ekspertë, politikanë, funksionarë, aktivistë, liderë organizatash të shoqërisë qytetare, diplomatësh dhe të personave tjerë relevantë. Në këtë mënyrë, CIVIL vazhdoi praktikën e të qenit podium i hapur për qëndrime dhe analiza të personave të rëndësishëm për proceset shoqërore –politike në kontekstin zgjedhor.

Në segmentin e hulumtimeve gjatë projektit “Zgjedhje të lira për qytetarë dhe qytetarë të lirë”, ekipi i CIVIL Media ka bërë një varg intervistash me intelektualë të shquar, persona publike, ekspertë dhe analistë, të cilëve u parashtroheshin

pyetje identike lidhur me çështje prekëse për procesin zgjedhor dhe për krizën politike në Republikën e Maqedonisë.

Në dhjetor të vitit 2015, Civil Media bisedoi me analistin ekonomik Xhevdet Hajredini, me Dr. Malinka Ristevska Jordanova - drejtoreshë e Institutit për Politikë Europiane (EPI), aktivistin Bojan Mariçiq, drejtor ekzekutiv i Qendrës së Maqedonisë për Arsimit Evropian (MCEO), me Elida Zylbearin - kryeredaktore në "Portalb" në gjuhën shqipe, gazetaren dhe analisten ekonomike Ida Protugjer, si dhe me Nikolla Rilkovskin, kryetar në largim i Komisionit Shtetëror Zgjedhor në kohën e realizimit të intervistës.

Të gjithë bashkëbiseduesve u ishin parashtruar pyetje të njëjta, të cilat kishin të bëjnë me zhvillimin e negociatave për tejkalimin e krizës politike, pengesave dhe shkeljeve të Marrëveshjes së Przhinës, si dhe për mundësitë e krijimit të kushteve të vërteta për zgjedhje të lira në prill të vitit 2016.

Xhevdet Hajredini dha parashikim se nëse nuk vjen deri te realizimi i obligimeve të ndërmarra, Maqedonia do të hyjë në një fazë shumë më dramatike të krizës politike. Ai mes tjerash vlerësoi: "Është e mundshme që Gruevski të mos largohet nga pushteti në mënyrë paqësore. Sepse dihet se alternativa e tij është – ose në pushtet, ose i gjykuar me burg shumëvjeçar".

Dr. Malinka Ristevska Jordanova vlerësoi se Qeveria ka përparësi strukturore, të fituar me sundim dhjetëvjeçar dhe se për konkurrentët politik nuk do të jetë lehtë të sigurojnë as nga afër kushte për zgjedhje të lira.

Bojan Mariçiq theksoi se tre pikat, rreth të cilave do të thyhen shtizat, edhe më tej janë Prokuroria Speciale Publike, paqeta e ligjeve për media dhe kontrolli parlamentar i shërbimeve sekrete. Ai theksoi se pjesëmarrja e organizatave qytetare është kyçe për zbatimin e zgjedhjeve.

Elida Zylbeari tha se nuk beson se do të krijohen kushte të vërteta për mbajtje e zgjedhjeve të lira. "Zgjedhjet do të zbatohen në "mënyrë efikase" sipas kërkesës së BE, që do të thotë pa dhunë, por kjo nuk do të thotë se ato në të vërtetë do të jenë të lira dhe demokratike".

Ida Protugjer ishte e vendosur në qëndrimin se zgjedhjet në asnjë mënyrë nuk guxojnë të mbahen me 24 prill të vitit 2016, sepse nuk është përmbushur asnjë parakusht që atë të jenë fer dhe demokratike. Ajo mendon se nëse zgjedhjet do të mbaheshin me 24 prill, Gruevski do t'i fitonte, me ndihmën e "ushtrisë së mbështetësve të korruptuar, me ndihmë të propagandës dhe manipulimit që e bën dhe përmes korruptimit me paratë tona".

Nikolla Rilkovski shprehi brengosje se prolongimi i Marrëveshjes së Przhinës do të ketë implikime negative. "Procesi i implementimit të Marrëveshjes së Przhinës në këtë fazë kalon nëpër një fazë të ndërlikuar, po zvarritet çdo gjë, për të cilën janë marrë vesh."

CIVIL ka qenë çdo herë i hapur për shpallje të intervistave me përfaqësues të palëve të ndryshme të prekura, me vendimmarrësit, partitë politike, ekspertët dhe veprimtarët në shoqërinë civile. Qasja e CIVIL-it për paraqitjen me video format është orvatje që porositet të përcillen në mënyrë origjinale. Shpesh janë bërë edhe transkripte nga bisedat ose përmbajtje të shkurta nga ato, të cilat janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe angleze. Kjo i bëri ueb faqet e CIVIL, para së gjithash, resurs atraktiv dhe dinamik onlajn.

INTERVISTA ME MINISTRA NGA QEVERIA

CIVIL ka paraqitur risi në komunikim edhe me Qeverinë. Me qëllim të kontribujë ndaj transparencës sa më të madhe në proceset, e njëkohësisht të jetë në komunikim të drejtpërdrejtë me Qeverinë për tema të rëndësishme për procesin zgjedhor dhe orvatjet për tejkalimin e krizës politike në tërësi, ekipi profesional i gazetarëve të CIVIL Media ka realizuar një sërë intervistash të rëndësishme me disa nga ministrat e Qeverisë. Qëllimi ishte që të tërhiqet paralele mes ministrave nga radhët e opozitës - LSDM, të cilët ishin të përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen për tejkalim të krizës politike, dhe ministrat nga përbërja e rregullt e Qeverisë, e përcaktuar nga partitë në pushtet. Plani ishte të realizohen nga dy intervista para zgjedhjeve, ndërsa një intervistë pas mbajtjes së zgjedhjeve.

CIVIL Media, në periudhën prej nëntorit të vitit 2015 deri në shkurt të vitit 2016, u drej-

tua deri te më shumë ministra në Qeveri. Plani ishte të realizohen nga tre intervista me secilin prej ministrave, në tre muajt para zgjedhjeve, dhe nga një intervistë pas kryerjes së procesit zgjedhor. Qëllimi i intervistave ishte të që ishte të përcillet puna e ministrave të rëndësishëm për procesin zgjedhor. Kërkuam intervistë edhe nga dy ministra të LSDM-së opozitare të kyçur në Qeveri sipas Marrëveshjes së Przhinës, si dhe nga ministra të përbërjes së rregullt të Qeverisë, të përcaktuar nga partitë në pushtet.

Të ftuar ishin Oliver Spasovski, ministër për Punë të Brendshme, Frosina Remenski si ministre e Punës dhe Politikës Sociale (LSDM), ministri për Punë të Jashtme Nikolla Poposki, ministri për Bujqësi, Pyje dhe Ekonomi të Ujërave, Mihail Cvetkov (nga koalicioni i VMRO-DPMNE), Ministri për Drejtësi, Adnan Jashari (BDI), dhe zëvendëskryeminstri i Qeverisë, me detyrë për Çështjet Evropiane, Fatmir Besimi.

Për fat të keq, me një përjashtim, përfaqësuesit e partive qeverisëse në pushtet, edhe pse ishin të ftuar disa herë, në mënyrë të rregullt, nuk u përgjigjën në ftesat për bisedë në kohë dhe në vend të cilin ata do ta zgjedhin. Një pjesë nga ata, fillimisht u pajtuan për bisedë para kamerave të CIVIL Media, mirëpo më vonë e ndërprejnë komunikimin.

CIVIL shpalli dy intervista me Oliver Spasovin si ministër për Punë të Brendshme: "Do ta dekriminalizojmë policinë", e shpallur me 15 dhjetor 2015, si dhe "Policia nuk guxon t'i frikësojë qytetarët!", e shpallur me 19 shkurt 2016. Spasovski foli për sfidat e sigurisë, departizimin e MPB, (mos)ekzistimin e strukturave paralele të armatosura në MPB dhe kontrollin mbi to, për 35.000 letërnjoftime të rremë të krijuara në MPB, të cilat hetohen nga PSP, si dhe për një varg tema tjera nga ky resor. Spasovski i ndau katër prioritetet, mbi të cilat do të fokusohet si ministër i Punëve të Brendshme: trajtimi, me të gjitha, i rreziqeve të sigurisë dhe sfidave në Maqedoni dhe në rajon, kriza e refugjatëve me të cilën po ballafaqohet Maqedonia, bashkëpunimi i mirë me Prokurorinë Speciale Publike, dhe përpjekjet maksimale për organizimin e zgjedhjeve të drejta dhe demokratike.

Ministrja Frosina Tashevska- Remenski, sipas planit, dha dy intervista, në të cilat ka ndarë me publikun informata për kaosin, keqpërdorimet dhe krimin e pushtetit në domenin e drejtësisë sociale. Ato janë intervistat "Dëshmitë për kaosin, keqpërdorimet dhe krimin", shpallur me 1 janar 2016, si dhe " Për 22 dy ditë në janar, Fondi i PIOM ka

deficit prej 662 milionë denarëve!”, e shpallur me 11 shkurt 2016. Tashevskaja -Remenski foli për kaosin në qendrat për mbrojtje sociale, për zvogëlimin virtual të papunësisë dhe për “dallimin” prej 160.000 personave në “statistikat” për numrin e të papunësuarve, për gjendjen katastrofale në të cilën 50% nga mjetet për pagesën e pensioneve janë subvencion nga Buxheti, fakt dëshpërues të cilin e pranon edhe ministri për financa, Zoran Stavreski i cili me një rast tha se “pa kredi, nuk do të ketë as pensione, as ndihmë sociale, as shpenzime që dalin nga pjesa e shërbimeve për punë të kryer”.

Tashevskaja – Remenski foli edhe për manipulimet me shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale dhe me grupet e cenushme sociale në përgjithësi, për largimin e 15 drejtorëve të Qendrave për Punë Sociale, për reagimet mbi vendimin e saj, për paditë nga zëvendësministri Dime Spasov (VMRO-DPMNE), si dhe për borxhet me miliona të Fondit për Pension – për vetëm 22 ditë në janar të vitit 2016, Fondi për Pension ka pasur deficit prej 662 milionë denarëve (11 milionë euro). Informatat që Tashevskaja – Remenski i ndau me publikun, vetëm i vërtetuan zbulimet e monitorimit afatgjatë të CIVIL në këtë sferë.

Ministri për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave, Mihail Cvetkov dha një intervistë për CIVIL Media: “Nuk japim subvencionet sipas zgjedhjeve!”, e shpallur me 18 shkurt 2016. CIVIL Media e pyeti ministrin Cvetkov për aferën që ka të bëjë me lidhjen e ministrisë së tij dhe pronarit të televizionit të poshapur TV NOVA, Sead Koçan. “Unë nuk mund t’ia ndaloj të ndërtojë, sepse ka televizion, “Transmet” e ka fituar edhe tenderin për ndërtim të sistemit për ujitje Raven – Reçicë, i cili në ankand elektronik nga 14 milionë është zvogëluar në 8,5 milionë, kemi zvogëlim nga 5,5 milionë euro, zvogëlim të çmimit të projektit! Ata e kanë filluar atë punë sepse mund ta ndërtojnë me aq para. Kur thoni se paratë ia kanë dhënë, nuk ia kanë dhënë, i ka fituar me punë”, u përgjigj Cvetkov.

CIVIL Media do të vazhdojë me këtë mënyrë të komunikimit me Qeverinë dhe do të botojë intervista, të cilat do të mundësohen në kornizat e projektit “Përpara”, i financuar me mjete gjermane nga Pakti për Stabilitet në Evropën juglindore.

#CIVIL ONLINE

KONTRIBUT DOMETHËNËS

Ermin KLIMENTA

Terrimediatik që sjell deri te mungesa e vazhdueshme e informatave për çështjet të rëndësishme dhe ngjarjet në vend, në veçanti ato që kanë të bëjnë me proceset politike dhe zgjedhjet, mund të depërtojë vetëm përmes mediumit tonë – onlajn dhe daljeve të medimeve. Ky kontribut në hapësirën gjithpërfshirëse të mediave dhe prodhimit të mediave në vend, është me të vërtetë me rëndësi. Ekipi i CIVIL Media punoi shumë orë për përmirësimin e onlajn-dukshmërisë të aktiviteteve tona dhe përhapjes së informatave dhe dijenisë për të drejtat e votuesve, si dhe për sigurimin e onlajn – forumit për debat shoqëror për çështjet që e mendojnë vendin. Ne tentuam t’i ndihmojmë publikut tone të bëjë dallimin mes propagandës dhe lajmeve, të njohë mosdijen nga dija, apatinë nga pjesëmarrja.

Për dallim nga shtetet moderne europiane, si dhe shtetet nga Perëndimi të cilat janë shumë progresive dhe ecin përpara duke vendosur teknologji të reja, për fat të keq, për ne, kjo teknologji ende përdoret thjeshtë për përhapjen e propagandës dhe për fitim sa më të madh nga web faqet më të lexuara, dhe përdorimin e taktikave jo fer për sulmim të konkurrencës, e veçanërisht të hapësirës së organizatave joqeveritare,

si që është rasti i web- faqes tonë. Web- faqja e CIVIL ishte nën shtypje të madhe. Rreth 31 milionë sulme për vetëm 6 muaj, në mesatare prej 5,2 milionë sulmesh në muaj. Prilli i vitit 2016 e shënoi sulmin më të madh me 10 milionë sulme gjatë këtij muaji.

Pavarësisht nga të gjitha sfidat. Web- faqja e CIVIL u rrit në një nga internet –portalet më të mëdha të organizatave joqeveritare në nivel rajonal, të cilat i mbulojnë përmbajtjet e specializuara në bazë ditore.

Dukshmëria e CIVIL në onlajn- hapësirën rritet në mënyrë eksponenciale. Onlajn- mediat e CIVIL, gjithashtu fitojnë ndjekës nëpër rrjetet sociale, të cilët me vëmendje e përcjellin punën e organizatës.


Motivimi më i rëndësishëm i ekipit tonë është që t'i shërbejë publikut. Nuk ekziston interes tjetër, komercial ose politik, por, të japim kontributin tonë ndaj proceseve demokratike, të dukshëm dhe të dobishëm për tjerët, që mundohen të sjellin ngjarje pozitive në vend.

CIVIL, gjithashtu, nxit debate të hapura në internet, përmes Twitter'it dhe Facebook'ut, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë mbi debatet që mbahen drejtpërdrejtë. Prandaj, çdo herë kur një ngjarje publike ndodh çdo kund në vend, onlajn- shoqëria ka mundësinë për kontribut për ngjarje, përmes pyetjeve dhe komenteve të cilat janë të paraqitura rregullisht nëpër ngjarjet. Publiku mundet të dërgojë koment ose pyetje deri te liderët politikë ose ekspertët deri sa flasin në ngjarjet, përmes Twitter dhe Facebook.

Rritja e publikut lexues nuk ec pa vërejtur. Në bazë të analizave që me vëmendje ndiqen në bazë ditore, ne mundemi të krenohemi sepse CIVIL kuptohet si burim relevant, dhe është vazhdimisht i cituar nga mediat më të rëndësishme në tërë vendin. Gjithashtu, konsiderohet edhe si resurs për hulumtues të vendit dhe të huaj, gazetarë, si dhe parti politike dhe organizata joqeveritare.

CIVIL, me më shumë se 3200 artikuj, të shpallura në tre gjuhë në web –faqen e saj, shkak-

CIVIL online reach



” Any weather is good for activism

CIVIL - Center for Freedom

toi reagim të madh të mediat, sërish me mbi 700 tekste të shpallura në web-faqe (në periudhën prej 1 korrik deri 130 qershor të vitit 2016).

Sipas Google Analytics, një nga mjetej – onlajn më me ndikim për matjen e ndikimit në internet, web-faqja e CIVIL ka realizuar 112.000 vizita në prilltë vitit 2016, dhe rregullisht realizohen mbi 80.000 vizita mujore. Në periudhën e implementimit të projektit, vetëm veb-faqen kryesore të CIVIL e kanë vizituar mbi 700.000 vizitorë.

Fejsbuk profili i CIVIL ka pasur mbi 5000.000 vizita (dhe aktivitet: 600.000+) në vetëm 12 muaj, gjegjësisht në

| Summary by Month | | | | | | | | | | |
|--------------------------|-----------|--------|-------|--------|----------------|------------------|---------------|----------------|-----------------|-----------------|
| Month | Daily Avg | | | | Monthly Totals | | | | | |
| | Hits | Files | Pages | Visits | Sites | KBytes | Visits | Pages | Files | Hits |
| Jul 2016 | 111875 | 102400 | 8311 | 512 | 1 | 4459982 | 1024 | 16622 | 204801 | 223751 |
| Jun 2016 | 157008 | 146563 | 12755 | 864 | 1 | 88979047 | 25929 | 382665 | 4396916 | 4710265 |
| May 2016 | 118942 | 109690 | 8580 | 536 | 1 | 67315366 | 16618 | 265992 | 3400413 | 3687214 |
| Apr 2016 | 326385 | 292813 | 14700 | 1417 | 1 | 164966907 | 42535 | 441019 | 8784398 | 9791557 |
| Mar 2016 | 174393 | 161310 | 12180 | 892 | 1 | 113164157 | 27663 | 377610 | 5000612 | 5406190 |
| Feb 2016 | 254037 | 226297 | 14359 | 1480 | 1 | 130710081 | 41451 | 402057 | 6336327 | 7113049 |
| Totals | | | | | | 569595540 | 155220 | 1885965 | 28123467 | 30932026 |

Преглд на нападите врз ЦИВИЛ

periudhën e zbatimit të projektit. Në profilin e Tuitërit të CIVIL, evidenca tregon mbi 200 mijë përshtypje, që është në nivel të kënaqshëm, por me siguri se duhen përmirësime në periudhën që vijon. Sidoqoftë, tema për zgjedhjet dhe kërkesat për zgjedhje të lira janë shumë atraktive, në veçanti, cicërrimet e CIVIL.

Rangimi sipas Aleksa i web –faqes së CIVIL. Është mes milionit të parë të web – faqeve në internet nga ana e lexuesve në botë.

Faqja e CIVIL është mes një mijë faqeve të para të lexuara (dhe rritet) në Maqedoni, (një mijë pozitat e para përfshijnë faqe të huaja përfshi rjetet si YouTube, Google etj.).

CIVIL do të mbetet e hapur përpjesëmarje të konstituentëve të saj dhe publikut gjith-përfshirës, të cilët na ndihmojnë që të përmirësohet aktiviteti ynë onlajn, që sjell deri te rritja më e madhe.

Në kornizat e projektit “ Zgjedhje të lira për qytetarë të lirë”, CIVIL ka ndarë një numër të madh përmbajtjesh audio-vizuele që qarkullojnë nëpër rrjetet sociale, me çka e bën organizatën shumë të dukshme dhe me ndikim.



Diskutim: Pluralizmi dhe kriza politike, 10 maj , 2016

Shtyrje e zgjedhjeve, revizion i Listës së Votuesve, media të lira, sundimi i së drejtës, demokracia, depolitizimi i institucioneve...

(21 parti politike, 50+ përfaqësues të OJQ-ve, medieve dhe komunitetit ndërkombëtar)



Çdo kohë është e përshtatshme për aktivizëm ! CIVIL në Shtip, 11 janar, 2016, duke promovuar Zgjedhje të Lira për Qytetarë(ë) të Lirë